



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Njësia Org. Org. Jedin. Org Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot Prot. No:	1698
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	94	Data Datum Date:	30.09.11
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

**PLANI I VEPRIMIT I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJISË
(PKEE)
(2010-2018)**

**PLANI I PARË AFATMESËM I VEPRIMIT I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJISË:
(2010-2012)**

**Dr. Besim Beqaj, Ministër
Ministria e Zhvillimit Ekonomik**

Prishtinë, Shtator 2011

PLANI I VEPRIMIT I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJISË (PVKEE)

PREAMBULA

Plani i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (PKEE) paraqet planin e parë afatgjatë të Kosovës për eficiencë të energjisë. Ai mbulon periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2018. Në këtë plan gjithashtu përfshihet Plani i Përkohshëm 2010-2012. Shumë prej masave që do të ndërmerren para vitit 2012 do të vazhdojnë edhe më tej dhe këto masa janë përcaktuar qartë.

Iniciativa për hartimin e PKEE-së është marrë në nëntor të vitit 2008, pas pranimin të një kërkese nga Taks Forca për Eficiencë të Energjisë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore.

Më 23 dhjetor 2008, Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave miratoi një vendim special për krijimin e grupit punues për përgatitjen e një drafti të PKEE-së. Grupi punues nga Kosova, Ministria përgjegjëse për Energji (ish MEM) kishte mundësi reale për sajimin dhe finalizimin e këtij dokumenti brenda një periudhe tremujore. GP dorëzoi dokumentin më 1 mars 2009. Në një shënim sqarues që iu dërgua Task Forcës për EE, Grupi Punues paraqiti qëndrimet e veta mbi çështjen në fjalë, duke theksuar se Kosova ishte duke e implementuar Programin e vet për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë (PKEEBRE) për periudhën 2007-2009.

Më 12 janar të vitit 2009, si përgjigje nga Sekretariati i KTE-së, GP pranoi një letër lidhur me Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë. Në letër thuhej se PKEEBRE nuk paraqet ndonjë ndërmarrje serioze; megjithatë, u dha edhe një sugjerim i qartë mbi rëndësinë e hartimit të PVKEE deri më 1 mars 2009.

Pas hartimit të një versioni punues të këtij dokumenti, mes 10 dhe 13 shkurt 2009, Grupit Punues iu ofruan shërbime këshillëdhënëse, përmes TAIEX-it, lidhur me përmbajtjen dhe metodologjinë që duhet shfrytëzuar për hartimin e PKEE-së.

Rrjedhimisht, Grupi Punues filloi hartimin e PKEE-së dhe e finalizoi këtë dokument më 23 shkurt 2009.

PVEE është dokument autentik, i hartuar nga Grupi Punues që përbëhej nga stafi profesional i Divizionit për Eficiencë të Energjisë, Burime të Ripërtëritshme të Energjisë dhe Mjedis dhe Divizioni i Statistikave dhe Bilanceve, dhe bazohet në një sërë mostrash të PVKEE-ve. Për të përkrahur hartimin e PKEE-së ishte krijuar një grup ndërinstucional që përbëhej nga përfaqësues të institucioneve në vijim:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (ish MEM)

Kryesues

Plani i Veprimt i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës	anëtar
3. Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës	anëtar
4. Zyra e Rregullatorit të Energjisë	anëtar
5. Ministria e Financave(ish MEF)	anëtar
6. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	anëtar
7. Ministria e Administratës Publike	anëtar
8. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	anëtar
9. Ministria e Infrastrukturës (ish MTPT)	anëtar
10. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar
11. Asociacioni i Komunave të Kosovës	anëtar

Gjithashtu, duhet përmendur se bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. D/2009/05/MC-EnC të datës 18 dhjetor 2009, mbi implementimin e disa direktivave mbi eficiencën e energjisë dhe shfrytëzimin e saj, anëtarët e TFEE janë pajtuar për zgjatjen e periudhave kohore të mbuluara nga PKVEE-të dhe për të kalkuluar në baza 9-vjeçare caqet indikative kombëtare për kursim të energjisë për periudhën 2010-2018 dhe për të përfshirë në to vitin 2012 si cak të ndërmjetëm. Një Grup Teknik ka punuar deri tani, i ndihmuar nga këshilltarët e BE-së, dhe i ka finalizuar të gjitha kalkulimet e lidhura me këtë detyrë. Ky raport paraqet të dhënat aktuale të azhuruara lidhur me kërkesën e energjisë dhe kursimin e energjisë për periudhën 2010-2018. Gjithashtu, gjatë periudhës korrik-nëntor 2010, Grupi Teknik, i përkrahur nga këshilltarët e BE-së, i është përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe i ka përfshirë të gjitha sugjerimet dhe korrigjimet e pranuar nga Sekretariati i Energjisë.

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

III. PASQYRË E KONSUMIT TË ENERGJISË, NDARË SIPAS LLOJIT TË LËNDËS DJEGËSE DHE SEKTORIT

IV. CAQET INDIKATIVE TË KURSIMIT TË ENERGJISË

- IV.1 CAKU I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË NË KOSOVË
- IV.2.1 PËRCAKTIMI I CAKUT TË PËRGJITHSHËM INDIKATIV TË EE
- IV.2.2 PËRCAKTIMI I CAKUT TË NDËRMJETËM INDIKATIV TË KURSIMIT TË ENERGJISË (2010-2012)

V. MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (EEI)

V.1. SEKTORI I AMVISËRIVE

V.2. MASAT INDIVIDUALE TË PËRMIRËSIMIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN E AMVISËRIVE

V.2.1: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR ETIKETIMIN E PAJIMEVE ELEKTRONIKE SHTËPIAKE (KODI: KA1)

V.2.2.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV MBI AUDITIMIN ENERGJETIK (KODI: KA2)

V.2.3.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR PROMOVIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË PËR KONSUMATORËT FINAL DHE SHËRBIMET ENERGJETIKE (KODI: KA3)

V.2.4.: NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR MENAXHIM TË PROJEKTEVE DHE AUDITIM TË ENERGJISË NËPËR KOMUNA (KODI: KA4)

V.2.5.: KURSI FILLESTAR PËR AUDITORË TË ENERGJISË (FAZA E PARË) (KODI: KA5)

V.2.6.: PËRMIRËSIMI I INKASIMIT DHE EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (KODI: KA6)

V.2.7.: PROMOVIMI I SHFRYTËZIMIT TË DRURIT PËR GATIM (KODI: KA7)

V.2.8.: RREGULLIMI TEKNIK I PERFORMANSËS ENERGJETIKE TË NDËRTESAVE (KODI: KA8)

V.2.9.: KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (LEE) (KODI: KA9)

V.2.10.: PROMOVIMI I EFIÇIENCËS ENERGJETIKE NËPËR AMVISËRI (KODI: KA10)

V.2.11.: KRIJIMI I SISTEMIT TË CERTIFIKIMIT TË AUDITORËVE TË ENERGJISË (KODI: KA11)

V.2.12.: FUSHATA PUBLIKE PËR KURSIM TË ENERGJISË DHE PËRMIRËSIM TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (KODI: KA14)

V.2.13.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV MBI NGROHJEN E NDËRTESAVE TË REJA KOLEKTIVE BANESORE (KODI: KA13)

V.2.14.: REFORMAT E LEGJISLACIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK SI ZHVILLIM POZITIV PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (KODI: KA14)

V.2.15.: STIMULIMI I SHFRYTËZIMIT TË SISTEMEVE TË ENERGJISË SOLARE PËR NGROHJE TË UJIT PËR NEVOJA SANITARE (KODI: KA 15)

VI. SERVICES SECTOR

VI. 1. INDIVIDUAL MEASURES FOR IMPROVING ENERGY EFFICIENCY IN THE SERVICES SECTOR

VI.1.1. ADMINISTRATIVE INSTRUCTION FOR LABELING HOME APPLIANCES (KODI: KS1)

VI.1.2.: ADMINISTRATIVE INSTRUCTION ON ENERGY AUDIT (KODI: KSH2)

VI.1.3.: ADMINISTRATIVE INSTRUCTION ON THE PROMOTION OF ENERGY EFFICIENCY AT END CONSUMERS (KODI: KS3)

VI.1.4.: MUNICIPAL CAPACITY BUILDING FOR PROJECT MANAGEMENT AND ENERGY AUDITING (KODI: KS4)

VI.1.5.: BEGINNERS COURSE FOR ENERGY AUDITOR TRAINING (PHASE ONE) (KODI: KS5)

VI.1.6.: INCREASING COLLECTION RATES AND ENERGY EFFICIENCY IMPROVEMENT (KODI: KSH6)

VI.1.7.: PROMOTION OF ENERGY EFFICIENCY IN MUNICIPALITIES (KODI:KSH7)

VI.1.8.: PROMOTION OF LPG FOR KITCHEN USE (KODI: KSH8)

VI.1.9.: TECHNICAL REGULATION ON THE ENERGY PERFORMANCE OF BUILDINGS (KODI: KSH9)

VI.1.10.: LEGAL AND INSTITUTIONAL ENERGY EFFICIENCY FRAMEWORK (KODI: KSH10)

VI.1.11.: PROMOTION OF ENERGY EFFICIENCY IN SMEs (KODI: KSH11)

VI.1.12.: SET UP OF THE ENERGY AUDITORS' CERTIFICATION SYSTEM (KODI: KSH12)

VI.1.13: PUBLIC CAMPAIGN ON ENERGY SAVING AND ENERGY EFFICIENCY IMPROVEMENT (KODI: KSH13)

VI.1.14.: TRANSFORMATION OF PUBLIC PROCUREMENT LEGISLATION TO THE BENEFIT OF EE IMPROVEMENT (KODI: KSH14)

VI.1.15.: ENCOURAGING THE USE OF SOLAR POWER SYSTEMS FOR SANITARY WATER HEATING (KODI: KSH15)

VI.1.16.: IMPROVING EE THROUGH EFFICIENT LIGHTING IN PUBLIC BUILDINGS (KODI: KSH16)

VI.1.17.: EFFICIENT PUBLIC LIGHTING (KODI: KSH17)

VI.1.18.: EE IMPROVEMENT OF HEATING APPLIANCES (KODI: KSH18)

VII. INDUSTRIAL SECTOR

VII. 1. INDIVIDUAL MEASURES OF ENERGY EFFICIENCY IMPROVEMENT IN THE INDUSTRIAL SECTOR

VII.1.1: PROMOTION OF ENERGY EFFICIENCY IN SMEs (KODI: KI1)

VII.1.2.: ENCOURAGING SIMPLE AUDITING IN THE INDUSTRIAL SECTOR (KODI: KI2)

VIII. TRANSPORTATION SECTOR

VIII.1. INDIVIDUAL MEASURES FOR ENERGY EFFICIENCY IMPROVEMENT IN THE TRANSPORTATION SECTOR

VIII.1.1.: AI FOR THE INTRODUCTION OF BIOFUELS (KODI: KT1)

VIII.1.2. PUBLIC AWARENESS CAMPAIGN IN THE TRANSPORTATION SECTOR (KODI:K*2)

IX. AGRICULTURE SECTOR

IX.1. INDIVIDUAL MEASURES FOR ENERGY EFFICIENCY IMPROVEMENT IN THE AGRICULTURE SECTOR

IX.1.1.: AWARENESS CAMPAIGN IN THE AGRICULTURE SECTOR (KODI: KB1)

X. Policy and Programmatic Measures for Implementation of NEEAP of Kosovo

XI. Monitoring indicators for 2010 - 2012

XII. Unit Conversion Table

SHKURTESAT

PKEE	Plani i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
EE	Eficienca e Energjisë
LEE	Ligji për Eficiencë të Energjisë
AEE	Agjencia për Eficiencë të Energjisë
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
PKEEBRE	Programi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë
TKE	Traktatit i Komunitetit të Energjisë
TF	Task Forcë
PEE	Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë
HEA	Pajisje elektronike shtëpiake
KE	Komisioni Evropian
MPEE	Masat e përmirësimit të eficiencës së energjisë
WSW	Uji i ngrohtë sanitar
AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
UA	Udhëzim Administrativ
DSB	Divizioni i Statistikave dhe Bilanceve
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
DEEBREM	Divizioni për Eficiencë të Energjisë, Burime të Ripërtëritshme të Energjisë dhe Mjedis
TeR	Termet e Referencës
K	Kosova
KH	Kosovë, amvisëritë
KS	Kosovë, shërbimet
KI	Kosovë, industria
KT	Kosovë, transporti
KA	Kosovë, bujqësia

BK	Buxheti i Kosovës
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
ESCO	Kompani e shërbimeve energjetike
GLN	Gaz i lëngëzuar i naftës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
GTZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MF	Ministria e Financave
Mİ	Ministria e Infrastrukturës
ktoe	ekuivalenti i Kiloton naftës
GWh	gigavat/orë
MW	megavat
CHP	Prodhim i kombinuar i energjisë elektrike dhe ngrohjes
IED	Direktiva për emetime industriale
IPPC	Kontrolli dhe parandalimi i integruar i ndotjes
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minerave

Kapitulli I. Hyrje

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (ish Ministria e Energjisë dhe Minierave-MEM) e Kosovës u themelua në vitin 2004 si institucion përgjegjës për sektorin e energjisë. Që nga viti 2005, brenda MZHE-it ka funksionuar një nënsektor i përbashkët e Departamentit të Energjisë për çështjet e EE dhe BRE. Që nga fillimi janë marrë parasysh praktikatat më të mira të shteteve tjera mbi EE dhe BRE në përpjekjet tona për ta përfunduar kornizën institucionale për EE dhe BRE, përmes themelimit të Agjencisë Kosovare për Eficiencë të Energjisë.

Baza ligjore për EE trajtohet nga tri ligjet primare të sektorit të energjisë: Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë.

Baza ligjore për sferën e EE është në fazën e fundit të krijimit, ngase e ka kaluar leximin e parë në Parlament dhe pritet të miratohet në gjashtëmuorin e parë të vitit 2011. Pas miratimit ligji do të plotësohet me një set aktesh legjislative sekondare, në veçanti atyre për krijimin e Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë, në formë të udhëzimeve administrative.

Përveç kësaj ndërtimi i kapaciteteve në fushën e EE paraqet një nga elementet e Strategjisë së Kosovës për Energji (2005-2015). Përveç kësaj, Strategjia e ndryshuar e Kosovës për Energji 2008-2018 identifikon EE-në si një nga objektivat strategjike për periudhën 2008-2018 dhe parasheh zhvillimin e mëtejshëm të një kornize gjithëpërfshirëse institucionale dhe ligjore, në pajtim me Direktivat Evropiane mbi EE.

Nga perspektiva e planifikimit politik, veprimtaritë për EE që përfshihen në Programin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë (PKEEBRE) për periudhën 2007-2009 ishin paraparë me Planin Kombëtar të Veprimit për EE (2007-2009), të hartuar nga Ministria përgjegjëse për Energji - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, (ish MEM) me përkrahje nga një projekt i AER-it i implementuar mes viteve 2007-2009. Masat e parapara në këtë dokument janë gjithëpërfshirëse (ligjore, institucionale, teknike, financiare, arsimore, etj.) dhe mbulojnë të gjithë sektorët e konsumit final të energjisë. Implementimi i këtyre masave bazohej në përkrahjen financiare të ofruar nga donatorët e jashtëm. Edhe pse masat dhe programet konkrete që me këtë dokument parashihej të ndërmerren ndërkohë nuk janë zbatuar në nivel të duhur, disa nga rezultatet e arritura mund të përmbliidhen në pikat në vijim:

- Ngritja e nivelit të përgjithshëm të dijeve dhe kulturës së EE
- Shtimi i kapaciteteve profesionale për EE në institucione qendrore dhe lokale, universitete, etj.
- Licencimi fillestar i rreth 50 ekspertëve për implementimin e procesit të auditimit energjetik;
- Monitorimi i projekteve studiuuese dhe vlerësuese lidhur me zbatimin e masave të EE në disa stabilimente të caktuara të sektorit publik, etj.

Republika e Kosovës u bë palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) pas nënshkrimit të këtij traktati nga UNMIK-u. Në shkurt të vitit 2008 u krijua një task forcë (grup veprues) anëtare e të cilit u bë edhe Ministria e Energjisë e Kosovës.

Duke u përpjekur që ta përafrojnë legjislacionin vendor mbi eficiencën e energjisë me atë të BE-së, dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara me Direktivën 2006/32/EC, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/15 mbi Promovimin e Përdorimit Eficient të Energjisë nga Konsumatorët Përfundimtarë dhe Shërbimet Energjetike. Për të zbatuar objektivat e përcaktuara nga TKE, Ministria përgjegjëse për energji MZHE (ish MEM) obligohet të hartojë Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, të quajtur Plani i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (PKEE). PKEE është dokument afatgjatë, i hartuar dhe implementuar në nivel të vendit, që mbulon periudhën mes 2010 dhe 2018. Hartimi i Planit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë është bërë duke u bazuar në shabllonin e Planit Kombëtar të Punës për Eficiencë Energjetike të pranuar nga TKE në korrik të vitit 2008. Ai është ndryshuar për të marrë parasysh rrethanat specifike të Kosovës, si dhe kushtet kryesore të përcaktuara në Direktivën 2006/32/EC.

Në veçanti, PKEE përmban caqet indikative për kursimin e energjisë në aspekt afatgjatë, afatmesëm dhe të ndërmjetëm (2010-2012).

Kapitulli II. Përmbledhje ekzekutive

Që nga lufta e viteve 1998-1999, Kosova është përballë me furnizim jo të qëndrueshëm të energjisë elektrike. Më tej, ajo nuk ka ndonjë sistem të qëndrueshëm të të dhënave mbi energjinë e konsumuar. Të vetmet të dhëna në dispozicion që konsiderohen si të besueshme janë ato mbi furnizimin (duke mos përfshirë drutë për djegie, që kualifikohen si biomasë). Të dhënat mbi konsumin e energjisë elektrike raportohen rregullisht nga furnizuesi publik, megjithatë, për shkak të humbjeve konstante teknike (rreth 30%), është e pamundshme që të përcaktohet në mënyrë të besueshme se ku shfaqen këto humbje (në sektorin e amvisërive apo të shërbimeve, që paraqesin dy sektorët me konsumin më të lartë të energjisë). Rreth 35% të energjisë elektrike në Kosovë përdoret për të ngrohur objektet banesore dhe objektet që janë pronë e shërbyesve (publik dhe privat).

Sektori që udhëheq sa i përket konsumit të energjisë elektrike është ai i amvisërive (rreth 63%). Përveç faktit se konsumon shumë energji elektrike, ky sektor gjithashtu konsumon sasi të mëdha të biomasës (drurit) dhe derivateve të naftës. Kontributi i ngrohjes qendrore në këtë kuptim është shumë i ulët, ngase ajo ofrohet vetëm në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Proporcioni i energjisë së prodhuar për qëllim të ngrohjes në mënyra tjera është i pavërejtshëm. Në Kosovë deri tani nuk asnjë impiant që bën prodhim të kombinuar të ngrohjes dhe energjisë elektrike, por do duhej përmendur që është kryer një studim i arsyeshmërisë së përdorimit të një pjese të Kosovës B si impiant për bashkëgjenerim dhe i zgjerimit të rrjetit të ngrohjes qendrore të Prishtinës. Zhvillimi i bashkëgjenerimit promovohet me Direktivën 2004/8/EC për shkak se ndihmon në masë të theksuar efikasitetin e përgjithshëm energjetik.

Është tejet e rëndësishme që të analizohet propozimi i ri i Direktivës Evropiane për Emetime Industriale (IPPC/IED), teksti i të cilës ka marrë miratimin politik të Këshillit të Ministrave të Mjedisit Shteteve Anëtare të BE-së në qershor të vitit 2009. Kjo Direktivë propozon caktimin e kushteve të reja dhe të fuqishme sa i përket limitimit të emetimit të ndotësve nga stabilimentet e mëdha që punojnë me djegie (LCP). Ky propozim parasheh shtimin e mundësisë së përdorimit të lëndëve djegëse vendore në LCP si dhe miratimin e disa kushteve të reja në instalime të madhësisë mesatare (<200 MW) për të plotësuar nevojat për ngrohje qendrore në aspekt afatgjatë (deri në vitin 2023).

Duke marrë parasysh propozimin e IED dhe përvojën sa i përket përdorimit të linjitet në disa shtete anëtare të BE-së, do të jetë e mundshme që të shfrytëzohen burimet lokale të linjitet në termocentrale me eficiencë të lartë (>40% për energji elektrike apo >75 % për CHP) të cilat u përmbahen standardeve adekuatë të emetimit.

Për më tepër, Kosova nuk mund të llogarisë në zhvillimin e sistemit të gazit natyror në të ardhmen e afërt ngase nuk ka stabilimente vendore të gazit natyror dhe nuk është e lidhur me Rrjetin Evropian të Gazit. Gjithashtu, pozita gjeografike e Kosovës nuk ofron mundësinë e ndërtimit të ndonjë terminali bregdetar të GLN-së. Për këtë arsye, si rrjedhojë e rrethanave të shtjelluara më lartë, pothuajse të gjitha shërbimet energjetike (ngrohja e hapësirës, gatimi, uji i ngrohët) për sektorët e banimit dhe shërbimit mbulohej me energji elektrike, biomasë (aktualisht dru), derivate të naftës (përshirë të GNL) dhe linjit.

Në anën tjetër, një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve të energjisë elektrike (mbi 40%) nuk paguajnë për energjinë që e përdorin, kështu që është tejet e rëndësishme që të ndryshohet kjo mënyrë e sjelljes tek kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Zvogëlimi i humbjeve joteknike (mospagimit të faturave) do të përmirësonte sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe gjendjen financiare të KEK-ut, si kompani përgjegjëse për furnizim të energjisë elektrike, dhe do të mundësonte investime të mundshme në sektorin e energjisë elektrike dhe do të sillte përmirësime në ndërmarrjen e masave të eficiencës së energjisë.

Në këto rrethana dhe marrë parasysh furnizimin jokonsistent dhe shfrytëzimin joeficient të energjisë elektrike, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë hapa ligjorë dhe institucionalë drejt arritjes së pajtuashmërisë me kushtet e EE. Që nga viti 2005, Divizioni për Eficiencë të Energjisë ka funksionuar si pjesë e Departamentit të Energjisë të MZHE-it (ish MEM). Projekte të ndryshme që ndërlidhen me përmirësimin e gjendjes në EE janë implementuar nën kornizën e Programit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të

Ripërtëritshme të Energjisë 2007-2009. Plani i parë i Kosovës për EE (2010-2018) është hartuar nga një grup ekspertësh nga ministria përgjegjëse për energji MZHE-i, (ish MEM) që përbëhej nga stafi profesional i Divizionit për Eficiencë të Energjisë, Burime të Ripërtëritshme të Energjisë dhe Mjedis dhe Divizionit për Statistika dhe Bilanc dhe versioni i paraqitur këtu është azhurnuar bazuar në asistencën teknike të ofruar nga Këshilltarët e BE-së.

Kapitulli III. Pasqyrë e konsumit të energjisë, ndarë sipas llojit të karburantit dhe sektorit të konsumatorëve

Tabelat dhe figurat në vijim paraqesin një pasqyrë mbi konsumin e energjisë në Kosovë gjatë periudhës 2003-2008, duke ofruar të dhëna të ndara sipas burimit të energjisë dhe sektorit konsumues të energjisë. Tabela 1 dhe Figura 1 në vijim paraqesin furnizimin e energjisë bazuar në burimet primare të energjisë për periudhën 2003-2008 (në ktoe).

Tabela 1: Burimi primar i energjisë së furnizuar për periudhën 2003-2008 (ktoe)


Burimi i energjisë	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Thëngjill (linjit)	1293	1289	1231	1226.1	1251.3	1385
Derivate të naftës	540.3	455	576	595.26	518.93	524.1
Biomasë (dru për djegie)	216.3	216.3	216.3	216.32	216.32	218.19
Energji ujore	5.58	12.14	11.99	10.902	10.135	10.05
Energji solare	0.16	0.18	0.19	0.263	0.289	0.321
Total	2055	1972	2036	2048.8	1997	2137.7

Furnizimi i energjisë në Kosovë gjatë periudhës 2003-2008 është shtuar mesatarisht për 3.2%. Gjatë kësaj periudhe, furnizimi i energjisë, sipas llojit dhe sasisë, është dukur si në vijim:

- Prodhimi nga thëngjilli ka shënuar rritje mesatare vjetore prej 1.79%.
- Importi i derivateve të naftës ka shënuar rritje mesatare vjetore prej 11.08%.
- Nuk ekzistojnë të dhëna të plota dhe të besueshme sa i përket shkallës së përdorimit të drurit, por besohet se sasia vjetore e drurit të shfrytëzuar është afërsisht 216-220 ktoe.
- Kontributi i energjisë solare ka shënuar rritje, megjithëse jo në ndonjë vlerë të theksuar.

Figura 1: Burimi primar i energjisë së furnizuar për periudhën 2003-2008 (ktoe)

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018



Gjenerimi i energjisë elektrike dominohet nga TC Kosova A dhe TC Kosova B. Gjenerimi i përbashkët i energjisë elektrike nga këto dy termocentrale është shtuar nga 341 ktoe në vitin 2004 në 384 ktoe në vitin 2007, me shtim mesatar vjetor prej 3.81%. Në vijim janë paraqitur edhe disa pika tjera me rëndësi:

- Prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet e Kosovës ka shënuar rënie nga 9.71 ktoe në vitin 2004 në 5.40 ktoe në vitin 2007, me një rënie mesatare vjetore prej 23.7%.
- Për të furnizuar në kohë të pikut të kërkesës, është dashur të importohet një sasi e konsiderueshme e energjisë elektrike. Në vitin 2004 është importuar energji elektrike në vlerë prej 55.96 ktoe, ndërsa në vitin 2007 është importuar 56.80 ktoe, duke shënuar ngritje vjetore mesatare prej 1.5%.
- Suficiti i energjisë (energjia e tepërt e prodhuar gjatë natës) është eksportuar, ndërsa eksporte: janë shtuar nga 16.7 ktoe në vitin 2004 në 31.7 ktoe në vitin 2007.
- Restriksionet e energjisë elektrike për kategori të ndryshme konsumatorësh (në veçanti për amvisëritë) supozohet se arrijnë rreth 8-10% të totalit të furnizimit.

Tabela 2 dhe Figura 2 paraqesin të dhënat mbi furnizimin bruto të energjisë elektrike për periudhën 2003-2008, të paraqitur në ktoe.

Sisteme të ngrohjes qendrore kanë vetëm Prishtina, Gjakova dhe Mitrovica. Këto sisteme mbulojnë vetëm 3% të kërkesës së ngrohjes së sektorit të amvisërive në Kosovë. Teknologjia e ngrohjes që shfrytëzohet aktualisht bazohet në lëndë djegëse të forta dhe në naftë. Ky sektor më tej përballlet me teknologji të vjetër, ndikime negative mjedisore dhe nivel të ulët të faturimit dhe inkasimit të energjisë së furnizuar. Humbjet komerciale dhe teknike janë tejet të larta ndërsa tarifatat ekzistuese nuk i mbulojnë tërësisht shpenzimet e furnizimit. Tabela 2 paraqet sasinë totale të ngrohjes së furnizuar për periudhën 2003-2008, paraqitur në ktoe.

Të dhënat për konsumin e energjisë elektrike raportohen nga furnizuesi publik i energjisë elektrike. Të dhënat mbi ngrohjen qendrore raportohen nga kompanitë publike në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjakovë. Të dhënat mbi konsumin e biomasës (drurit për djegie) bazohen në studimet dhe hulumtimet e kryera, si dhe në statistikat e ofruara nga Agjencia Kosovare e Pyjeve. Të dhënat mbi konsumin e karburanteve vlerësohet duke i krahasuar ato me të dhënat e shteteve tjera të rajonit që kanë nivel të ngjashëm të zhvillimit me Kosovës. Duhet theksuar se të dhënat mbi konsumin e energjisë nuk kanë rrjedhur nga asnjë hulumtim.


Në vitin 2010, mund të pritet një përmirësim i dukshëm i të dhënave, pasi që pritet të kryhen disa hulumtime gjithëpërfshirëse që pritet të realizohen në të gjithë sektorët e konsumit. Ministria përgjegjëse për energji-MZHE(ish MEM) është duke realizuar një projekt shumë të mirë në këtë sferë për të siguruar të dhëna sa i përket statistikave energjetike, në veçanti sa i përket konsumit. Ky hulumtim rezultoi me të dhëna të qëndrueshme, të besueshme dhe më komplete mbi përmirësimet në eficiencën energjetike në të gjithë sektorët e energjisë.

Tabela 2: Furnizimi bruto i energjisë, 2003 – 2008 (ktoe)

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

Lloji i energjisë	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Energji elektrike	312.1	350.98	383.27	381.27	415.79	429.25
Ngrohje qendrore	9.99	11.31	14.05	14.489	10.34	14.563

Figura 2: Furnizimi bruto i energjisë elektrike, 2003 – 2008 (ktoe)



Siç shihet në Tabelën 2 dhe Figurën 2, sasia e energjisë elektrike të furnizuar (prodhim dhe import) është shtuar nga 312.1 ktoe në vitin 2003 në 429.79 ktoe në vitin 2008.

III.1 Konsumi final dhe primar i energjisë për periudhën 2003-2008

Burimet e energjisë konsumohen nga sektorë të ndryshëm ekonomikë, siç janë amvisëritë, ndërtesat shërbyese publike dhe private, industria, transporti dhe bujqësia. Marrëdhënia mes zhvillimit ekonomik të vendit dhe kërkesës së energjisë në të konsiderohet si një çështje kyçe dhe mund të paraqet një cikël të mbyllur. Ky cikël ngërthen në vete shumë analiza ekonomike, sociale dhe teknologjike. Për të definuar si duhet këto marrëdhënie duhet ndërmarrë shumë studime në sektorë të ndryshëm zhvillimorë ekonomikë dhe socialë. Ato do të paraqesin bazën për të kuptuar më mirë sfidat me të cilat përballlet sektori i energjisë në Kosovë dhe përkushtimin e domosdoshëm për të siguruar furnizim të energjisë me çmimin më të ulët, për të garantuar furnizim të energjisë për të plotësuar kërkesën e konsumatorëve dhe për të krijuar kushtet e domosdoshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Për momentin, intensiteti energjetik në Kosovë është nivel relativisht të ulët. Furnizimi total i energjisë primare në Kosovë për njësi të GDP-së në vitin 2008 supozohet të jetë rreth 420 toe për milion USD (PPP), krahasuar me mesataren e 15 shteteve të BE-së me total 177.4 toe/milion USD në vitin 2005. Kjo do të thotë se prodhimi makroekonomik, që në përgjithësi përfaqësohet me Bruto Prodhimin Vendor (GDP), është relativisht i ulët. Arsyet për këtë lidhen me nivelin e ulët të zhvillimit industrial në Kosovë, me shfrytëzimin e teknologjive të vjetra, në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, dhe me faktin që një pjesë e madhe e energjisë konsumohet nga sektori i amvisërisë. Në kaptinën në vijim do të diskutohet mbi konsumin e energjisë nga sektorët e ndryshëm.

Përvoja e shteteve evropiane dëshmon trendet vijuese sa i përket intensitetit total të energjisë në periudhën 1995-2005:

- Për EU-27 ndryshimi mesatar vjetor -1,3 %;
- Për EU-15 ndryshimi mesatar vjetor -1,0 %.

Një numër tejet i vogël nga 30 shtetet evropiane të mbuluara nga hulumtimi i kryer nga Agjencia Mjeresore Evropiane nuk ka arritur zbritje vjetore (janë shënuar katër ngritje, në Itali, Austri, Portugali dhe Norvegji, ndërsa në një shtet – Islandë – nuk ka pasur ndryshim). Megjithatë, asnjë nga këto shtete nuk ka përietur luftë në territorin e tyre në 50 vitet e fundit.

III.2 Konsumi final i energjisë për sektorin e amvisërive, 2003-2008

Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërive ndahet në pesë pjesë të dallueshme, me karakteristika të ndryshme: ngrohja e hapësirave, klimatizimi, ngrohja e ujit dhe gatimi, ndriçimi dhe pajisjet tjera elektrike.


Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

Sektori i amvisërive zë vendin e parë sa i përket konsumit të energjisë në Kosovë, duke shfrytëzuar 32.85%. Si rrjedhojë, është e rëndësishme të dihet se cili është potenciali për kursime të energjisë elektrike, biomasës, derivateve të naftës (përfshirë GLN) dhe thëngjillit për njësi të shërbyer. Që nga viti 2000, furnizimi dhe kërkesa e energjisë për ngrohje të hapësirave, gatim dhe ngrohje të ujit (për çka shfrytëzohet kryesisht druri si lëndë djegëse) ka mbetur pak a shumë në një vijë. Pas vitit 2000 ka pasur një rënie të theksuar të furnizimit të zonave të banimit me dru nga zonat malore. Kjo ka rezultuar me rënie të madhe të shfrytëzueshmërisë së druve (që kryesisht prehen ilegalisht) për këto qëllime dhe me ngarkim të pajisjeve elektronike (nënstacioneve, linjave të bartjes dhe shpërndarjes). Tabela 3 dhe figura 3 paraqesin konsumin e energjisë nga amvisëritë gjatë periudhës 2003-2008.

Tabela 3: Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërive (në ktoe)

Burimet e energjisë	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Thëngjill (linjit)	4.6	2.2	3.9	3.6	2.2	8.3
Derivate të naftës	35.4	30.1	38.4	39.7	25.0	34.8
Biomasë	108.2	108.2	108.2	108.2	108.2	108.2
Energji elektrike	178.5	188.2	203.3	211.1	198.9	210.4
Energji solare	0.05	0.05	0.06	0.08	0.09	0.09
Ngrohje qendrore	4.1	4.7	6.0	6.3	5.1	6.2
Total	330.8	333.4	359.8	368.9	339.4	368.0

Figura 3: Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërive (në ktoe dhe %)



Energjia elektrike ka qenë kontribuuesi kryesor në sektorin e amvisërive dhe kjo është një nga arsyet kryesore përse Kosova është duke vuajtur nga këndvështrimi i sigurisë së furnizimit.

III.3 Konsumi final i energjisë për sektorin shërbyes privat dhe publik 2003-2008

Sektori i shërbimeve ndahet në dy degë: shërbime publike dhe shërbime private. Sektori i shërbimeve publike kryesisht në të kaluarën ka shfrytëzuar ngrohje të prodhuar me teknologji të vjetra, me instalime të vjetra, por në disa raste janë vënë në funksion disa skema të reja. Të dhënat mbi sasinë e energjisë së kërkuar nga shërbimet e ndryshme dhe kontributi i secilës lëndë të parë bazohen në hulumtime të ndryshme të kryera nga ministria përkatëse për energji MZHE(ish MEM). Duhet theksuar se ngrohja e hapësirave, ujit të ngrohtë dhe sigurimi i ndriçimit në të gjithë nënsektorët kryesisht realizohen me cilësi të ulët, për shkak të infrastrukturës së vjetër energjetike në institucione publike dhe për shkak të mungesës së buxhetit adekuat për t'i mirëmbajtur sistemet energjetike. Tabela 4 dhe Figura 4 paraqesin të dhënat mbi konsumin e energjisë në sektorin privat dhe publik të shërbimeve për periudhën 2003-2008.


Tabela 4: Konsumi i energjisë në sektorin shërbyes privat dhe publik (në ktoe)

Burimet e energjisë	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Thëngjill (linjit)	6.2	2.9	5.2	4.8	4.3	4.5

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

Derivate të naftës	40.5	34.4	43.9	45.4	39.9	41.2
Biomasë	54.1	54.1	54.1	54.1	54.1	54.8
Energji elektrike	34.2	36.1	39.0	40.5	28.3	30.0
Energji solare	0.02	0.03	0.03	0.04	0.04	0.05
Ngrohje qendrore	2.7	3.1	4.0	4.2	3.4	3.8
Total	137.7	130.7	146.1	148.9	130.1	134.3

Figura 4: Konsumi i energjisë në sektorin shërbyes privat dhe publik (në ktoe dhe përqindje)



Biomasa dhe derivatet e naftës janë kontribuuesit më të mëdhenj në konsumin e energjisë nga sektori i shërbimeve publike dhe private.

III.4 Konsumi final i energjisë nga sektori i industrisë në periudhën 2003-2008


Në analizën në dokumentin e azhurnuar të Strategjisë së Energjisë, Sektori i Industrisë ndahet në nënsektorët vijues, si: metalurgjike, kimike, materiale ndërtimore, mihje, ushqim/pije/drihan, tekstil/lëkurë/shfaqje, dru/letër/shtypje, mekanike, etj. Analiza e zhvillimit ekonomik gjatë periudhës 2003-2008 tregon përmirësim të vogël sa i përket kontributit që sektori i industrisë i jep zhvillimit të vendit. Me fjalë të tjera, prodhimtaria e përgjithshme industriale kontribuon më pak tani në vlerën absolute të GDP-së se sa që ka bërë para vitit 1999. Burimet e energjisë në sektorët industrialë konsumohen për fuqi punuese, procese ngrohëse në temperatura të ulëta dhe të larta dhe për teknologji të ndryshme (p.sh. proces të elektrolizës). Tabela 5 dhe Figura 5 paraqesin konsumin nga sektori i shërbimeve private dhe publike për periudhën 2003-2008.

Tabela 5: Konsumi i energjisë në sektorin industrial (në ktoe)

Burimet e energjisë	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Thëngjill (linjit)	23.1	10.9	19.3	17.8	10.8	10.9
Naftë	131.6	111.9	142.6	147.6	129.8	133.7
Biomasë	32.5	32.5	32.5	32.5	43.3	44.0
Energji elektrike	29.3	30.9	33.4	34.7	85.0	100.4
Total	216.5	186.2	227.9	232.5	268.9	289.0

Siç paraqitet në tabelën e mësipërme, burimet kryesore të energjisë që i kontribuojnë mbulimit të kërkesës së energjisë në sektorin e industrisë janë derivatet e naftës dhe energjia elektrike.

Figura 5: Konsumi i energjisë në sektorin industrial (në ktoe dhe %)




III.5 Konsumi final i energjisë në sektorin e transportit në periudhën 2003-2008

Sektorin e transportit në Kosovë ka shënuar zhvillim me normë të lartë të rritjes pas viteve të 60-ta kur, përveç shtimit kuantitativ të mjeteve të transportit rrugor, u zhvilluan kapacitetet infrastrukturore dhe të transportimit të sistemeve rrugore dhe hekurudhore, duke krijuar kështu një strukturë regjionale të transportit. Sektorin e transportit ka luajtur një rol të rëndësishëm në konsumin e burimeve të energjisë. Shtimi i dukshëm në numrin e mjeteve të transportit pas vitit 2000, në veçanti në mjete të transportit rrugor, u përcoill me shtim të aktiviteteve transportuese dhe me një shtim të dukshëm të konsumit të karburanteve, në veçanti naftës dhe benzinës. Sektorin ndahet në dy nënsektore: të transportimit të mallrave dhe transportimit të pasagjerëve. Tabela 6 dhe Figura 6 paraqesin konsumin e energjisë nga sektori i transportit për periudhën 2003-2008.

Tabela 6: Konsumi i energjisë në sektorin e transportit (në ktoe)

Sektorin e transportit	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Derivate të naftës	273.3	232.4	296.3	306.5	269.5	278.2
Total	273.3	232.4	296.3	306.5	269.5	278.2

Figura 6: Konsumi i energjisë në sektorin e transportit (në ktoe dhe %)



Siç u cek edhe më lartë, kontribues kryesorë të energjisë së shfrytëzuar në këtë sektor janë nafta dhe benzina.

III.6 Konsumi final i energjisë në sektorin e bujqësisë në periudhën 2003-2008

Kosova për shumë vite ka qenë një vend ku ka mbizotëruar bujqësia – ende ajo mbulon rreth 40% të GDP-së totale. Në këtë sektor, energjia konsumohet në kultivim të kulturave, bujqësi, pylltari, etj. Në veçanti në zonat rurale bujqësia vazhdon të jetë kontribuuesi kryesor për zhvillimin ekonomik dhe social. Në figurën 7

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018


dhe tabelën 7 është paraqitur konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë kushtëzohet nga shumë faktorë, mes të cilëve më të rëndësishmit janë:

- Fermat janë të madhësive të vogla dhe të fragmentuara,
- Ka probleme me pronësinë mbi tokat e punueshme,
- Çmimet e mëdha të lëndës së parë dhe mënyrat e paorganizuara dhe joefektive të prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore.
- Mungesa apo pamjaftueshmëria e kredive bujqësore.
- Mungesa apo pamjaftueshmëria e mjeteve mekanike bujqësore.

Tabela 7: Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë (në ktoe dhe %)

Sektori bujqësor	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Thëngjill (linjit)	4.6	2.2	3.9	3.6	0.7	0.7
Derivate të naftës	25.3	21.5	27.4	28.4	34.9	36.3
Biomasë	21.6	21.6	21.6	21.6	10.8	11.2
Energji elektrike	2.4	2.6	2.8	2.9	2.6	2.7
Energji solare	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
Total	54.0	47.9	55.72	56.5	49.1	50.9

Figura 7: Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë (në ktoe dhe %)



Siç u përshkrua më lartë, burimi kryesor i energjisë në këtë sektor janë derivatet e naftës.


III.7 Konsumi final i energjisë nga të gjithë sektorët 2003-2008

Analiza e paraqitur në figurën 8 dhe tabelën 8 dëshmon se kërkesa e energjisë për të gjithë sektorët ka shënuar rritje: nga 1012.3 ktoe në vitin 2003 në 1120.0 në vitin 2008. Siç tregojnë edhe shifrat, konsumatori më i madh është sektori i amvisërive, përcjellë më pas nga sektori i industrisë dhe ai i transportit. Analiza e furnizimit të sektorëve të energjisë tregon se kontribues kryesorë janë energjia elektrike, derivatet e naftës, biomasa (druri për djegie) dhe GLN.

Tabela 8: Konsumi i energjisë në të gjithë sektorët (ktoe) për periudhën 2003-2008

Konsumi i energjisë nga sektorët	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Sektori i amvisërive	330.8	333.4	359.8	368.9	339.4	368.0
Sektori i shërbimeve	137.7	130.7	146.1	148.9	130.1	134.3
Sektori i industrisë	216.5	186.2	227.9	232.5	268.9	289
Sektori i transportit	273.3	232.4	296.3	306.5	269.5	278.2
Sektori i bujqësisë	54.0	47.9	55.7	56.5	49.1	50.9
Total	1012.3	930.6	1085.8	1113.2	1057.0	1120.0

Figura 8: Konsumi i energjisë në të gjithë sektorët (në ktoe dhe përqindje)



Kapitulli IV. Caqet indikative të kursimit të energjisë në periudhën afatgjatë (2010-2018) dhe afatmesme (2010-2012)

IV.1. CAKU I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGIJË NË KOSOVË

IV.2 Përcaktimi i cakt të përgjithshëm indikativ të EE

Çështjet më të rëndësishme për të zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës dhe sektorin e energjisë të Kosovës janë shtimi i sigurisë së energjisë dhe mbajtja, në të njëjtën kohë, e një niveli relativisht të ulët të intensitetit të energjisë që do të nxisë një ekonomi efikase dhe konkurruese në tregun ndërkombëtar, i cili sa shkon e hapet më tej. Zhvillimi i përshpejtuar i eficiencës së energjisë duhet të jetë element kyç për arritjen e një zhvillimi afatgjatë dhe të qëndrueshëm të shtetit.

Analizat tregojnë se intensiteti i energjisë i Kosovës është një nga më të lartët në rajon, duke u renditur pas Bullgarisë. Si rrjedhojë e kësaj, sektori i energjisë në vend përballë me dy sfida të rëndësishme: (i) me mbajtjen e niveleve aktuale të kërkesës mesatare, dhe (ii) me shtimin e konsumit të energjisë për kokë banori. Një skenar i mundshëm 'mesatar' i shtimit të Prodhimit Bruto Vendor (GDP-së) për periudhën 2009-2018 (me rritje mesatare vjetore prej 3.1%) është marrë si bazë reale për planifikimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe për prognozimin e kërkesës së energjisë. Në tabelën 9 paraqitet parashikimi afatgjatë i kërkesës së energjisë nga sektorët e ndryshëm, duke u bazuar në dokumentin: Azhurnimi i Strategjisë së Energjisë (drafti final i marsit të vitit 2009).

Tabela 9: Parashikimi i kërkesës për energji nga të gjithë sektorët (ktoe) (2005-2018)

Sektori	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Amvisëri	360	369	339	368	377	381	387	396	405	414	421	430	444	464
Shërbime	146	149	130	134	138	139	140	141	143	145	147	149	152	158
Industri	228	233	269	289	295	320	364	383	401	421	433	449	474	511
Trans- port	296	307	270	278	287	296	306	316	326	336	347	358	375	400
Bujqësi	56	57	49	51	53	55	58	60	62	64	67	69	73	78
Total	1086	1113	1057	1120	1150	1191	1254	1296	1337	1380	1414	1455	1517	1610

Sipas kalkulimeve të kryera në pajtim me Aneksin I të Direktivës së KE-së 2006/32/EC, në periudhën 2003-2007, konsumi final mesatar është 1039.78 ktoe. Konsumi mesatar i transportit ajror është 18.7 ktoe¹.

Sa i përket mesatares së përcaktimit të caqeve për kursimin e energjisë, sipas nenit 4(1) të Direktivës, ajo është: $1039.78 - 18.7 = 1021.08$ ktoe²

Në bazë të përvojave të shumë vendeve të zhvilluara, Figurat 9 dhe 10 paraqesin kërkesën totale të energjisë (a) pa kursime të energjisë dhe (b) me kursime të energjisë sipas caqeve të përmendura më lartë. Analizimi i figurave tregon se kursimet e energjisë për vitet e para janë më të ulëta (ngase ato rlo të shërbejnë si fazë përgatitore, por, megjithatë, caku prej 3% arrihet gjatë periudhës 2010-2012) ndërsa në vitet e mëpasme kursimet e energjisë duhet të shtohen për të arritur objektivin e përcaktuar në 9%.

¹ Aneksi 2 paraqet bazën e të dhënave, sipas formatit të EUROSTAT për bilanc të energjisë për të gjitha vitet që i mbulon analiza.

² Në Kosovë nuk ka përcillet konsumi bazuar në Direktivën e Tregimit të Emetimeve

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

Figura 9: Caqet afatshkurta dhe afatgjata të EE në %





Figura 10: Totali i kërkesës së energjisë, kursimi i energjisë dhe caqet afatshkurta dhe afatgjata në %



Kosova i ka miratuar caqet indikative prej 9%, apo 1021.08 ktoe, që duhet të arrihet në fund të periudhës (2010-2018), për të arritur vlerën prej 91.89 ktoe energji të kursyer. Për këtë arsye, sasia e energjisë që Kosova mëton ta kursejë deri në fund të vitit 2018 është 91.89 ktoe.

Tabela në vijim paraqet kontributin (në përqindje) të sektorëve të ndryshëm në konsumin e përgjithshëm të energjisë mes viteve 2010-2018, sipas dokumentin Parashikimi i Kërkesës së Energjisë për periudhën 2009-2018.

Tabela 10: Parashikimi i kontributit të secilit sektor në konsumin e energjisë (%) (2009-2018)

Sektorët	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Amvisëri	32.8%	32.0%	30.9%	30.6%	30.3%	30.0%	29.8%	29.6%	29.4%	29.2%
Shërbime	12.0%	11.7%	11.2%	10.9%	10.7%	10.5%	10.4%	10.2%	10.0%	9.8%
Industri	25.6%	26.9%	29.0%	29.6%	30.0%	30.5%	30.6%	30.9%	31.2%	31.5%
Transport	25.0%	24.9%	24.4%	24.3%	24.4%	24.4%	24.5%	24.6%	24.7%	24.8%
Bujqësi	4.6%	4.7%	4.6%	4.6%	4.6%	4.6%	4.7%	4.7%	4.7%	4.7%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 10 paraqet pjesëmarrjen e secilit sektor në konsumin e përgjithshëm të energjisë, shprehur në përqindje. Sipas analizave të kryera gjatë hartimit të Parashikimit të Kërkesës së Energjisë për periudhën 2009-2018, është e qartë se jemi duke shkuar drejt konsolidimit të një sistemi. Gjatë kësaj periudhe, është paraparë se konsumi në sektorin e industrisë do të shënojë rritje graduale, duke shtuar konsumin e energjisë në fund të periudhës (vitin 2018). Kjo do të ndodh si rezultat i rindërtimit dhe zhvillimit të industrisë që do të ngjajë gjatë viteve në vijim. Në anën tjetër, pjesëmarrja e të gjithë sektorëve tjerë në konsumin e energjisë do të zvogëlohet në përmasa relative. Kjo rënie do t'i përfshijë sektorin e amvisërisë, pjesëmarrja e të cilit do të bie nga 33.34% në vitin 2009 në 29.2% në vitin 2018.

Përqindja e sektorëve të ndryshëm në konsumin e përgjithshëm të energjisë në Kosovë (nesatarja për periudhën 2003-2007), në krahasim me përqindjen e sektorëve të ndryshëm në konsumin e energjisë në vendet e Bashkimit Evropian është paraqitur më poshtë në tabelën 11:

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2013

Tabela 11: Pjesëmarrja nga sektorët e ndryshëm (në përqindje)

Vendi	Kosova	Mesatarja në shtetet e BE-së
Sektorët	Pjesëmarrja në %	Pjesëmarrja në %
Amvisëri	33.34	26.28
Shërbime	13.34	12.47
Industri	22.35	27.77
Transport	26.52	30.91
Bujqësi	5.06	2.54

Bazuar në kërkesat e nenit 4 (2) të Direktivës 2006/32/EC, u përcaktua Caku i Ndërmjetëm Indikativ i Kursimit të Energjisë për periudhën 2010-2012, në pajtim me Cakun e Përgjithshëm Indikativ për Kursim të Energjisë në fund të vitit 2018.

Caku i Ndërmjetëm Indikativ për Kursim të Energjisë i miratuar paraqet 3% të konsumit mesatar gjatë periudhës pesëvjeçare që i referohet, duar marrë në konsideratë konsumin e transportit ajror. Caku i Ndërmjetëm i Kursimit të Energjisë është caktuar në bazë të një analize të kryer nga Grup. Punuesi për Hartimin e Planit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, të udhëhequr nga Divizioni për Eficiencë të Energjisë, Burime të Ripërtëritshme të Energjisë dhe Mjedis. Një grup ndërinstitucional ishte krijuar për të përkrahur këtë grup punues, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, entiteteve energjetike, komunave dhe donatorëve, me qëllim të përcaktimit të caqeve reale indikative dhe për t'i ofruar këtij të fundit përkrahje në monitorimin dhe implementimin e tyre.

Faktet në vijim janë marrë parasysh gjatë përcaktimit të caqeve të EE-së për periudhën e ndërmjetme, mes 2010-2012:

1. Mungesa e një ligji për eficiencë të energjisë
2. Mungesa e Agjencisë Kombëtare për Eficiencë të Energjisë dhe e Zyrave Rajonale për Energji
3. Mungesa e një Fondi për Eficiencë të Energjisë
4. Mungesa e një sistemi të etiketimit energjetik të ndërtesave
5. Mungesa e procedurave të përshtatshme ligjore për prokurim të EE
6. Mungesa e kompanive që ofrojnë shërbime që ndërlidhen me EE
7. Vonesat në fillimin e etiketimit të pajimeve elektronike shtëpiake (që pritet në të ardhmen e afërt)
8. Mungesa e të dhënave të plota për hulumtim të saktë të sektorëve shtetëror, sa i përket EE
9. Mungesa e një vendimi që do të detyronte konsumatorët nga sektori publik që të ndërmarrin masa për përmirësimin e EE

Më tej, janë shqyrtuar faktet në vijim, të cilat kanë për qëllim lehtësimin e implementimit të procesit të PVKEE-së:

1. Ngritja e nivelit të njohurive dhe kapaciteteve të përgjithshme profesionale mbi EE-në branda MZHE-it (ish MEM), me përkrahjen e Komisionit Evropian, përmes BE-së dhe donatorëve tjerë si USAID, BERZH, etj;
2. Procesi aktual i promovimit të shfrytëzimit të energjisë solare në katër klinika spitalore të QIKUK-së, dhe në qendrën studentore, si rezultat i një projekti të financuar me Buxhetin e Kosovës (2009 dhe 2010);
3. Komisioni Evropian ka alokuar një buxhet prej 1.2 milion euro për projektin e implementimit të masave për përmirësimin e eficiencës energjetike në pesë stabilimente publike (4 shkolla dhe 1 spital). Implementimi i projektit do të finalizohet në gjysmën e dytë të vitit 2011;
4. Në vitin 2010, komiza institucionale për implementimin e legjislacionit të miratuar do të plotësohet në masë të gjerë;
5. Lansimi i një programi për përmirësimin e EE-së nga KfW, përmes dy bankave më të rëndësishme (ProCredit dhe RBKO), që arrin vlerën prej 10 milion euro, nga i cili po përfillojnë shumë projekte të EE-së në sektorin e amvisërive dhe NMV-ve;

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

6. Gjatë vitit 2010 është realizuar një anketë gjithëpërfshirëse për të vlerësuar konsumin e energjisë nga sektorët e ndryshëm. Për herë të parë, ky hulumtim ngërthen në vete edhe një segment të EE-së dhe pyetësorët janë në fazën e fundit të procedimit;
7. Në vitin 2010, 50 auditorët e parë të energjisë janë në fazat e fundit të certifikimit, bazuar në një program të BE-së (e për më tepër, GTZ ka premtuar financimin e ngritjes së kapaciteteve të MZHE-it(ish MEM) dhe sektorit privat në auditim energjetik);
8. Aktualisht ka interes për auditivin energjetik si afarizëm.

Për shkaqet e përmendura më lartë, Kosova e ka ndërmarrë një qasje proaktive dhe e ka një cak të ndërmjetëm të kursimit të energjisë në Planin e Parë Kombëtar për Eficiencë të Energjisë (2010 – 2012), që është 3% nga 1021.08 ktoe. Sasia e synuar prej 3% nga sasia e gjithmbarshme e periudhës (2010 – 2012) është 30.63 ktoe.

Caku i miratuar indikativ i ndërmjetëm: 31 ktoe

Caku indikativ kombëtar duhet të përcaktohet mes sektorëve të kërkesës finale të energjisë, në mënyrë që efektiviteti i masave të propozuara të mund të monitorohet në mënyrë më të ndarë. Për më tepër, autoritetet dhe organizatat e ndryshme kanë juridiksion për të implementuar përmirësime të eficiencës së energjisë në sektorë të ndryshëm.

Përmasa që sektori mban në cakun kombëtar kryesisht bazohet në faktorët në vijim:

- Në përpjesëtimin që sektorët e ndryshëm mbajnë në konsumin final të energjisë,
- Në potencialin për përmirësime të eficiencës,
- Në konceptin e eficiencës ekonomike të masave të ndryshme të eficiencës së energjisë në sektorë të ndryshëm (për këtë arsye është shumë më mirë që të monitorohen masat më efektive) dhe
- Në nivelin e domosdoshëm të intervenimeve politike dhe ligjore brenda sektorëve.

Siç u dëshmua më lartë, sektorët e amvisërive dhe të transportit shfrytëzojnë pjesën më të madhe të energjisë së konsumuar. Megjithatë, alkimi nuk bëhet vetëm në bazë të këtyre përqindjeve por edhe në bazë të parashikimeve të dhëna sa i përket ndikimit të masave të propozuara të EE. Nivelet e synuara brenda secilit sektor janë dhënë në tabelën në vijim. Ndarja e këtij synimi indikativ të ndërmjetëm të kursimit të energjisë sipas sektorit është paraqitur në Tabelën 12.

Tabela 12: Caku i ndërmjetëm i kursimit të energjisë sipas sektorit

Caku indikativ i kursimit të energjisë: 31 ktoe			
Periudha	(2010-2012)		
Sektori	%	ktoe	GWh
Amvisëri	40	12.8	144
Shërbime	30	9.6	108
Industri	25	8	90
Transport	4.5	1.4	52
Bujqësi	0.5	0.15	5.8

Siç mund të vërehet në Tabelën 12, gjatë periudhës afatmesme, sektori i amvisërive do të jetë sektori që shënon kursimet më të mëdha të energjisë. Kjo është arsyeja përse ky sektor karakterizohet me masa të shumta për përmirësimin e EE-së dhe këto masa, të cilat në vijim do të përshkruhen detajisht, janë masat me çmimin më të ulët (në krahasim me masat tjera). Përcaktimi i një caku të ndërmjetëm në vlerë prej 40% nga caku i përgjithshëm i caktuar për amvisëritë gjithashtu rrjedh nga fakti se deri tani janë ndërmanë një sërë veprimesh nga ministria përgjegjëse e energjisë MZHE (ish MEM) dhe donatorët e jashtëm në këtë drejtim. Gjithashtu, sektori i amvisërive në Kosovë paraqet sektorin më të studiuar, dhe rrjedhimisht sektorin ku më së qarti janë identifikuar mundësitë për kursim të energjisë.

Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

Sektori i shërbimeve ngërthen në vete një spektër të gjerë të konsumatorëve të të gjitha formave, formave energjetike dhe llojeve. Ky sektor përfshin: shëndetësinë, arsimin, shërbimet publike, veprimtarinë kulturore, sportet, etj. Sektori publik gjithashtu përfshin ofruesit e shërbimeve private në sfera të ndryshme (turizm, shërbime hoteliere, ndërmarrje private sportive, kujdes shëndetësor, arsim dhe veprimtari kulturore, etj.). Edhe pse pjesëmarrja reale e këtij sektori arrin në 13.34% nga konsumi i përgjithshëm, caku i miruar i ndërmjetëm i kursimit të energjisë për periudhën trevjeçare është 30% nga caku i përgjithshëm, për shkak se është paraparë të ndërmerren masa administrative të obligueshme për përmirësimin e EE-së, siç janë aplikimi i Direktivës 2002/91/EC mbi performansën energjetike të ndërtesave. Deri tani, janë kryer punët fillestare për të promovuar shfrytëzimin e mëtejshëm të energjisë solare në disa spitale dhe qendra studentore të caktuara.

Industria, transporti dhe bujqësia si sektorë të ndarë në konsumin e energjisë mbase do të arrijnë kursimin e energjisë në vlerën prej 30% nga caku i përgjithshëm i ndikativ. Edhe pse pasqyra e përgjithshme e gjendjes me konsumin e energjisë në këta sektorë tregon se ka shumë hapësirë për të përmirësime në kursim të energjisë, periudha e parë trevjeçare nuk parasheh masa të cilat do të mund të konsideroheshin tepër ambicioze, ngase këta tre sektorë ende nuk janë trajtuar nga aspekti i eficiencës së energjisë. Këta tre sektorë konsiderohet se janë më të hapur ndaj fushatave promovuese dhe vetëdijësuese se sa ndaj masave konkrete obligative. Nevojitet kohë e konsiderueshme që në këta sektorë të funksionojnë instrumentet dhe mekanizmat e domosdoshëm që do të kishin ndikim në përmirësimin e gjendjes sa i përket EE-së. Figurat 11 dhe 12 paraqesin përmbledhje të kursimit relativ dhe absolut të energjisë që kërkohen nga secili sektor ekonomik për të arritur objektivat e definuar në kaptinat e mësipërme.

Figura 11: Kursimi relativ kumulativ i EE, shprehur në përqindje për sektor





Figura 12: Kërkesa totale e energjisë pas zbatimit të masave të EE-së në secilin sektor dhe kursimet absolute të EE për secilin sektor (ktoe)



Kapitulli V. Masat e përmirësimit të efijencës së energjisë (EEI)

V.1. Sektori i amvisërive

Siç mund të vërehet nga Figura 3, mes viteve 2003 dhe 2008, sektori i amvisërive ka mbajtur një përcindje mjaft të lartë të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Për të përcaktuar objektivin e zvogëlimit të konsumit të energjisë sipas caqeve të definuara më lartë, është dashur të merren në konsideratë masat kualitative dhe kuantitative vijuese që duhet ndërmarrë gjatë viteve në vijim:

- Termo-renovimi kompleks, përfshirë: shfrytëzimin e sistemeve të ngrohjes me kontroll automatik dhe izolimit termal në ndërtesa, që do të kontribuojnë në zvogëlimin e kërkesës për energji për ngrohje të hapësirave.
- Depërtimi i GLN-së do të duhej të kontribuojë në zvogëlimin e sasisë së energjisë elektrike të shfrytëzuar për gatim dhe ngrohje të hapësirave, dhe do të duhej të zëvendësojë konsumin e druve
- Promovimi i bashkëgjenerimit efikas të ngrohjes dhe energjisë elektrike (përfshirë sistemet e ftohjes-ngrohjes), në veçanti përmes finalizimit të konceptit të bashkëgjenerimit në Prishtinë, me ç'rast Prishtina do të furnizohej me ngrohje nga Termocentrali Kosova B.
- Promovimi i skemave të ngrohjes qendrore që kontribuojnë në sigurimin e ngrohjes së hapësirave dhe ujit, në veçanti në blloqet e reja të ndërtesave shumëkatëshe.
- Promovimi i bojlerëve të rinj dhe efikas.
- Depërtimi i paneleve solare për përgatitje të ujit të ngrohët, që do të zvogëlojë kërkesën për energji elektrike që shfrytëzohet për këtë qëllim.
- Shfrytëzimi i pajisjeve efikase shtëpiake (makina larëse, shporete, pajisje të aklimatizimit, poçe, etj.) që zvogëlojnë sasinë e energjisë elektrike të shfrytëzuar nga pajisjet elektronike shtëpiake.

Këto masa të efijencës dhe rezultatet e tyre sqarohen më në detaje më poshtë.

Figurat 13 dhe 14 paraqesin kursimet relative dhe absolute të energjisë së kërkuar për të arritur objektivat e definuara në kapitullin e mësipërme.

Figura 13: Caku afatshkurtër dhe afatgjatë i EE për sektorin e amvisërive, në %





Figura 14: Kërkesa totale e energjisë pas zbatimit të masave të EE në sektorin e amvisërive dhe kursimet absolute të EE, në ktoe



Masat që parashihet të ndërmerren mes viteve 2009 dhe 2012 konsiderohet se do të japin efekt të njëhershëm, në veçanti sa i përket kursimit të energjisë së ngrohjes, duke qenë se ngrohja aktualisht kryesisht bëhet përmes pajimeve elektronike – edhe pse këto masa do të kenë ndikim edhe në kurs min e lëndëve djegëse, kryesisht biomasës dhe linjtit. Megjithatë, marrë parasysh shkallën e domosdoshme të investimeve dhe përvojën e shteteve tjera në këtë fushë, nuk do të jetë e mundur që të gjitha ato të realizohen brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Tabela 14: Masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë në sektorin e amvisërive

KODI	TITULLI	STATUSI	NATYRA	Viti i parë	Viti i fundit	Rezultati	Kursimi i energjisë (toe)	Kostoja e investimit/ Implementimit (Euro)	Indikatorët e monitorimit	ZBATUAR NGA
KA1	UA mbi etiketimin e HEA	Është miratuar por pritet fillimi i zbatimit	Rregulative/ normative	2008	2018	Implementimi i këtij udhëzimi rezultoi me kurseme indirekte vjetore të energjisë elektrike nga sektorë të caktuar	1571	70000 Nuk janë zotuar	UA e përgatitur	MZHE, MTI, tregtarët, shoqatat e konsumatorëve, MEF/dogana, donatorët
KA2	UA mbi auditimin energjetik	Është miratuar	Rregulative/ normative/ informative	2010		Implementimi i rekomandimeve mbi auditimin vullnetar energjetik pritet të rezultojë me kurseme të energjisë. BE është duke e finalizuar projektin dhe 50 AE të parë janë në fazën e fundit të certifikimit, që do të realizohet deri në fund të dhjetorit 2010.	4714	300000 Të zotuarra si pjesë e një projekti të BE-së që do të fillojë në gjuymën e dytë të 2009	UA e përgatitur	MZHE, BE, UNIVERSITETI, ESCO, SHOQATAT
KA3	UA mbi promovimin e eficiencës së energjisë tek konsumatorët finalë	Është miratuar	Rregulative/ normative/ informative	2010	2011	Lidhet me masa tjera të EEI		60000 Nuk janë zotuar	UA e përgatitur	INSTITUCIONET, OPERATORET E ENERGJISË
KA4	Ngritja e kapaciteteve për menaxhim të projekteve dhe auditim energjetik në komuna (faza e parë)	E finalizuar	Arsimore/ trajnuese	2010	2010	BE është duke e finalizuar projektin dhe 50 AE të parë janë në fazën fundit të certifikimit, që do të realizohet deri në fund të dhjetorit 2010.	1048	100000 Të zotuarra si pjesë e projektit që do të finalizohet deri në fund të dhjetorit 2010	Numri i audituesve të licencuar energjetik	MZHE, RIINVEST
KA5	Kurse fillestare të trajnimit për auditues energjetik (faza e parë)	E finalizuar	Arsimore/ Trajnuese	2008	2008	I paverësuar	1048	30000 Realizuar si pjesë e një projekti të BE-së për vitin 2008	60 Auditor Energjetik të trajnuar	MZHE, AER, ekspertë të ndryshëm
KA6	EE dhe shtimi i normës së inkasimit	E finalizuar	Arsimore/ Trajnuese	2007	2018	I paverësuar	6286	300000 Të zotuarra nga KEK dhe në proces	% nga rifija e normës së inkasimit	MDA

Plani i Veprimt i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

KA7	Promovimi i GLN-së për ngrohje dhe shfrytëzim në kuzhinë	Aplikimi ka filluar	Arsimore	2009	2012	Vlerësohet se do të ketë kursime të energjisë elektrike që shfrytëzohet për ngrohje dhe galim, që paraqet 25% të konsumit aktual të energjisë elektrike	4714	45000 Të zotuar nga MZHE dhe zbuluar gjatë periudhës maj-tetor 2009	Shitimi i konsumit të GLN-së	(ToR)
KA8	Rregullorja teknike e performansave energjetike të ndërtesave	Draft	Rregullative/normative	2007	Miralimi në 2009, implementimi përgjatë tërë periudhës së mbuluar (deri në fund të 2018)	Implementimi i kësaj rregulloreje pritet të rezultojë me kursime të konsiderueshme të energjisë që konsumohet për ngrohje kolektive banesore. MZHE në bashkëpunim me MMPH, përkrah me 11 komuna të Kosovës kanë filluar një projekt për identifikimin e barrierave kryesore për implementimin e rregullores teknike për kursimin energjetik në ndërtesa të reja dhe të riparuar.	6286	60000 Vec janë zotuar nga MZHE-i dhe duhet përmendur se deri në fund të vitit 2010	MZHE është duke përgatitur një projekt për lehtësimin e implementimit të këtij Udhëzimi Administrativ Numri i ndërtesave të ndërtuara/riparuar a sipas rregullave të reja teknike MMPH, MZHE	
KA 9	Ligji për EE	Draft	Rregullative/normative	2009	Miralimi në vitin 2011, implementimi përgjatë tërë periudhës së mbuluar (deri në 2018)	Rezultatet janë të ndërlidhura me masat e përgjithshme të EEI	2619	10000 Drafti final është përgatitur nga MZHE	Ligji për EE të finalizohet dhe miratohet	MZHE, Qeveria
KA 10	Promovimi i EE në amvisëri	Planifikuar	Financiare/kredi të bula	2009	2014	Vlerësuar nga KfW dhe RFB duke shfrytëzuar kriteret e projektit. Komponenti i fushatës së këtij projekti do të sjell kursime vjetore të energjisë, si rezultat i vetëdijes së shtuar dhe ndërmarrjes së nismave individuale për izolime termale në zona të banimit, dhe instalimit të sistemeve solare për ngrohje të ujit për nevojat sanitare. Projektet do të fokusohen me shumë në instalimin e sistemeve solare për ngrohje të ujit sanitar, pasi që ky aktivitet për momentin është i aftë për konsumin e 25% të energjisë	7857	5600000 Pakoja kreditore është siguruar nga KfW dhe RFB KfW është gjithashtu në proces të fillimit të fazës së dytë me ProCredit Bank Kosovën për lëshimin e 10M Euro në formë të kredive të bula për EE në amvisëri dhe NMV.	Lëshimi i kreditë nga KfW dhe RFB për shllimin e EE në amvisëri Lëshimi i kreditë nga KfW dhe RFB Pakoja kreditore është siguruar nga KfW dhe RFB KfW është gjithashtu në proces të fillimit të fazës së dytë me ProCredit Bank Kosovën për lëshimin e 10M Euro në formë të kredive të bula për EE në amvisëri dhe NMV.	MZHE, institucionet qeveritare (qendrore dhe lokale), KfW, donatorë tjerë

Plani i Veprimt i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – PVKEE 2010-2018

KA 11	Zhvillimi i sistemit të certifikimit të auditorëve të energjisë	Planifikuar	Financiare	2009	2009	Me përkrahje nga KE certifikimi i 50 auditorëve të energjisë do të kryhet deri në fund të dhjetorit 2010.	2095	100000 Të zotuar si pjesë e një projekti që do të fillojë në gjysmën e dytë të vitit 2010	Numri i licencave të auditorëve të energjisë	MZHE; KE; GTZ; Shoqatat energjetike; specialistët e energjisë	
KA-12	Fushata publike mbi kursimin e energjisë dhe përmirësimin e EE	Planifikuar	Financiare/arsimoret	2009	2018	Projekti demonstrativ që parashihet të implementohet për të stimuluar paguesit e rregullt të energjisë. Projekti do të fokusohet në një komunë të caktuar dhe të ketë si cak përfundimtar promovimin e masave të eficientësisë së energjisë në përgjithësi dhe të ndiqimil eficient në veçanti, duke i zëvendësuar poqel inkandeshente me ato floroshente.	3143	300000 Të zotuar si pjesë e një projekti të BE-së që do të finalizohet në dhjetor të vitit 2010	kWh të kursyer nga amvisëri të ndryshme si mostra të studimit të MZHE/RIINVEST	MZHE, KEK, GTZ, konsumatorët individualë	
K13	UA mbi ngrohjen e ndërtesave të reja kolektive të banimit	Planifikuar	Rregullative/normative	2010	2011	Miratimi i një UA mbi ngrohjen e ndërtesave të reja kolektive banesore do të përmbaj dispozita për aplikimin e kufizimeve në shfrytëzimin e energjisë elektrike për ngrohje në ndërtesa të reja kolektive të banimit	4190	70000 Të pabotuara	UA duhet të përgatitet	MZHE, MMPH	
K14	Stimulimi i shfrytëzimit të sistemeve të energjisë solare për ngrohje të ujit për nevoja sanitare	Planifikuar	Rregullative/financiare/arsimoret	2010	2018	Kjo masë kombinohet me masa tjera të EE, por pritet që do të ketë efekt të theksuar sa i përket kursimit të energjisë, ngase 25% të tërë konsumit të energjisë në këtë sektor bëhet për ngrohje të ujit për nevoja sanitare.	7857	3400000 Pakoja kreditore është siguruar nga KfW dhe RFB; faza e dytë do të realizohet mes KfW dhe ProCredit Bank Kosovë	Numri i meirave katror të sistemeve solare për ngrohje të ujit në sektorin e amvisërive	MZHE, konsumatorët nga sektori i amvisërive	
Total të gjitha masat							52,380	10,385,000			

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V. 2. MASAT INDIVIDUALE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN E AMVISËRIVE

V.2.1: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR ETIKETIMIN E PAJISJEVE ELEKTRONIKE SHTËPIAKE (KODI: KA1)

TITULLI	UA PËR ETIKETIMIN E PAJISJEVE ELEKTRONIKE SHTËPIAKE
KATEGORIA	LEGJISLATIVE/NORMATIVE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	Konsumatorët individualë, furnizuesit dhe prodhuesit e pajisjeve
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Zhvillimi i skemave të etiketimit dhe institucionalizimi i sistemeve të kontrollit të produkteve që parashihen me implementimin e këtij Udhëzimi administrativ. Gjatë vitit 2010, dizajni dhe forma e etiketave të pajisjeve elektronike shtëpiake është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, me përkrahje të BE-së. Me funksionimin adekuat të sistemit të kontrollit të etiketave, konsumatorët do të shtojnë besimin në tregun e pajisjeve elektronike dhe do të kenë mundësi të kursejnë energji duke shfrytëzuar pajisjet më eficiente dhe do të mund t'i zëvendësojnë pajisjet që janë më pak eficiente.
EFEKTIVITETI	Skemat e etiketimit përfshijnë një kontroll rigoroz të pajisjeve shtëpiake elektronike nga perspektiva e etiketimit. Kontrolli do të ketë ndikim në shmangien nga shfrytëzimi i pajisjeve joefikase apo keqpërdorimi i etiketave. Ne do të përfitojmë me pajisje me efizienzë të lartë, të cilat do të jenë lehtë të dallueshme me etiketat e tyre specifike. Prodhuesit dhe tregtarët, të vetëdijshëm për pasojat që do të kenë nëse pajisjet e tyre nuk janë në pajtueshmëri me kushtet përkatëse, do të jenë të obliguar të kontrollojnë në mënyrë shumë rigorozë cilësinë e lëndëve që shfrytëzohen në prodhim si dhe pajisjet që janë në shitje (nga tregtarët). Kjo hapë rrugën për depërtimin më të sigurt dhe më efikas të pajisjeve efikase në treg.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Kursimi indirekt që rrjedh nga aplikimi i UA-së për etiketim të pajisjeve elektronike shtëpiake pritet të jetë 1% e vlerës së konsumit vjetor mesatar nga sektori i amvisërive, apo 3.46 ktoe. Kursimet e pritura për periudhën 2010-2012 janë 6.92 ktoe, ndërsa në deri në fund të vitit 2018 kjo do të arrijë në 23.22 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	UA është nënshkruar. Implementimi i plotë do të fillojë në vitin 2011, kur priten rezultate specifike nga masat.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.2.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR AUDITIMIN ENERGJETIK (KODI: KA2)

TITULLI	UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR AUDITIMIN ENERGJETIK
KATEGORIA	LEGJISLATIVE/INFORMATIVE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNJUAR	Kategori të caktuar të konsumatorëve përfundimtarë dhe auditorët e energjisë
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<ul style="list-style-type: none"> • Stimulimi i auditorëve të energjisë • Stimulimi i auditimit të ndërtesave me sipërfaqe më të mëdha se 1000 m² dhe aplikimi i certifikatave të performansës energjetike të ndërtesave • Krijimi i një sistemi të monitorimit të UA-së për auditim energjetik të ndërtesave
EFEKTIVITETI	<ul style="list-style-type: none"> • Sajimi i një kurikule të AE përmes programeve të BE-së. • Sajimi i një skeme të certifikimit të auditorëve të energjisë. • Krijimi dhe mirëmbajtja e një regjistri të auditorëve të energjisë • Pas krijimit të tregut të auditorëve të certifikuar të energjisë, do të plotësohen parakushtet për auditim vullnetar të një kategorie të konsumatorëve nga sektori i amvisërive • Certifikimi i auditimit të energjisë përcakton parakushtet për vlerësim më të mirë të projekteve të EE-së që duhet ndihmuar me kredit dhe huazime nga jashtë. • Krijimi i kushteve për përkrahje profesionale për hartuesit e dokumenteve të lënderimit në sektorin publik sa u përket masave për përmirësimin e efijencës së energjisë, në veçanti projekteve që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe renovimin e shkollave, ambulancave, spitaleve, objekteve kulturore, gjatë fazës së parë të implementimit të UA-së (2011 – 2012.)
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Kjo masë do të ndihmojë në implementimin e masave që kanë të bëjnë me performancën energjetike të ndërtesave, përmes aplikimit të certifikatave për performancë energjetike të ndërtesave.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	IA për auditimin energjetik është nënshkruar në vitin 2008. Parashihet lëshimi i certifikatave për veprimtarinë e auditorit të energjisë. Gjithashtu parashihet lëshimi i certifikatave të performansës së energjisë për ndërtesa publike.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.3.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR PROMOVIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË PËR KONSUMATORËT FUNDORË DHE SHËRBIMET ENERGJETIKE (KODI: KA3)

TITULLI	UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR PROMOVIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË PËR KONSUMATORËT FUNDORË DHE SHËRBIMET ENERGJETIKE
KATEGORIA	LEGJISLATIVE/INFORMATIVE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	<ul style="list-style-type: none"> • Ofruesit e shërbimeve të EEI • Furnizuesit e energjisë • Operatorët e shpërndarjes dhe kompanitë e shitjes me shumicë dhe pakicë • Ofruesit e shërbimeve të energjisë
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<p>Udhëzimi Administrativ është në fuqi. Ky UA është në pajtim me Direktivën e KE 2006/32 EC. Plani i Kosovës për Eficiencë të Energjisë është bazuar në kushtet e përcaktuara me UA për Promovimin e Eficiencës së Energjisë për Konsumatorët Fundorë të Shërbimeve Energetike, respektivisht në Direktivën e KE 2006/32/EC. PKEE parashihet një sërë masash që sigurojnë implementimin e UA-së. PKEE parashihet se deri në vitin 2012 në sektorin e amvisërive do të ketë kurse prej 3%, nga mesatarja e energjisë së konsumuar për periudhën 2003-2007. Ky plan kryesisht bazohet në masat konkrete që parashihen të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në kursimin e energjisë, përfshirë: kreditë për projekte të EEI në sektorin e amvisërisë (kjo duhet të fshihet ngase si masë nuk ndërthet në vete kurse. Kursimet janë përcaktuar me masa tjera të kursimit të energjisë që implementohen nga shteti dhe përcaktohen si kushte në këtë Udhëzim).</p>
EFEKTIVITETI	<ul style="list-style-type: none"> • Shtimi i numrit të organeve shtetërore që angazhohen në monitorimin dhe implementimin e masave për EEI, si dhe dokumentet dhe aktet tjera nga fusha e eficiencës së energjisë. • Shtimi i numrit të kompanive të furnizimit, përmirësimi i sistemit të shpërndarjes dhe rrjetit, shtimi i numrit të kompanive që bëjnë shitje me pakicë. • Shtimi i cilësisë së bazave të dhënave dhe komunikimit mes kompanive që punojnë në eficiencë të energjisë-konsumatorëve-organeve monitoruese. • Shtimi i kursimit të energjisë në të gjithë sektorët dhe kursimi i burimeve të energjisë.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Kursimi i energjisë gjatë implementimit të këtij UA duhet të kalkulohet përmes mjeteve tjera që rezultojnë nga implementimi i tij.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	UA është në fuqi që nga viti 2008, megjithatë, implementimi i tij do të fillojë me miratimin e Planit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.4.: NDËRTIMI I KAPACITETEVE NË MENAXHIM TË PROJEKTEVE DHE AUDITIM TË ENERGJISË NË KOMUNA (KODI: KA4)

TITULLI	NDËRTIMI I KAPACITETEVE NË MENAXHIM TË PROJEKTEVE DHE AUDITIM TË ENERGJISË NË KOMUNA
KATEGORIA	ARSIMOR/TRAJNUES
NIVELI I ZBATIMIT	KOMUNAL
GRUPI I SYNUAR	Stafi komunal, asociacionet dhe kompanitë energjetike, specialistët e energjisë
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Trajnime u janë ofruar zyrtarëve komunal në fushën e grumbullimit të statistikave energjetike, menaxhim të projekteve të eficientës së energjisë, etj. Gjithashtu, bazuar në asistencën teknike të siguruar nga BE, janë mbajtur katër kurse me stafin e ardhshëm të Zyrave Lokale për Energji në fushat e planifikimit energjetik, Planin e Veprimit për EE në nivel komunal, etj.
EFEKTIVITETI	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i linjave aktive dhe funksionale komunikuese mes komunave dhe Departamentit për Energji të Ministrisë së Energjisë dhe Minerarave • Ngritja e vetëdijes në komuna mbi kërkesat e PKEE-së, të cilat duhet marrë parasysh gjatë planifikimit të projekteve apo hartimit të programeve zhvillimore komunale. • Ngritja e vetëdijes në komuna mbi nevojën për Planifikimin Rajonal të EE-së dhe procesin e monitorimit të tij nga Zyra Lokale e Energjisë (që duhet krijuar gjatë vitit 2011 sipas projektligjit për EE). • Krijimi i një baze të përbashkët të veprimit për hartimin e dokumenteve dhe akteve që kanë të bëjnë me EEP.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Kjo masë nuk ka ndikim direkt në EEP, megjithatë, me të përcaktohen parakushtet organizative për skemën monitoruese të eficientës së energjisë, që do të jetë e rëndësishme në vitet në vijim.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	<p>Trajnime u organizua nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Projekti implementohet nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Reinvest. Pjesëmarrja ishte në nivel të lartë. Gjithsej janë trajnuar 60 zyrtarë komunalë. Kursi u implementua brenda një periudhe 45 ditore, organizuar në ligjëratat pesëorëshe në ditë, në muajt nëntor dhe dhjetor 2008. Ligjërues ishin ekspertë nga fusha të ndryshme të energjisë, ekonomisë, statistikave, menaxhimit të projekteve, njohës të programeve të kursimit të energjisë, etj.</p> <p>Trajnime i dytë u organizua nga programi i BE-së në katër punëtori për 30 ekspertë të 11 komunave. Ky trajnim u fokusua në planifikimin energjetik dhe planin e veprimit për EE në nivel komune. Bazuar në trajnimet në vend të punës u hartua një model i planit të EE-së për sektorin e shëndetësisë në Gjakovë, dhe i njëjti do të shërbejë si model i tregut për komunitetet tjera.</p>

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.5.: KURSI FILLESTAR I TRAJNIMIT PËR AUDITORË TË ENERGJISË (FAZA E PARË) (KODI: KA5)

TITULLI	KURSI FILLESTAR I TRAJNIMIT PËR AUDITORË TË ENERGJISË (FAZA E PARË)
KATEGORIA	ARSIMOR/TRAJNUES
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNJUAR	Ekspertë nga fusha e EE-së nga MZHE, MMPH; ekspertë nga fusha të ndryshme nga sektori privat, të interesuar në trajnime për auditim energjetik.
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Kjo masë ka për tendencë krijimin e bërthamës fillestare të auditorëve të ardhshëm të energjisë. 60 pjesëmarrës janë trajnuar, Trajnimi është implementuar në tri grupe punuese me nga 20 anëtarë. Projekti paraqet një donacion të Komisionit Evropian. Kanë filluar punët paraprake përgatitore në përzgjedhjen e 20 ekspertëve që kanë kaluar trajnimet.
EFEKTIVITETI	Krijimi i tregut të auditorëve të certifikuar të energjisë ofron parakushtet për realizimin e auditimit të energjisë, fillimisht në baza obligative për konsumatorët publikë, e më pas edhe për ndërtesa kolektive banesore, të cilat do duhet të kalojnë nëpër auditim të efijencës së energjisë. Kjo masë do të ndikon në ngritjen e vetëdijes mes konsumatorëve të sektorit të amvisërive, që më pas do të kryejnë auditime të energjisë dhe do të ndërmarrin EEP.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Rezultatet e kësaj mase nuk janë të kuantifikueshme. Rezultatet e punës së auditorëve do të kenë ndikim në masat tjera që përfshijnë realizimin e auditimit të domosdoshëm dhe masat e vlerësimit të specializuar të projektpropozimeve për kredi të EEP, apo projekteve nga institucione dhe agjenci publike që kërkojnë vlerësime të specializuara të efijencës së energjisë, nga këndvështrimi i tenderimit publik. Efekti i aplikimit të auditimit vullnetar të energjisë në sektorin e amvisërive nuk është vlerësuar ende.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Projekti është realizuar mes viteve 2007 dhe 2008, ndërsa ka vazhduar me certifikimin praktik të 50 auditorëve të energjisë që do të ndodh në vitin 2010, me përkrahje teknike të BE-së. Programi i BE-së do të finalizohet në fund të dhjetor 2010 dhe 50 AE-të e parë do të certifikohen nga institucione të BE-së. Kjo masë është e ndërlidhur me disa masa tjera që kanë të bëjnë me stimulimin e auditimit të energjisë, edhe në baza obligative edhe në baza vullnetare.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN
V.2.6.: SHITIMI I NORMËS SË INKASIMIT DHE EFIÇIENCËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE (KODI: KA6)

TITULLI	SHITIMI I NORMËS SË INKASIMIT DHE EFIÇIENCËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE
KATEGORIA	VETËDIJËSUESE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMUNAL
GRUPI I SYNUAR	KONSUMATORËT, KEK, Operatori i Shpërndarjes
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<p>Në periudhën e pasluftës (pas luftës së vitit 1998 – 1999), Kosova është duke u përballë me fenomenin e pagesave jo të rregullta për energjinë elektrike të konsumuar, nga një pjesë e konsumatorëve nga sektori i amvisërive dhe nga disa konsumatorë nga sektori i shërbimeve dhe ai industrial. Më shumë se 30% të energjisë elektrike fare nuk faturohet. Më shumë se 30% të energjisë elektrike të faturuar nuk paguhet nga konsumatorët. Kompania elektroenergetike, KEK, vazhdon të përballët me vështirësi të mëdha në operim, veçanërisht për shkak të pengesave financiare. Ajo ka arritur të mbulojë shpenzimet e veta joteknike kryesisht falë ndihmës së pranuar nga Buxheti i Kosovës dhe donatorët e ndryshëm.</p> <p>Përmirësimi i pagimit të energjisë elektrike do të rezultojë me ndryshim të qasjes nga kjo pjesë e konsumatorëve. Kjo do të rezultojë me shfrytëzim më racional të energjisë elektrike. Sektori i amvisërive shpenzon rreth 60% të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Për të zvogëluar këtë nivel, është e domosdoshme që të eliminohet fenomeni i mospagimit të energjisë elektrike të konsumuar, fenomen ky që pengon zhvillimin dhe funksionimin normal të tregut të energjisë elektrike. Përderisa ky fenomen të përsëritet, do të jetë e pamundshme që të maten efektet konkrete të masave për përmirësimin e efiçencës energjetike, pasi që shtimi i normës së inkasimit do të ketë ndikim në kursim të energjisë megjithëse vetë pagesa nuk është pjesë e masave të përmirësimit të EE-së. Projekti është duke u përkrahur financiarisht nga BE/AER dhe duke u realizuar nga MDA.</p>
EFEKTIVITETI	Efekti i kësaj mase parashihet të ndikojë tek konsumatorët nga sektori i amvisërive për të paguar borxhet e tyre ndaj furnizuesit publik të energjisë elektrike, me qëllim të stabilizimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Realizimi i kësaj mase ka përfunduar ndërsa është e pamundshme të maten efektet e saj. Nuk janë realizuar hulumtime para dhe pas implementimit të kësaj mase, të cilat do të dëshmonin nëse ajo ka pasur ndikim në shtimin e normës së inkasimit (që është një nga rezultatet e pritura).
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Masa është implementuar në vitin 2007. Sidoqoftë, është e rëndësishme që KEK-u të përkrahet nga MZHE-i dhe një grup i donatorëve për të vazhduar këtë program dhe për të arritur që niveli i humbjeve joteknike në vitin 2015 të jetë 5% dhe mospagimi 5%.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.7.: PROMOVIMI I SHFRYTËZIMIT TË GLN-SË NË KUZHINË (KODI: KA7)

TITULLI	PROMOVIMI I SHFRYTËZIMIT TË GLN-SË NË KUZHINË
KATEGORIA	STUDIM VLERËSUES DHE FUSHATË VETËDIJËSUESE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	KONSUMATORË NGA SEKTORI I AMVISËRIVE DHE SHËRBIEMEVE (HOTELIERE, SHËNDETËSORE, ETJ.) QË JANË KONSUMATORËT MË TË MËDHENJ TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR NEVOJA TË GATIMIT
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Studimi i gjendjes aktuale dhe mundësive për zëvendësimin e energjisë elektrike me GLN. Kjo është bërë me qëllim të identifikimit të politikave dhe masave që do ta mundësojnë këtë zëvendësim. Ky studim pritet të rezultojë me kurseme të energjisë elektrike në përgjithësi, dhe burimeve të energjisë (kursimi i thëngjillit që shfrytëzohet për të prodhuar energjinë elektrike) në veçanti.
EFEKTIVITETI	Sektori i amvisërive shfrytëzon një sasi të caktuar të energjisë elektrike për nevoja të kuzhinës, që arrin në rreth 25% të energjisë elektrike të shfrytëzuar nga sektori. GLN nuk gëzon përdorim të gjerë, megjithëse shfrytëzimi i të njëjtit për të plotësuar nevojat e mësipërme veç ka filluar. Zëvendësimi i energjisë elektrike me GLN do të ndikojë në zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike dhe të shpenzimeve gjegjëse. Për më tepër, shfrytëzimi i gjerë i GLN-së për gatim do të zvogëlojë nivelin e ndotjes (në veçanti të SO ₂ , pluhurit – materieve të ngurta dhe CO ₂). Kur e dimë se në Kosovë energjia elektrike prodhohet kryesisht përmes djegies së injiit, dhe që efienca e termocentraleve është relativisht e ulët, duke qenë se Kosova A funksionon me 29% dhe Kosova B me 34% të kapaciteteve, kjo çështje bëhet edhe më e rëndësishme.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Pas implementimit të rekomandimeve që rrjedhin nga studimi, pritet që të ketë kursim të theksuar të energjisë elektrike dhe burimeve që shfrytëzohen për ta prodhuar atë nga gatimi, ndërsa jemi të vetëdijshëm për faktorët përcjellës që karakterizojnë shfrytëzimin e GLN-së si lëndë djegëse. Kursimet vjetore të energjisë pritet të jenë 0.5 ktoe. Deri në fund të vitit 2011 pritet që kursimi të jetë 1 ktoe, ndërsa deri në fund të vitit 2017 kursimi do arrin 7 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Projekti është implementuar gjatë vitit 2009, por është e rëndësishme të theksohet se ky proces do të vazhdojë gjatë viteve 2011-2012 në mënyrë që të arrihet vetëdijësimi adekuat nëpër amvisëri.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.8.: RREGULLORJA TEKNIKE PËR PERFORMANSËN ENERGETIKE TË NDËRTESAVE (KODI: KA8)

TITULLI	RREGULLORJA TEKNIKE PËR PERFORMANSËN ENERGETIKE TË NDËRTESAVE
KATEGORIA	RREGULLATIV/NORMATIV
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	Pronarët e ndërtesave, ekspertët e projektimit, auditorët e energjisë, shoqatat e arkitektëve dhe ndërtimtarëve, prodhuesit e materialeve ndërtimore
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<p>Kosova ka përgatitur Udhëzimin Administrativ për aktet ligjore që mbulojnë çështjen e performansës energjetike në ndërtesa të reja dhe të rehabilituara. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të nenit 12 të Ligjit të Ndërtimit Nr. 2004/15 të datës 27 maj 2004, dhe nenit 1, paragrafi 1.3, pika (ç) të Rregullores mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë Nr. 2001/19, të datës 13 shtator 2001, me qëllim të kursimit të energjisë termale dhe mbrojtjes termale të ndërtesave të shpalli si në vijim: Rregullore teknike mbi kursimin e energjisë termale dhe mbrojtjen termale të ndërtesave të reja në Kosovë. Kjo Rregullore teknike rregullon kushtet teknike për kursimin e energjisë termale dhe mbrojtjen termale. Kushtet kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1. projektet ndërtimore të ndërtesave të reja, dhe 1.2 projektet e adaptimit dhe rindërtimit të ndërtesave ekzistuese me temperaturë të brendshme të ngrohjes prej më shumë se 12°C.
EFEKTIVITETI	<p>Kjo Rregullore rregullon specifikimet teknike dhe specifikimet tjera të mallrave ndërtimore që shfrytëzohen për ndërtim dhe qëllimin e kursimit të energjisë termale dhe mbrojtjes termale.</p> <p>Kjo masë do të rregullojë edhe më tej çështjen e pajtueshmërisë së ndërtesave me EE, duke rregulluar të gjitha shërbimet brenda një ndërtese që konsumojnë energji, siç janë ngrohja e hapësirave, ftohja e hapësirave, uji i ngrohtë, ndriçimi dhe pajisjet e gatimit dhe elektronike. Ajo do të mundësojë konsumin e kontrolluar të energjisë në ndërtesa dhe përmirësimin e performansës së tyre. Ajo gjithashtu do të rregullojë certifikimin e ndërtesës për pajtueshmërinë energjetike, që rjedh nga performansa energjetike e saj. Sa i përket sektorit të amvisërve, auditimi energjetik dhe certifikimi i ndërtesave do të paraqesë një proces të dëshirueshëm dhe vullnetar, që fillimisht do të trajtojë ndërtesat shumëkatëshe që kanë sipërfaqe të përgjithshme të banimit prej më shumë se 1000 m².</p>
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, dhe me implementimin e plotë të saj, besohet se do të arrihen rezultate të rëndësishme. Këto rezultate priten gjatë vitit 2011. Sasia e energjisë së kursyer në baza vjetore mund të matet pasi që të jenë implementuar masat e përmirësimit të EE-së në sektorin e amvisërve, si dhe në ndërtesat e sektorit të shërbimeve (lufta në lehtësi të lehtë) të lexoni më shumë për këtë në kapitullin gjegjës)
STATUSI I IMPLEMENTIMIT DHE AFATET KOHORE	Rregullorja pritet të hyjë në fuqi në vitin 2010, ndërsa implementimi i saj mund të fillojë në vitin 2011.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN
V.2.9.: KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË (LEE) (KODI: KA9)

TITULLI	KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË (EEL)
KATEGORIA	LEGISLACION/IRREGULLATIV/ORGANIZATIVE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	Institucionet, organizatat dhe agjencitë, ndërmarrjet energjetike, shërbimet energjetike, operatorët e sistemit të shpërndarjes, auditorët e energjisë, shërbimet e prokurimit.
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Të gjitha aktivitetet e ndërmarrja dhe planifikuara për të ardhmen që kanë të bëjnë me efijencën e energjisë bazohen në Ligjin për Energjinë (deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Efijencë të Energjisë), i cili adreson dhe rregullon çështjen e efijencës së energjisë. Mungesa e një Ligji për EE ka rezultuar me pengesa të shumta që kanë të bëjnë me zhvillimin e kornizës institucionale. Ky ligji do të rregullojë në mënyrë shumë më të detajuar sferën e EE. Ky ligji gjithashtu do të përcaktojë autorizimet e organeve të ndryshme shtetërore, organizatave dhe agjencive që punojnë në sferën e EE, në veçanti të Fondit për EE.
EFEKTIVITETI	Miratimi i LEE do të rezultojë me fuqizim të mëtejshëm të fushës së EE nga këndvështrimi ligjor, institucional dhe organizativ. Ai do të mbulojë të gjithë sektorët konsumues të energjisë. Gjithashtu, ligji do të përcaktojë mekanizmat për aplikimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave për përmirësim të efijencës së energjisë.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Rezultatet lidhen me masat konkrete që do ndërmerren gjatë implementimit të ligjit.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Ligji planifikohet të hyjë në fuqi gjatë vitit 2011. Gjithashtu, gjatë vitit 2011 do të themelohet Agjencia për Efijencë të Energjisë, edhe në kuptimin funksional edhe në atë organizativ.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.10.: PROMOVIMI I EFIÇIENCËS ENERGJETIKE NË AMVISËRI (KODI: KA10)

TITULLI	PROMOVIMI I EFIÇIENCËS ENERGJETIKE NË AMVISËRI
KATEGORIA	FINANCIARE/KREDI ME KUSHTE TË LEHTËSUARA (KREDI TË BUTA)
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	Konsumatorët nga sektori i amvisërive dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shërbyese dhe konsumatorët industrialë.
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Me qëllim të promovimit të Eficiencës së Energjisë në Sektorin e Amvisërive dhe Sektorin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Banka Gjermane për Zhvillim ka siguruar një kredi prej 10 milion euro për projekte që bazohen në shfrytëzimin eficient të energjisë. Kreditë kanë filluar në prill të vitit 2009 në RBKO, ndërsa faza e dytë do të fillojë vitin e ardhshëm me ProCredit Bank Kosovë, me qëllim të lehtësimit të kushteve të kredive (kredi të buta). Kreditë parashihen se do të ofrohen përmes bankave Raiffeisen dhe ProCredit gjatë një periudhe pesëvjeçare (2009-2014). Sektorët e amvisërive dhe NVM-ve do të jenë përfituesit kryesorë të masave të EE për izolimin e mureve të shtëpive dhe kulmeve të tyre, si dhe për izolimin e detyrë dhe dritareve, instalimin e sistemeve solare për ngrohje të ujit për nevoja sanitare dhe masave tjera të eficiencës së energjisë. Lista e masave të EE që do të përkrahjet me këto kredi të buta do jetë në dispozicion edhe të NVM-ve dhe do të diskutohet me sektorin e shërbimeve dhe atë të industrisë.
EFEKTIVITETI	Përmirësimet e eficiencës së energjisë në ndërtesa rezidenciale, si dhe ngritja e vetëdijes mbi masat e kursimit të energjisë nga shfrytëzimi i materialeve dhe pajimeve izoluese.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Projekti pritet të zbatohet mes 2009-2014, ndërsa efektet e kursimit të energjisë kanë filluar të ndihen që në vitin 2010. Deri tani, RBKO ka ndarë rreth 4.2 milion euro ndërsa ProCredit rreth 3.5 milion euro për tre sektorët: amvisëri, shërbyes privat dhe industrial.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Kjo masë pritet të zbatohet bazuar në kritere adekuate dhe kompakte që përcaktohen me qëllim të përmirësimit të eficiencës së energjisë.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.11.: KRIJIMI I NJË SISTEMI TË CERTIFIKIMIT TË AUDITORËVE TË ENERGJISË (KODI: KA 11)

TITULLI	ZHVILLIMI I NJË SISTEMI TË CERTIFIKIMIT TË AUDITORËVE TË ENERGJISË
KATEGORIA	RREGULLATIV/NORMATIV
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNJUAR	AUDITORËT, ESCO, KONSULENTËT, ETJ.
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Certifikimi i auditorëve të energjisë, pas kryerjes së trajnimeve speciale dhe regjistrimi i tyre në regjistrin zyrtar. Ky trajnim është përkrahur përmes programit të BE-së për asistencë teknike për 50 AE të parë, proces ky që do të kryhet në mes të dhjetorit 2010. Edhe Komisioni Certifikues do të përkrahët nga GTZ.
EFEKTIVITETI	Krijimi i parakushteve për kryerjen e auditimit vullnetar energjetik nga shoqata e konsumatorëve të sektorit të arvisërive (shoqatat banesore) sipas kushteve të caktuara. Sigurimi i përkrahjes për institucionet publike në përgatitjen e dokumentacionit teknik të prokurimit për projekte kapitale në cakimin e kritereve të EE.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Kjo masë është masë përkrahëse për masat tjera që kanë për qëllim stimulimin e auditimit energjetik. Rezultatet e kësaj do të përcaktohen si masa nxitëse për auditim vullnetar energjetik në sektorin e arvisërive.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Kjo masë është implementuar gjatë vitit 2010, me certifikimin e 50 AE-ve të parë, ndërsa në vitet vijuese do zbatohet duke kryer auditimet energjetike para ndërtimit të ndërtesave publike dhe ndërtesave kolektive banesore.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.12.: FUSHATA PUBLIKE PËR KURSIMIT E ENERGJISË DHE PËRMIRËSIMET E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (KODI: KA 14)

TITULLI	FUSHATA PUBLIKE PËR KURSIMIT E ENERGJISË DHE PËRMIRËSIMET E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË
KATEGORIA	ARSIMORE/INFORMATIVE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	KONSUMATORË NGA TË GJITHË SEKTORËT
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Implementimi i fushatave vetëdijesuese të fokusuarra, me karakter informativ dhe arsimor, në lidhje me kursimin e energjisë dhe masat e përmirësimit të EE. Projekti parashihet të zbatohet brenda një kohe kohore trevjeçare (2009-2011). Projekti për vitin 2009 është financuar nga MZHE-i ndërsa për vitin 2010 është financuar nga programi i BE-së dhe do të finalizohet në mes të dhjetor 2010.
EFEKTIVITETI	Ngritja e vetëdijes mes konsumatorëve, përfshirë konsumatorët nga sektori i amvisërive, mbi efektet e shumta të kursimit të energjisë dhe njohuritë mbi metodat dhe mënyrat e kursimit të energjisë.
KURSIMIT E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	3-4% nga energjia elektrike e konsumuar nga sektori i amvisërive. Kursimet e pritura në vitin 2012 arrijnë 4.85 ktoe. Deri në fund të vitit 2018 pritet të kursehen 17.64 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Kjo masë është implementuar që nga viti 2010, ndërsa rezultatet e kësaj mase do të jenë të dukshme në tri vitet vijuese. Strategjia dhe plani i detajuar i fushatës janë miratuar si dokumente të ndara, që marrin parasysh veçantitë e secilit sektor ekonomik (i amvisërive – me fokus special, shërbimeve, industria/NMV, etj.).

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.13.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR NGROHJEN E NDËRTHESAVE TË REJA KOLEKTIVE BANESORE (KODI: KA13)

TITULLI	UA PËR NGROHJEN E NDËRTHESAVE TË REJA KOLEKTIVE BANESORE
KATEGORIA	RREGULLATIVE / NORMATIVE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	KONSUMATORËT PUBLIKË DHE PRIVATË, NDËRMARRJET ENERGJETIKE, MENAXHERËT NË FUSHËN E ENERGJISË, NDËRMARRJET NDËRTIMORE, INSPEKTORATI NDËRTIMOR (QENDROR DHE LOKAL)
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi, diskutimi dhe miratimi i dokumentit • Ndërtimi i kapaciteteve institucionale të implementuesve • Përkrahja e entiteteve që i nënshtrohen këtij udhëzimi
EFEKTIVITETI	<p>UA mbi ngrohjen e ndërthësive të reja kolektive banesore do të mundësojë menaxhimin e konsumit të energjisë në ato ndërtesa; do të përcaktojë kriteret e reja për ngrohje të hapësirave në këto objekte dhe do të obligojë konsumatorët që të mos shfrytëzojnë energjinë elektrike por të përzgjedhin alternativa tjera për ngrohje.</p> <p>Ky veprim do të stimulojë pronarët e ndërthësive të reja banesore që të kërkojnë alternativa për sigurimin e ngrohjes për konsumatorët e tyre. Mes këtyre alternativave përfshihen ngrohja qendrore, ngrohja për objektin banesor si dhe pajisjet e vogla e të mëdha të bashkëgjenerimit (si projekti i bashkëgjenerimit nga Kosova B) për prodhimin e ngrohjes dhe energjisë elektrike njëkohësisht.</p>
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	<p>Duke shfrytëzuar burime tjera (jo energji elektrike), nëpër amvisëri, shërbime dhe sektorë tjerë, do të kursehet energjia elektrike. Kursimet e energjisë mund të vlerësohen pas implementimit të kësaj mase, efektet e së cilës do të jenë të dukshme në vitin 2010. Alternativa më bazike e kësaj mase është implementimi i ngrohjes së decentralizuar. Sipas të dhënave të parashikuara, pritet të ndërtohen 3200 banesa të reja për çdo vit. Për momentin, ndërtesat e reja në masë shumë të vogël kycen në sisteme të ngrohjes qendrore. Kjo masë do të ndihmojë në shumë drejtime: do të shtojë efikasitetin energjetike, do të përforcojë implementimin e UA-së mbi humbjet termike në ndërtesa, dhe do të zvogëlojë emetimet e gazrave serre.</p>
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	UA për ngrohjen e Ndërthësive të Reja Kolektive Banesore mund të pritet të miratohet në vitin 2011.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.14.: REFORMAT E LEGJISLACIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK QË SJELLIN PËRFITIME PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (KODI: KA14)

TITULLI	REFORMAT E LEGJISLACIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK QË SJELLIN PËRFITIME PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË
KATEGORIA	KOOPERATIVE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNUAR	INSTITUCIONET QENDRORE DHE LOKALE DHE NDËRMARRJET PUBLIKE QË FUNKSIONOJNË NË BAZË TË ALOKIMEVE BUXHETORE
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Avancimi i legjislacionit dhe praktikave të prokurimit duke caktuar kritere për përmirësimin e efijencës së energjisë. Synimi është që të përdoret sektori publik si shembull për kursim të energjisë dhe përmirësim të efijencës së energjisë.
EFEKTIVITETI	Transformimi i legjislacionit të prokurimit publik dhe përshtatja e tij me kërkesat dhe kriteret e Efijencës së Energjisë do të ketë ndikim në përmirësimin e EE-së në sektorin publik dhe do të sigurojë menaxhim efektiv të fondeve. Sektori publik do të paraqes shembull për masat efikase dhe praktikat më të mira në fushën e efijencës së energjisë.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Rezultatet nuk janë të matshme në aspekt afatmesëm 2010-2018
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Planifikimi në vitin 2010, plotësimet dhe ndryshimet në vitin 2011. Efektet reale të kësaj mase priten në vitin 2011 dhe do të vazhdojnë përgjatë tërë periudhës, deri në vitin 2018.

KOSOVO ENERGY EFFICIENCY PLAN

V.2.15.: STIMULIMI I SHFRYTËZIMIT TË SISTEMEVE SOLARE PËR NGROHJEN E UJIT PËR NEVOJA SANITARE (KODI: KA15)

TITULLI	STIMULIMI I SHFRYTËZIMIT TË SISTEMEVE SOLARE PËR NGROHJEN E UJIT PËR NEVOJA SANITARE
KATEGORIA	FINANCIARE/ARSIMORE
NIVELI I ZBATIMIT	KOMBËTAR
GRUPI I SYNJUAR	KONSUMATORËT E SEKTORIT TË AMVISËRISË
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Instalimi i sistemeve të energjisë solare për ngrohjen e ujit për nevoja sanitare në katër klinika spitalore të QKUK në Prishtinë dhe në njërin konvikt studentor në fillim të vitit 2010 është dëshmuar të jetë shembull i suksesshëm dhe është bazuar në përkrashjen financiare nga MZHE-(ish MEM). Këta shembuj tjerë të kursimit të energjisë do të shfrytëzohen për të stimuluar shfrytëzimin e sistemeve të energjisë solare për ngrohje të ujit për nevoja sanitare në sektorin e amvisërisë. Në vitin 2010 janë në proces të instalimit edhe sisteme të energjisë solare për ngrohje të ujit për nevoja sanitare në stabilimente tjera publike (donacion nga Komisioni Evropian).
EFEKTIVITETI	Kjo masë ndikon në zvogëlimin e konsumit të energjisë për qëllime të ngrohjes së ujit për nevoja sanitare, zvogëlimin e koslos së prodhimit të energjisë, zvogëlon normën e emetimit të CO ₂ , dhe shton gjasat për arritjen e Ceqeve Indikative për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
KURSIMET E PRITURA NË VITIN 2011 DHE 2016	Kursimi vjetor i energjisë do të jetë 0.03 ktoe. Deri në fund të vitit 2012, kursimet do të arrijnë në 0.06 ktoe, ndërsa deri në fund të vitit 2018 0.24 ktoe. Sistemet e energjisë solare për ngrohje të ujit dhe sistemet e ardhshme fotovoltaike do të ndihmojnë në plotësimin e nevojave energjetike për kohë të pikut gjatë verës, dhe do të kenë ndikim (përkrash zvogëlimi të konsumit final të energjisë) në zvogëlimin e humbjeve teknike të energjisë elektrike në sistemet e bartjes, shpërndarjes dhe prodhimit.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Projekti i MZHE-(ish MEM) ka filluar në nëntor të vitit 2008 dhe është përmbyllur në shkurt të vitit 2010. Tri sisteme tjera solare me sisteme të integruara për ngrohje qendrore janë në fazat e fundit të instalimit në dy shkolla dhe një spital. Efektet do të maten në vitin 2012, pas së paku një vit monitorimi.

Kapitulli VI. Sektori i shërbimeve

Sektori i shërbimeve përfshin ndërtesat qeveritare (lokale dhe qendrore), objektet arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive (publike dhe private) dhe hoteliere, ndërmarrjet tregtare, ofruesit e shërbimeve, etj. Siç u përmend në analizën e mësipërme, ky sektor përbën rreth 13% të konsumit total energjetik të Kosovës.

Parashikimi i mundësive për përmirësim të efiçencës së energjisë është 30% nga gjithsej kursimet për periudhën 2010-2012. Këto vlerësime janë bërë duke marrë parasysh faktin që më 2010 është planifikuar që të nisët zbatimi i aktit nënligjor për auditim të energjisë (Udhëzimi Administrativ), i cili obligon ndërmarrjet publike të kryejnë auditim të energjisë dhe të ndërmarrin masa për kursim të energjisë në pajtim me rekomandimet e auditorëve. Sektori publik i shërbimeve gjithashtu përfshin instalimin e objekteve pilot për EE, të cilat do të ndërmarrin masa të efiçencës që do të ndikojnë në PEE.

Meqë është kërkesë e qartë e Direktivës 2006/32/EC që sektori publik i shërbimeve duhet të merr përsipër një rol të rëndësishëm udhëheqës, duke u paraqitur si shembull i parë për të gjithë sektorët tjerë pasues, është vlerësuar që sektori publik i shërbimeve ka një potencial të konsiderueshëm për kursime të energjisë në të ardhmen në Kosovë. Është me rëndësi që t'i kushtohet vëmendje e veçantë uljes së kërkesës për energji dhe karburant. Janë bërë ndryshime në uljen e intensiteteve të energjisë dhe në strukturën e furnizimit të burimeve të energjisë, për secilin shërbim. Janë paraparë masa të ndryshme, siç janë zbatimi i pagesave të energjisë, rritja në çmimet e energjisë elektrike bazuar në koston e shërbimit (duhet të mbulohet i tërë zinxhiri i koston, përfshirë mihjet, prodhimin, importin, bartjen, shpërndarjen dhe hapat e pakicës), zbatimi i kodeve të energjisë në ndërtesa në stoqet private dhe publike të ndërtesave, aplikimin e masave fiskale stimuluese për investime në burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe burimet tjera efektive të energjisë, fushata të vetëdijesimit, etj.

Masat më të rëndësishme janë si në vijim:

- Zbatimi i pagesave të energjisë elektrike për të gjitha nënkategoritë e ndërtesave private dhe publike;
- Depërtim i fuqishëm i mazutit për ngrohje për të përmbushur kërkesën për ngrohje të hapësirave dhe ngrohje të ujit, për ta përdorur në vend të energjisë elektrike, gjë e cila do ta mbështesë sistemin e energjisë dhe kursimet e energjisë si burime primare të energjisë;
- Depërtim i thellë i GLN-së për ngrohje të hapësirave dhe gatim në ndërtesat e vogla private dhe publike shërbyese;
- Përmirësim i izolimit termik në ndërtesat ekzistuese publike dhe private të sektorit të shërbimeve dhe aplikimi i rreptë i Kodit të ri të Energjisë në Ndërtim (i titulluar në Kosovë – Udhëzimi Administrativ për Rregullimin e Humbjeve termike në ndërtesa) për ndërtesat e reja të sektorit të shërbimeve;
- Shtrirje e përdorimit të paneleve solare për përgatitje të ujit të nxehtë në ndërtesat publike dhe komerciale në sektorin e shërbimeve;
- Futja e skemës së CHP (kombinimit të ngrohjes dhe energjisë) për Kosovën B për të mbuluar hapësira më të mëdha të Prishtinës dhe për këtë projekt është financuar një studim i fizibilitetit nga ana e KfW Bank, e cila edhe mund të financojë këtë investim.
- Futja graduale e impianteve të vogla të kombinuara të ngrohjes dhe energjisë (SSCHP naftë) dhe skemave të ngrohjes qendrore për konsumatorët e mëdhenj dhe të vegjël (spitalet, konviktet, hotelet, etj), veçanërisht përmes zëvendësimit të sistemeve ekzistuese konvencionale;
- Realizimi i Auditimeve të Energjisë në ndërtesat publike dhe private të sektorit të shërbimeve (spitale, konvikte, hotele, etj) dhe qendrave komerciale dhe hoteliere;
- Rritje e efiçencës në ndërtesat publike dhe private të sektorit të shërbimeve përmes masave të tjera të ndryshme, siç janë rritja e përdorimit të ndriçimit fluoreshent, futja e teknikave inteligjente elektronike, përdorimi i pajisjeve moderne elektrike me kosto të përmirësuar, në pompa, frigoriferë, etj, për konsumatorët të ndryshëm të sektorit të shërbimeve.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Tabela 15: Konsumi i energjisë nga ana e Sektorit të Shërbimeve në vitet 2003-2008, e shprehur në ktoe.

Sektori i shërbimeve	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Pjesëmarrja në konsum	137.69	131	146	149	130.1	143.3

Tabela 16: Llojet e burimeve të energjisë dhe pjesëmarrja e tyre në konsumin e energjisë në Sektorin e shërbimeve, gjatë 2003-2008

Pjesëmarrja e burimeve energjetike në Sektorin e shërbimeve ktoe	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Thëngjill	6.17	2.92	5.16	4.76	4.32	4.45
Produkte të naftës	40.48	34.43	43.89	45.40	39.93	41.21
Biomasë	54.08	54.08	54.08	54.08	54.08	54.80
Energji elektrike	34.23	36.09	38.99	40.48	28.34	30.00
Energji solare	0.02	0.03	0.03	0.04	0.04	0.05
Ngrohje qendrore	2.71	3.11	3.97	4.17	3.41	3.79
Gjithsej	137.69	130.66	146.12	148.93	130.12	134.30

Në figurat 15 dhe 16 janë përmbledhur kursimet relative dhe absolute të energjisë të dhura për sektorin e shërbimeve për t'i arritur objektivat e përkufizuar në pjesët e sipërpërmendura.

Figure 15: Caqet afatshkurte dhe afatgjate për EE për sektorin e shërbimeve në %





Figura 16: Gjithsej kërkesa për energji pas zbatimit të masave të EE në sektorin e shërbimeve dhe kursimeve absolute të EE në (ktoe)



PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Tabela 17: Masat për përmirësimin e Efiçiensës së energjisë (EE) në Sektorin e Shërbimeve

KODI	TITULLI	GJENDJA	LLOJI	VITI I FILLIMIT	VITI I PËRFUNDIMIT	REZULTATI	Kursimi të energjisë (toe)	Kostoja e zbatimit (Euro)	Indikatorët e monitorimit	IMPLEMENTUESIT
KS1	UA për etiketimin e pashijeve elektrike për zyra	Miratur por implementimi nuk ka filluar	rregullative / normative	2010	2018	Zbatimi i këtij Udhezimi duhet të paraqesë rezultatet e para pas tri viteve (2010-2012)	2357	Buxheti është përfshirë në amvisëri Buxheti është përfshirë në amvisëri	UA është përgatitur	MZHE, MTI, Tregtarët, MEF/Doganat, donatorët
KS2	UA për Auditim të Energjisë	Miratur	rregullative / normative	2010		Zbatimi i rekomandimeve të Auditimit të Energjisë mundëson parakushtin për kursime të energjisë në Sektorin e shërbimeve.	3536	Buxheti është përfshirë në amvisëri	UA është përgatitur	MZHE, MASHT, GTZ, AER, UNIVERSITETI, KOMPANITË E ENERGJISË, ASOCIACIONET,
KS3	UA për promovimin e efiçiensës së energjisë për konsumatorët e fundit	Miratur	rregullative / normative/informative	2010	Në vazhdim e sipër	Ndërlidhet me të gjitha masat e EE-së të ndërmarra në Sektorin e Shërbimeve	1571	Buxheti është përfshirë në amvisëri	UA është përgatitur	INSTITUCIONET, OPERATORËT E ENERGJISË
KS4	Ngritja e kapaciteteve komunale për menaxhim të projekteve dhe auditim të energjisë (faza e parë)	Përfunduar	edukim / trajnim	2007	2007	Nuk ka vlerësim		1891141	60 Auditorë të energjisë të trajnuar nga RIINVEST dhe 30 nga Programi i BE-së	MZHE, BE, Riinvest
KS5	Auditim i energjisë në nivel komunal (faza e parë)	Përfunduar	edukim / trajnim	2008	2008	Nuk ka vlerësim	2750	1470887		MZHE, BE, eksperi të sektorit private
KS6	Rritje e shkallës së inkasimit dhe efiçiensës së energjisë	Përfunduar	edukim / informim	2007	2007	Nuk ka vlerësim	3929	Buxheti është përfshirë në amvisëri		MDA
KS7	Promovimi i efiçiensës së energjisë në nivel komunal	Përfunduar	financa/ edukim dhe informim	2006	2008	GTZ ka realizuar 40 projekte të IEE në objekte të ndryshme publike të shërbimeve (shkolla, spitale, ndërtesa komunale, etj.). Vlerësimi i kësaj mase ka rezultuar me kursime vjetore të energjisë prej 4.6 GWh apo 0.39 ktoe, dhe 14 GWh apo 1.20 ktoe në	2750	Buxheti është përfshirë në amvisëri		Komunal, GTZ,

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISJË

KS8	Promovimi i GLN-së për përbushje të kërkesës së energjisë për gatim	Studim	Edukim	2009	2011	Eshhtë vlerësuar që fushata e vetëdijesimit do të rezultojë me kursime të energjisë prej afro 1% të konsumit total të energjisë të përdorur për gatim që përbën rreth 25% të energjisë që aktualisht përdoret për këtë qëllim	1964	Buxheti është përfshirë në amvisëri	MZHE, MTI,
KS9	Rregullore teknike për performancën energjetike në ndërtesa	Draft	rregulative / normative	2007	Miratimi më 2009; zbatimi deri më 2018	Rregulltorja pritet të prodhojë rezultate pas fillimit të zbatimit	2357	Buxheti është përfshirë në amvisëri	MZHE, MASHT, Komunal
KS 10	Ligji për EE	Draft	rregulative / normative	2008	Miratimi më 2011; zbatimi deri më 2018	Outputet janë të ndërlidhura me të gjitha masat e përgjithshme të IEE	1964	Buxheti është përfshirë në amvisëri	MZHE, Institucionet (Qendrore dhe lokale)
KS 11	Promovimi i EE në NVM	Kontraktuar	financa/ kredit me kushte më të mira (kredit të buta)	2009	2014	Fonde të dedikuara nga KfW për qëllime të EE në Amvisëri dhe NVM në Kosovë (10+10 milionë Euro). Zbatimi i kësaj mase ka filluar dhe RBKO dhe ProCredit Ko janë duke financuar projekte në amvisëri (siç u cek më lart) si dhe në NVM (duke përfshirë ndërtesa private në sektorin shërbimeve) KfW është në programim të fillimit të një linje të re të kredive të buta me komuna të ndryshme për financimin e të gjitha masave që kanë të bëjnë me EE. BE-ja, në anën tjetër, do të ofrojë asistencë teknike për këtë qëllim.	3143	2009908	Institucionet (Qendrore dhe lokale), KfW, GTZ, Raiffeisenbank
KS12	Themelimi i bazës së sistemit për certifikim të auditorëve	Kontraktuar	Financa	2009	2009	Më 2008, MZHE(ish MEM), me mbështetje të AER-it, organizoi një kurs trajnimi për fillestarë për 60 specialistë në auditimin e energjisë. Më 2010 niveli i dytë i trajnimit pasoi me certifikimin e afro 50 auditorëve të energjisë. Ky trajnim është financuar nga BE-ja.	1964	Buxheti është përfshirë në amvisëri	MZHE, GTZ, Kompanitë e energjisë, ekspertë të sektorit privat

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

KS13	Fushatë publike për kursim të energjisë dhe IEE, përmes ndiçimit efikas	Planifikuar	Financiar / edukim	2009	2011	Pritet që sektori i shërbimeve do të kursejë një sasi të caktuar të energjisë së konsumuar në këtë sektor	1964	Buxheli është përfshirë në amvisëri	ME: Institucionet qeveritare (Qendrore dhe lokale); donatorët
KS14	Transformimi i legjislacionit të prokurimit publik në të mirë të përmirësimit të EE	Planifikuar	rregullative / informative	2010	2010	Outputet varen nga masat tjera të ndërmarra.	1571	40000	MEF, Parlamenti,
KS15	Stimulimi i përdorimit të sistemeve të paneleve solare për ngrohje të ujit sanitar	Planifikuar	rregullative / financiare/ edukative	2010	2016	MZHE(ish MEM) dhe institucionet tjera qeveritare kanë realizuar disa projekte demonstruese në lidhje me përdorimin e energjisë solare për ngrohje të ujit sanitar. Këto masa janë zbatuar në institucione publike. Këta hapa janë planifikuar për vitet në vijim, me synim të afirmimit të rëndësisë së Energjisë Solare dhe shndërrimin e sektorit të shërbimeve në lider të kësaj fushe.	1964	1187673	MZHE; Institucionet qeveritare (Qendrore dhe lokale); konsumatorët e sektorit të shërbimeve, donatorët
KS16	Përmirësimi i EE përmes ndiçimit efikas në ndërtesat publike	Planifikuar	Edukative/ rregullative	2010	2018	Kjo masë e IEE do të përqendrohet në ndiçimin efikas në ndërtesat e institucioneve publike. Kjo masë do të mbështetet me rregulloret përkatëse që përcaktojnë formën efikase në ndërtesat e institucioneve të sektorit të shërbimeve, për ta bërë këtë sektor model pozitiv.	1964	639516	MZHE; Institucionet qeveritare (Qendrore dhe lokale); donatorët
KS17	Ndiçim efikas publik	Planifikuar	Edukative/ vetëdijësim	2011	2016	Ndiçimi efikas i rrugëve dhe shesheve duhet të bëhet në qytetet më të mëdha në vend. Kjo masë do të paraprihet me një projekt demonstrues të digitalizimit të ndiçimit publik, i cili do të bëhet në një qytet në Kosovë.	1964	639516	
KS18	Përmirësimi i EE në pajisjet për ngrohje në Sektorin e shërbimeve	Planifikuar	Edukative/ vetëdijësim	2010	2016	Instalimi i makinerisë ekzaminuese (potenciometër etj.) në pajisjet për ngrohje në sektorin e shërbimeve (stufa termale, radiatorë).	39285	7239125	

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISË

VI. 1. MASAT INDIVIDUALE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGISË NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE

VI.1.1. UDHËZIMI I ADMINISTRATIV PËR ETIKETIMIN E PAJISJEVE SHËRBYESE ELEKTRIKE (KODI: KS1)

TITULLI	UA PËR ETIKETIMIN E PAJISJEVE ELEKTRIKE PËR ZYRA
KATEGORIA	LEGJISLATIVE/INFORMUESE
Niveli i aplikimit	NACIONAL
Grupi i cakut	KONSUMATORËT E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE, FURNIZUESIT E PAJISJEVE ELEKTRIKE PËR ZYRA, TREGTARËT DHE PRODHUESIT
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Dizajnimi i etiketave dhe krijimi i një sistemi të inspektimit për pajisjet elektrike për zyra. Në veçanti, synim është krijimi i shembullit të përsosur të furnizimit të pajisjeve elektrike për zyra me skema të etiketimit. Do të përcaktohen kritere të qarta për institucionet qeveritare qendrore dhe lokale dhe ndërmarrjet e shërbimeve komunale që shërbehen me pajisje të etiketuara me efijencë të lartë të energjisë. Do të ketë udhëzues të qartë (doracak) për përdorim për prokurimin e të gjitha institucioneve dhe ndërmarrjeve.
EFEKTIVITETI	Informimi i konsumatorëve të sektorit të shërbimeve për cilësinë e EE dhe kategorinë e pajisjeve të tyre elektrike shtëpiake dhe të kuzhinës. Ofrimi i mundësisë së përzgjedhjes së pajisjeve efikase.
KURSIMET E PRITURA MË 2011 DHE 2016	Kjo masë duhet të rezultojë me Kursime të caktuara të energjisë, efektet e së cilës do të vërehen pasi që masa të ketë filluar së zbatuari.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	UA është nënshkruar më 2008. Zbatimi i saj do të filloj më 2010, duke krijuar rezultate.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË

VI.1.2.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR AUDITIM TË ENERGIJË (KODI: KSH2)

TITULLI	UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR AUDITIM TË ENERGIJË
KATEGORIA	LEGJISLATIVE/INFORMATIVE
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	Disa kategori të konsumatorëve të fundit dhe auditorë të energjisë
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEEË	<ul style="list-style-type: none"> • Nxitja e certifikimit të auditorëve • Nxitja e auditimit të ndërtesave me mbi 1000m², • Themelimi i sistemit të monitorimit për zbatim të UA për auditimet e obligueshme
EFEKTIVITETI	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i kushteve për certifikim të auditorëve. • Themelimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të auditorëve të certifikuar. • Themelimi i tregut të auditorëve të certifikuar, krijon kushtet për vlerësimin e Eficiencës së energjisë në një grup të ndërtesave publike me kërkesa të obligueshme për auditim të energjisë në periudha të caktuara. • Certifikimi i auditorëve ofron mundësinë për auditim profesional, duke përfshirë zbatimin e udhëzimit administrativ me kërkesa të obligueshme për auditime periodike për grupe të caktuara; • Certifikimi i auditorëve krijon kushtet për të pasur vlerësim më të mirë të projekteve që mundësojnë kredi të leverdshme për eficiencë të energjisë • Krijimi i kushteve për mbështetje profesionale për ofertat dhe hartuesit e dokumentacioneve të ofertave të sektorit publik në lidhje me kërkesat për përmirësim të eficiencës së energjisë, veçanërisht projektet që përfshijnë ndërtimin dhe rindërtimin e shkollave, klinikave, ndërtesave kulturore në fazë të parë të zbatimit dhe UA (2010-2012).
KURSIMET E PRITURA TË ENERGIJË IN 2011 DHE 2016	Kjo masë do të asistojë zbatimin e masave për auditim të energjisë siç është zbatimi i udhëzimit administrativ për performancën e objekteve dhe Certifikata të performancës së energjisë në ndërtesa.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	UA është nënshkruar. Janë paraparë aktivitete të ndryshme për certifikim të auditorëve (shih KA?)

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISJË

VI.1.3.: UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR PROMOVIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGISJË TE KONSUMATORËT E FUNDIT (KODI: KS3)

TITULLI	UA PËR PROMOVIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGISJË TE KONSUMATORËT E FUNDIT
KATEGORIA	LEGJISLATIVE/INFORMATIVE
Niveli i aplikimit	NACIONAL
Grupi i caktuar	<ul style="list-style-type: none"> • Ofruesit e masave për përmirësim të efijencës së energjisë, • Furnizuesit e energjisë, • Operatorët e shpërndarjes dhe kompanitë me pakicë • Ofruesit e shërbimit të energjisë.
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<p>Udhëzimi Administrativ tanimë është në fuqi. Ky UA është në pajtueshmëri me Direktivën 2006/32/EC. Plani Kosovar për Efijencë të Energjisë është hartuar në bazë të kërkesave të UA-së, përkatësisht Direktivës 2006/32/EC. Plani Kosovar për Efijencë të Energjisë ka përcaktuar disa masa të cilat mundësojnë zbatimin UA-së. PKEE parasheh që deri më 2011 të ketë kursim të energjisë prej 3% të mesatares së konsumit për periudhën 2003-2007. Baza kryesore për mbështetjen e këtij Plani janë masat specifike të cilat prodhojnë efekte të drejtpërdrejta të kursimeve të energjisë siç janë: kreditë për projekte të efijencës së energjisë për NVM-të dhe arvisëntë.</p>
EFEKTIVITETI	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i organeve dhe mekanizmave shtetërorë për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave për përmirësim të efijencës së energjisë dhe dokumenteve dhe akteve të efijencës së energjisë, • Rritje e cilësisë së kompanive të furnizimit, sistemit të shpërndarjes dhe rritje, kompanive me pakicë; • Rritje e cilësisë e bazës së të dhënave dhe komunikimit ndërmjet organeve monitoruese - ndërmarrjeve - konsumatorëve të efijencës së energjisë • Rritje e kursimeve të energjisë në të gjithë sektorët e energjisë dhe llojet e burimeve të energjisë
KURSIMET E PRITURA TË ENERGISJË IN 2011 DHE 2016	Kursimet e energjisë gjatë zbatimit të këtij Udhëzimi janë vlerësuar në masat tjera të cilat janë rrjedhojë e këtij zbatimi.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	UA është në fuqi që nga viti 2008. Zbatimi i tij filloi me miratimin e Planit Kosovar për Efijencë të Energjisë.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
VI.1.4.: NGRITJA E KAPACITETEVE KOMUNALE PËR MENAXHIM TË PROJEKTEVE DHE AUDITIM TË ENERGJISË (KODI: KS4)

TITULLI	NGRITJA E KAPACITETEVE KOMUNALE PËR MENAXHIM TË PROJEKTEVE DHE AUDITIM TË ENERGJISË
KATEGORIA	EDUKIM/TRAJNIM
Niveli i aplikimit	KOMUNAL
Grupi i cakut	Stafi komunal
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<p>Trajnime për zyrtarë komunalë për grumbullimin e të dhënave esenciale statistikore të energjisë, menaxhim të projekteve të efijencës së energjisë, etj.</p>
EFEKTIVITETI	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i komunikimit aktiv dhe funksional ndërmjet komunave dhe Departamentit të energjisë në Ministrinë e Energjisë dhe Minerave • Ngritja e vetëdijes së Stafit të menaxhmentit komunal lidhur me kërkesat për efijencë të energjisë gjatë parashikimeve të planeve zhvillimore dhe programeve komunale • Krijimi i bazës për ndërveprim në hartimin e dokumenteve dhe akteve të E
KURSIMET E PRITURA MË 2011 DHE 2016	Kjo masë krijon kushtet organizative për monitorim të gjendjes së efijencës së energjisë.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Kursi trajnues është organizuar nga ministria përgjegjëse për energji- Ministria e Zhvillimit Ekonomik(ish Ministria e Energjisë dhe Minerave). Projekti është realizuar nga Instituti për Zhvillim hulumtues Rrimvest. Trajnimi është ofruar për 60 zyrtarë komunalë. Kohëzgjatja e kursit ishte 45 ditë, 5 orë në ditë, në nëntor dhe dhjetor 2008. Shumica e ekspertëve të njohur të energjisë, ekonomisë, statistikave, menaxhimit të projekteve dhe ekspertëve të programeve për parashikime të energjisë, etj., janë përdorur si ligjërues.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË

VI.1.5.: FILLIMI I KURSIT PËR TRAJNIM TË AUDITORËVE TË ENERGIJË (FAZA E PARË) (KODI: KS5)

FILLIMI I KURSIT PËR TRAJNIM TË AUDITORËVE TË ENERGIJË (FAZA E PARË)	
TITULLI	FILLIMI I KURSIT PËR TRAJNIM TË AUDITORËVE TË ENERGIJË (FAZA E PARË)
KATEGORIA	EDUKIM/TRAJNIM
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	Ekspertë të fushave të ndryshme kanë shprehur interesim për të marrë trajnime të auditimit të energjisë.
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Kjo masë synon krijimin e një fondacioni fillestar të auditorëve të ardhshëm të energjisë. Trajnimet janë siguruar për 60 pjesëmarrës. Trajtimi është organizuar në tri grupe me nga 20 pjesëmarrës. Ky Projekt është donacion i Komisionit Evropian. Përgatitjet për përzgjedhjen në bazë të testeve të 20 personave për certifikim tanimë kanë filluar. Për financimin e këtij projekti pritet një donacion gjerman.
EFEKTIVITETI	Krijimi i tregut të auditorëve të certifikuar krijon kushtet për auditime të obligueshme të objekteve të mëdha të konsumatorëve në sektorin publik të shërbimeve, siç është theksuar në UA për Auditim të energjisë. Ky proces nënkupton institucionalizimin e Auditimit të energjisë, që është gjithashtu i dëshirueshëm, esencial dhe fitimprurës për konsumatorët privatë të sektorit të shërbimeve.
KURSIMET E PRITURA TË ENERGIJË IN 2011 DHE 2016	Rezultatet e kësaj mase nuk janë të matshme. Rezultatet e punës së auditorëve janë paraqitur në masat tjera që përfshijnë auditime të obligueshme të energjisë dhe ku kërkohen vlerësime të specializuara për projekte të sektorit të shërbimeve që kërkojnë kredi për qëllime të efijencës së energjisë apo projekteve nëse institucionet dhe agjencitë publike kërkojnë vlerësime të specializuara të efijencës së energjisë në formë të tenderëve publikë.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Projekti është realizuar më 2007 dhe 2008, dhe projekti përcjellës për certifikim është bërë përmes Fondeve të BE-së për 50 auditorë të cilët do të certifikohen më dhjetor 10. Kjo masë është e ndërlidhur me masa tjera për nxirjen e auditiveve, si atyre të obligueshme ashtu dhe vullnetare.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VI.1.6.: RRRITJA E SHKALLËS SË INKASIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (KODI: KSH6)

TITULLI	RRITJA E SHKALLËS SË INKASIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË
KATEGORIA	VE TËDJESIM
NIVELI I APLIKIMIT	KOMUNAL
GRUPI I ÇAKUT	KONSUMATORËT QË NUK PAGUAJNË ENERGJINË E KONSUMUAR
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	<p>Për shumë vite, Kosova përballet me fenomenin e mospagesave të rregullta të energjisë së shfrytëzuar elektrike, nga një numër i konsiderueshëm e konsumatorëve. Veç kësaj, Korporata Energjetike, KEK, përkatësisht Divizioni i Furnizimit, nuk është në gjendje të faturtojë mbi 30% të energjisë së konsumuar. Mbi 30 % të energjisë së faturuar nuk paguhet nga konsumatorët. KEK-u përballet me shumë vështirësi në operacionet e tij. Ai mbijeton falë mbështetjes financiare nga buxheti publik dhe më herët nga donacionet e huaja. Duke rritur shkallën e inkasimit të energjisë, do të ndryshojmë sjelljen e konsumatorëve dhe sektorit të shërbimeve, që vazhdon të shfrytëzojë energji të papaguar. Gjithashtu, kjo do të ketë ndikim në përdorimin racional të energjisë elektrike në këtë sektor.</p> <p>Ulja e nivelit të konsumimit të energjisë në sektorin e shërbimeve kërkon veprime tjera që çojnë në zhdukjen e këtij fenomeni, që pengon seriozisht funksionimin normal të tregut të energjisë. Përderisa ky fenomen është i pranishëm në Kosovë, do të jetë shumë vështirë të maten efektet konkrete të masave për përmirësim të efijencës së energjisë, meqë kufizimet në pagesa do të prodhojnë efekte të kursimit të energjisë, gjersa pagesat nuk i nënshirohen masave të efijencës së energjisë. Ky Projekt mbështetet nga AER.</p>
EFEKTIVITETI	Efekt i vetëdijesimit të konsumatorëve për përmirësimin dhe obligimeve të tyre karshi furnizuesit publik të energjisë me synim të stabilizimit të furnizimit të energjisë.
KURSIMET E PRITURA TË ENERGJISË IN 2011 DHE 2016	Kjo masë tanimë është përfunduar dhe efektet e saj nuk janë matur. Nuk është bërë asnjë hulumtim para, apo pas zbatimit të masës për të matur efektin e rritjes së shkallës së inkasimit si rezultat i pritur.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Kjo masë është realizuar më 2007.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISË

VI.1.7.: PROMOVIMI I EFIÇIENCË SË ENERGISË NË KOMUNA (KODI: KSH7)

TITULLI	PROMOVIMI I EFIÇIENCË SË ENERGISË NË KOMUNA
KATEGORIA	FINANCIARE/EDUKATIVE/INFORMUESE
NIVELI I APLIKIMIT	KOMUNAL
GRUPI I ÇAKUT	Konsumatorët publikë, Komunitat, Asociacioni i Komunitave të Kosovës
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Më 2006-2008, GTZ ka bashkëfinancuar 40 projekte të ndryshme për eficiency të energjisë në komunitet e Kosovës. Projektet kryesisht përfshijnë termizolim dhe jashtëm në ndërtesa të vjetra, zëvendësimin e dritareve, dyerve dhe ndreqjen e kulmeve. kryesisht në sektorin publik të shërbimeve. Veç kësaj, disa projekte përfshijnë rinovime dhe zëvendësimin e plotë të sistemeve ekzistuese të ngrohjes duke përfshirë zëvendësimin të kaldajave. Objektet në të cilat janë zbatuar masa të eficiency së energjisë janë kryesisht shkollat (filloret dhe të mesme), kopshte fëmijësh, klinika, ndërtesa komunale, etj., në komunitet e ndryshme të Kosovës. Komunitat përkatëse kanë bashkëfinancuar projektet që janë zhvilluar në territoret e tyre
EFEKTIVITETI	Përmirësimi i EE dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara për këto objekte.
KURSIMET E PRITURA MË 2011 DHE 2016	Kursimet vjetore të energjisë si rrjedhojë e këtyre masave të PEE në sektorin publik të shërbimeve, përmes realizimit të 40 projekteve është 0.39 ktoe dhe në fund të vitit 2011 kursimet do të jenë 1,20 ktoe, dhe në fund të 2016 3.43 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Projektet janë përfunduar nga 2006-2008.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISË

VI.1.8.: PROMOVIMI I GLN PËR TË PËRMBUSHUR KËRKESËN E ENERGISË PËR GATIM NË NDËRTESAT E SHËRBIMEVE (KODI: KSH8)

TITULLI	PROMOVIMI I GLN PËR TË PËRMBUSHUR KËRKESËN E ENERGISË PËR GATIM NË NDËRTESAT E SHËRBIMEVE
KATEGORIA	HULUMTIM I VLERËSIMIT TË MUNDËSIVE DHE FUSHAT E VETËDIJESIMIT
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	KONSUMATORËT E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE (HOTELE, INSTITUCIONE SHËNDETËSORE, ETJ) TË CILAT KRYESISHT E PËRDORIN ENERGIJËNË PËR GATIM
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Hulumtim i mundësive për zëvendësim të energjisë elektrike me GLN. Kjo bëhet më qëllim të hartimit të politikave që çojnë drejt këtij zëvendësimi. Hulumtimi gjeneron rezultate të kursimeve të energjisë.
EFEKTIVITETI	Sektori i shërbimeve përdor një sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike për qëllime gatimi: megjithatë, GLN aktualisht përdoret për këtë qëllim, por vetëm në masë shumë të vogël. Zëvendësimi i energjisë elektrike me GLN do të ketë ndikim në uljen e konsumit të energjisë elektrike për këtë qëllim, dhe uljen e kostove për furnizim të energjisë. Veç kësaj, përdorimi më i madh i GLN-së për qëllime gatimi në sektorin e shërbimeve do të ulë nivelin e emetimeve të CO2 duke marrë parasysh faktin që energjia elektrike në Kosovë prodhohet nga linjiti dhe efikasiteti i Termocentraleve është shumë i dobët: Kosova A 29% dhe Kosova B rreth 34 %.
KURSIMET E PRITURA MË 2011 DHE 2016	Pritet që zbatim i rekomandimeve të hulumtimit do të nxisë kursim vjetor të energjisë së përdorur për gatim në sektorin e shërbimeve në sasi prej 0.2 ktoe. Në fund të 2012, prijjet për kurse janë 0.5 ktoe, dhe në fund të 2018, 1,4 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Projekti është në zbatim e sipër. Termel e referencës janë hartuar. Ky hulumtim do t'i kushlojë vëmendje të veçantë kërkesave të efijencës së energjisë.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VI.1.9.: RREGULLORE TEKNIKE PËR PERFORMANCËN ENERGETIKE TË NDËRITESAVE (KODI: KSH9)

TITULLI	RREGULLORE TEKNIKE PËR PERFORMANCËN ENERGETIKE TË NDËRITESAVE
KATEGORIA	RREGULLATIVE/NORMATIVE
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	Pronarët e ndërtesave, ekspertë të parashikimit, auditorë të energjisë, asocione të arkitektëve dhe inxhinierëve të ndërtimitarisë, prodhues të materialeve ndërtimore
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Kosova nuk ka miratuar Rregulloren, Udhëzimin apo akt nënligjor për performancë të energjisë të ndërtesave, në pajtueshmëri me Direktivën 2002/91/EC. Përkundër disa përpjekjeve për të hartuar një dokument të tillë, kjo çështje ende mbetet e hapur. Plani është të miratohen Certifikatat Energetike të Ndërtesave më 2011.
EFEKTIVITETI	Kjo masë do të rregullojë EE në ndërtesa të të gjithë sektorëve të konsumimit të energjisë, duke përfshirë sektorin e shërbimeve, duke mundësuar kështu kontrollin e konsumit të energjisë, dhe përmirësimin e performancës së tyre energetike. Gjithashtu, ajo do të mundësojë certifikim energjetik të ndërtesave, si pasojë e auditimit të energjisë, duke përfshirë edhe sektorin publik dhe privat të shërbimeve. Konsumatorët më të mëdhenj nga radhët e objekteve të shërbimeve publike do t'i nënshtrohen auditimit të rregullt trevjeçar energjetik.
KURSIMET E PRITURA MË 2011 DHE 2016	Pasi që ky kod energjetik të hyjë në fuqi, rezultatet indikative të masave të imponuara do të jenë të dukshme në periudhë afatmesme (2010-2012), duke filluar nga 2010.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Ai hyn në fuqi më 2010 dhe zbatimi i tij i plotë fillon më 2011.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË

VI.1.10.: KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË (KODI: KSH10)

Titulli		KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË
KATEGORIA		LEGJISLACION/RREGULLATIVE/ORGANIZATIVE
NIVELI I APLIKIMIT		NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT		INSTITUCIONET, MEKANIZMAT DHE AGJENCITË, KOMPANITË ENERGETIKE, KOMPANITË E SHËRBIMEVE ENERGETIKE, OPERATORË TË SISTEMIT TË SHPËNDARJES, AUDITORË TË ENERGIJË, PROKURIMET
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE		Të gjitha aktivitetet e zhvilluara, përfshirë ato që do të zhvillohen në të ardhmen për efijencë të energjisë, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për efijencë të energjisë. Gjithashtu, ky ligj adreson çështjen e rregullimit të efijencës së energjisë. Mungesa e një ligji për efijencë të energjisë ka shkaktuar pengesa të shumta në lidhje me zhvillimin e stafit institucional. Ky ligj synon të rregullojë efijencën e energjisë në një nivel më të lartë të përgjegjësive. Ky ligj gjithashtu do të përcaktojë autoritetin e mekanizmave dhe institucioneve nacionale që merren me politikën dhe masat e PEE, duke përfshirë fondin për efijencë të energjisë.
EFEKTIVITETI		Miratimi i LEE do të forcojë fushën e EE-së në kuptim ligjor, institucional dhe organizativ. Ai do të përfshijë të gjithë sektorët e energjisë, duke përfshirë sektorin e shërbimeve. Gjithashtu, ligji do të përcaktojë instrumentet për zbatim dhe vlerësim për masat e EE.
KURSIMET E PRITURA MË 2011 DHE 2016		Rezultatet lidhen me masat konkrete të zbatimit të Ligjit.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR		Ligji pritet të miratohet dhe të hyjë në fuqi më 2011. Shpresohet që Agjencia për Efijencë të Energjisë do të themelohet po këtë vit.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VI.1.11.: PROMOVIMI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË NVM (KODI: KSH11)

TITULLI		PROMOVIMI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË NVM
KATEGORIA		FINANCIARI/KREDI TË BUTA PËR NVM
NIVELI I APLIKIMIT		NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT		NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME SHËRBYESE
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE		Me synim të promovimit të efijencës së energjisë në sektorin e amvisërisë dhe të NVM-ve, Banka Gjermane për Zhvillim ka ndarë një kredi prej 10 milionë Euro për kreditimin e projekteve të efijencës së energjisë. Përfutjesit do të jenë edhe NVM-të e sektorit të shërbimeve. Kreditë do të kenë kushte favorizuese. Ndajta e kredive ka filluar me zbatimin e kredive përmes Raiffeisenbank në periudhë pesëvjeçare (2009-2014). KfW është duke financuar edhe ProCredit Bank me të njëjtën sasi prej 10 milionë euro si investim për kredi të buta në EE për amvisëri (siç u cek më lart) dhe për NVM.
EFEKTIVITETI		Sektori i NVM përfillon kryesisht përmes izolimit të mureve dhe kulmeve, detyrve dhe dritareve, për sisteme të ngrohjes dhe pajisje për energji solare për ngrohje të ujit sanitar dhe masave tjera të PEE.
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016		Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesat shërbuese, dhe rritja e vetëdijes për efektet e kursimeve të energjisë përmes përdorimit të materialeve izoluese.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR		Rezultatet e kursimeve të energjisë nuk janë drejtpërsëdrejti të matshme. Projektet do të zbatohen nga 2009-2014.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISË

VI.1.12.: KRIJIMI I SISTEMIT TË CERTIFIKIMIT TË AUDITORËVE TË CERTIFIKUAR (KODI: KSH12)

TITULLI	KRIJIMI I SISTEMIT TË CERTIFIKIMIT TË AUDITORËVE TË CERTIFIKUAR
KATEGORIA	RREGULLATIVE/INFORMATIVE
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	AUDITORËT, ESCO, KONSULENTËT, ETJ.
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Certifikimi i auditorëve pas përfundimit të trajnimeve të specializuara dhe futjes së tyre në regjistrin zyrtar. Ky trajnim është mbështetur nga programi i BE-së. Fillimisht, 50 ekspertë janë trajnuar në kurse të specializuara pasi kanë përmbyshur fazën e parë të trajnimit të Auditimit të Energjisë për ndërtesa dhe gjithashtu kanë finalizuar fazën e dytë për ndërmarrje industriale.
EFEKTIVITETI	Krijimi i kushteve për auditime të obligueshme të objekteve të caktuara publike dhe auditimi vullnetar i energjisë, sipas pritjeve. Krijimi i kushteve për mbështetje të institucioneve publike në përgatitje të dokumentacionit teknik për prokurim të projekteve kapitale përmes krijimit të kriterëve dhe kërkesave të PEE.
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Kjo masë do të ndihmojë masat tjera që kanë të bëjnë me nxitjen e auditimit të energjisë. Rezultatet e kursimeve të energjisë janë indirekte.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Zbatimi i kësaj mase do të fillojë më 2009.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VI.1.13: FUSHATË PUBLIKE PËR KURSIMIT E ENERGJISË DHE PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË (KODI: KSH13)

TITULLI	FUSHATË PUBLIKE PËR KURSIMIT E ENERGJISË DHE PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË
KATEGORIA	EDUKIM/INFORMIM
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	KONSUMATORËT E TË GJITHË SEKTORËVE
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Realizimi i fushatave të përqendruara të vetëdijesimit, informimit dhe edukimit për kursimet e energjisë në sektorin e shërbimeve. Kohëzgjatja e projektit vlerësohet të jetë trevjeçare (2010-2012) dhe e financuar nga buxheti publik i Kosovës.
EFEKTIVITETI	Ngrija e vetëdijes së konsumatorëve për efektet e shumta të kursimeve të energjisë dhe njohja e tyre me mënyrat dhe metodat për kursime të energjisë.
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Kjo masë do të rezultojë me një kursim të energjisë prej 5 % të konsumit të energjisë elektrike në sektorin e shërbimeve. Kursimet vjetore të energjisë pritet të jenë 1.78 ktoe. Deri në fund të vitit 2011 kursimet e energjisë pritet të jenë 7.2 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Masa do të realizohet nga viti 2010 apo së paku 2012 dhe do të vazhdojë jo vetëm deri 2018. Hollësitë e strategjisë dhe planit për fushatë janë shpjelluar në dokumente të veçanta. Rezultatet e para do të jenë të dukshme brenda 3 viteve planit 2010-2012.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VI.1.14.: TRANSFORMIMI I LEGJISLACIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË PËRFITIM TË PËRMIRËSIMIT TË EE (KODI: KSH14)

TITULLI	TRANSFORMIMI I LEGJISLACIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË PËRFITIM TË PËRMIRËSIMIT TË EE
KATEGORIA	BASHKËPUNUES
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	INSTITUCIONET QENDRORE DHE LOKALE, DHE NDËRMARRJET PUBLIKE QË OPEROJNË ME BUXHETE PUBLIKE
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Avancimi i legjislacionit dhe praktikave të prokurimit përmes caklimit të kriterëve për përmirësim të efciencës së energjisë. Synimi është që sektori publik të përdoret si shembull për kursim të energjisë dhe përmirësim të efciencës së energjisë

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJISË

EFEKTIVITETI	Transformimi i legjislacionit të prokurimit publik dhe përshtatja e tij me kërkesat dhe kriteret për Eficiencë të Energjisë do të ketë ndikim në përmirësimin e EE në sektorin e shërbimeve dhe menaxhimit efektiv të fondeve
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Rezultatet nuk janë të matshme.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Planifikimi për plotësimin dhe ndryshime do të bëhet gjatë vitit 2012. Efektet e vërteta të kësaj mase priten më 2012 dhe do të vazhdojnë në periudhë afatgjate.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VI.1.15.: NXITJA E PËRDORIMIT TË SISTEMEVE SOLARE PËR NGROHJE TË UJIT SANITARE (KODI: KSH15)

Titulli	NXITJA E PËRDORIMIT TË SISTEMEVE SOLARE PËR NGROHJE TË UJIT SANITARE
KATEGORIA	FINANCAVEDUKIM
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	SEKTORI PUBLIK DHE PRIVAT I SHËRBIMEVE
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Instalimi i sistemeve solare për ngrohje të ujit sanitar në katër klinika të QKUK në Prishtinë dhe në një konvikt të qendrës studentore në fillim të vitit 2010 është dëshmuar të jetë shembull i suksesshëm. Panelet solare për ngrohje të ujit sanitar do të instalohen në periudhën 2010-2011 në tri objekte tjera publike, si pjesë e projektit "Zbatimi i Masave të EE në Ndërmarrjet Publike", financuar nga Komisioni Evropian. Këto dhe shembuj të tjerë të përdorimit të energjisë solare për ngrohje të ujit sanitar, duke kursyer konsum të energjisë nga burime tjera të përdorura për këtë qëllim, do të shërbehen për të nxitur sektorin e shërbimeve në përmirësim të efiçencës së energjisë.
EFEKTIVITETI	Kjo masë ulë konsumin e energjisë për qëllime të ujit të ngrohtë sanitar, ulë koston e prodhimit të energjisë, ulë shkallën e emetimeve të CO ₂ , rritë cilësinë e shërbimeve, si dhe rritë përmbushjen e Çaqeve indikative për burime të ripërtëritshme të energjisë.
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Duke marrë parasysh faktin që një sasi e konsiderueshme e energjisë elektrike konsumohet në sektorin e shërbimeve për ngrohje të ujit sanitar, futja e sistemeve me panele solare do të ulë koston e këtij konsumi. Kursimet vjetore të energjisë pritet të jenë 2.17 ktoe. Deri në fund të vitit 2011 (periudha 2010-2012) këto kursime do të arrijnë 4.34 ktoe, dhe deri më 2018 në 15.2 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Projekti i parë ka filluar në nëntor 2008 dhe ka përfunduar në shkurt 2009 dhe efektet e tij kanë qenë të dukshme dhe përmbushin objektivat.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISJË

VI.1.16.: PËRMIRËSIMI I EE PËRMES NDRIÇIMIT EFIKAS NË NDËRTESTAT PUBLIKE (KODI: KSH16)

Titulli	Përmirësimi i EE përmes ndriçimit efikas në ndërtesat publike
KATEGORIA	VETËDIJESIM/RREGULLATIV
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	Institucionet publike qeveritare
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Kjo masë e IEE do të përqendrohet në pjesën e ndriçimit efikas, i cili do të aplikohet në ndërtesat publike. Një nga hapat e kësaj mase do jetë instalimi i sistemeve automatike dhe vendosja e sensorëve në sistemet e ndriçimit të brendshëm. Kjo masë do të mbështetet me rregulloret përkatëse që përcaktojnë formën efikase në ndërtesa të institucionet publike, për ta bërë këtë sektor model pozitiv.
EFEKTIVITETI	Efektet e kësaj mase janë aplikimi i masave efikase të shpenzimit të energjisë, përmes fuqisë së praktikave të ndriçimit efikas.
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Rezultatet konkrete të kursimeve të energjisë përmes masave të PEE do të jenë dukshme pas zbatimit dhe monitorimit të tij.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Zbatimi i kësaj mase ka filluar në shtator 2010 me mbështetje financiare të MZHE(ish MEM) dhe GTZ.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË

VI.1.17.: NDRIÇIMI EFIKAS PUBLIK (KODI: KSH17)

Titulli	NDRIÇIMI EFIKAS PUBLIK
KATEGORIA	Edukim /vetëdijesim
NIVELI I APLIKIMIT	Rajonal (në qytetet më të mëdha në vend)
GRUPI I ÇAKUT	Institucionet qendrore dhe lokale të sektorit të shërbimeve
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Ndrichi efikas i rrugëve dhe shesheve duhet të bëhet në qytetet më të mëdha në vend, siç janë Prishtina, Peja, Prizreni, Ferizaj, etj. Kjo masë do të paraprihet me një projekt demonstrues të digjitalizimit të ndriçimit publik, i cili do të bëhet në një qytet në Kosovë.
EFEKTIVITETI	Kjo masë do të krijojë vetëdijesim të institucioneve publike në menaxhimin e ndriçimit publik, për të kursyer energji dhe për të rritur eficientësinë e energjisë në ndriçimin publik.
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Rezultatet konkrete të kursimeve të energjisë përmes kësaj mase të PEE do të jenë të dukshme pas zbatimit dhe monitorimit të saj.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Zbatimi i kësaj mase do të fillojë gjatë vitit 2011.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGISJË

VI.1.18.: PËRMIRËSIMI I EE NË PAJISJET PËR NGROHJE (KODI: KSH18)

Titulli	PËRMIRËSIMI I EE NË PAJISJET PËR NGROHJE
KATEGORIA	EDUKIM/VE TËDIJESIM
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	Sektor i shërbimeve
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Ujje e konsumit të energjisë elektrike dhe termale përmes instalimit të makinave ekzaminuese në pajisjet për ngrohje në sektorin e shërbimeve. Instalimi i pajisjeve të kontrollit automatik në sistemet e ngrohjes termike.
EFEKTIVITETI	Kontrolli i konsumit të energjisë dhe ujje e konsumit të tepërt
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Rezultatet konkrete të kursimeve të energjisë përmes kësaj mase të PEE do të vërehen pas zbatimit dhe monitorimit të tij.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Zbatimi i kësaj mase do të fillojë më 2011.

Kapitulli VII. Sektori Industrial

Sektori industrial është sektor i rëndësishëm për konsum të energjisë, përkundër faktit që zhvillimi i tij është penguar nga vështirësi të shumta dhe progresi i ngadaltë. Në mungesë të një mekanizmi ndërinstitucional zbatues për eficiency të energjisë, është shumë vështirë të jepet një përshkrim i saktë i gjendjes ekzistuese të këtij sektori apo disponueshmërisë së të dhënave të kërkuara për të matur ndikimin potencial të rismare të eficiency së energjisë. Si rrjedhojë, nuk kishte fushatë të vetëdijesimit për këtë sektor dhe as mundësi për realizim të projekteve, siç parashihet në KEERERP 2007-2009, për ta përshkruar sektorin dhe parashikuar kërkesën e energjisë, dhe as zbatimin e projekteve demonstruese në industri. Këto aktivitete do të realizohen brenda periudhës së parë të këtij Plani të Veprimit gjatë 2010-2012.

Niveli i konsumit të energjisë në sektorin industrial gjatë periudhës 2003-2008 ka hasur lëkundje. Gjatë dy viteve të fundit, megjithatë, ka pasur rritje të arsyeshme (286.86 ktoe më 2007 dhe 289.01 ktoe më 2008). Nëse dikush mund të thotë se niveli i konsumit pasqyron nivelin e rritjes industriale, atëherë mund të supozohet se ky sektor përballlet me një trend zhvillimor, dhe do të konsumojë edhe më shumë ene gjë. Nga kjo perspektivë, PEE duhet të ndjek këtë trend të zhvillimit.

Parashikimet për konsum të energjisë për vitin 2010-2018 tregojnë një rritje të konsumit të energjisë në sektorin industrial, për gati njëqind për qind krahasuar me vitin 2008. Në veçanti, konsumi i energjisë elektrike do të ketë rritje të vazhdueshme prej gati 300 ktoe në vit, si rrjedhojë e zhvillimit të ardhshëm të aktiviteteve të ndryshme industriale, duke përfshirë industrinë e rëndë dhe ndoshta edhe mihjet. Më 2009, konsumi i lëndës djegëse përsëri do të jetë më i larti për tërë sektorin, ndoshta si rrjedhojë e mungesës së energjisë elektrike. Ndërmarrjet industriale detyrohen të shpenzojnë në produkte të naftës për të kompensuar për mungesën e energjisë elektrike.

Plani trevjeçar për eficiency të energjisë (2010-2012) tregon që Sektori industrial do të jetë i treti në kuptim të kursimit të energjisë nga konsumi i përgjithshëm i energjisë, pas sektorit të amvisërisë dhe atij të shërbimeve, me kursim vjetor të energjisë prej 25 % 90 GWh.

Me sektorët e Transportit dhe Bujqësisë, synimi është arritja e 30% të kursimit të energjisë në periudhë afatmesme (2010-2012). Një vështrim i përgjithshëm në gjendjen e këtyre tre sektorëve mund të tregojë se ka mjaft hapësirë për Eficiency të Energjisë. Tri vitet e para të PNEE nuk përfshijnë masa ambicioze të EE sepse këta tre më parë nuk janë trajtuar në kuptim të eficiency së energjisë. Konsiderohet se ka nevojë të madhe për të ndërmarrë hulumtime dhe fushata të promovimit në këta sektorë, sesa për masa kor krete të obligueshme. Duhet më shumë kohë për t'i krijuar instrumentet dhe mekanizmat e nevojshëm me ndikim të drejtpërdrejtë në EEi.

Figurat 17 dhe 18 përmbledhin kursimet relative dhe absolute të duhura për sektorin e industrisë për t'i përmbushur objektivat e definuar në pjesët e mësipërme.

Figura 17: Caqet afatshkurte dhe afatgjate të EE për sektorin e industrisë në %




Figura 18: Gjithsej Kërkesa për energji pas zbatimit të masave të EE në sektorin e industrisë dhe kursimet absolute të EE në (ktoe)




Tabela 18 tregon masat për përmirësim të efikasitetit të energjisë (PEE) në sektorin industrial.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Tabela 18: Masat për përmirësim të eficiency së energjisë (PEE) në Sektorin Industrial

KODI	TITULLI	GJENDJA	LLOJI	VIT I FILLIMIT	VIT I PËRFUNDIMIT	REZULTATI	Kursime të energjisë toe	Kostoja e zbatimit Euro	Indikatorët monitorues	ZBATUES
K11	Promovimi i EE në NVM	Planifikuar	Financa/kredi të buta	2009	2014	Kreditë sigurohen nga KfW dhe ndarja e tyre bëhet përmes Raiffeisenbank.	1456	Buxheti është përfshirë në sektorin e amvisërisë	Sasia e kredive për zbatim të Masave të kursimit të EE në Industri	MZHE (ish MEM), MTI, NVM, donatorët, Kompanitë energjetike
K12	Inkurajimi i auditimit të fsheshtë në sektorin e industrisë dhe fushatat për vetëdijësim në këtë sektor	Planifikuar	Informativ/edukativ	2010	2016	Vetëdijësimi i përgjithshëm për potencialin e kursimit në NVM-të industriale Pronarët dhe menaxhmenti i NVM-ve marrin njohuri për rëndësinë e EE dhe teknologjive eficiente. Do të kryhet një numër i VM-ve në NVM dhe rëndësia e planifikimit të biznesit, me zbatimin e masave të EE të identifikuar në VM.	4356	Buxheti është përfshirë në sektorin e amvisërisë	Numri i auditiveve të energjisë të kryer në sektorët nën-industrialë	MZHE, MTI, MF (ish MEF), NVM-të përkatëse

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VII. 1. MASAT INDIVIDUALE PËR PËRMIRËSIM TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN INDUSTRIAL

VII.1.1: PROMOVIMI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË NVM (KODI: KI1)

TITULLI	PROMOVIMI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË NVM
KATEGORIA	FINANCIARË/KREDITË E BUTA
NIVELI I APLIKIMIT	NACIONAL
GRUPI I ÇAKUT	NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME INDUSTRIALE
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Me synim të promovimit të Efiçiensës së energjisë në Sektorin e Amvisënsë dhe NVM-ve, Banka Gjermane për Zhvillim ka ndarë një kredi prej 10 milionë Euro për kreditimin e projekteve të efiçiensës së energjisë. Përfshiesit përfshijnë edhe sektorin e NVM-ve. Kreditë do të jenë me kushte favorizuese. Parashikimi është që të fillohet me zbatimin e kredive përmes Raiffeisenbank në periudhë pesëvjeçare (2009-2014).
EFEKTIVITETI	Kursimet e energjisë do të jenë rezultat i përmirësimit të kushteve të Shfrytëzimit të Energjisë dhe proceseve tjera të zhvilluar në NVM.
REZULTATI PRITET MË 2011 DHE 2016	Zbatim i projekteve pritet në periudhën 2009-2014.
KURSIMET E PRITURA MË 2011 DHE 2016	Kursimet e pritura vjetore në sektorin industrial: deri në fund të 2012 janë 5.5 ktoe, deri më 2018 do të jenë 27.5 ktoe.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VII.1.2.: NXITJA E AUDITIMIT TË THJESHËTË NË SEKTORIN INDUSTRIAL (KODI: KI2)

TITULLI	NXITJA E AUDITIMIT TË THJESHËTË NË SEKTORIN INDUSTRIAL
KATEGORIA	INFORMUES/ EDUKUES
GRUPI I ÇAKUT	Ndërmarrjet Industriale
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Auditimet e thjeshta të efikasitetit të energjisë në ndërmarrjet industriale. Njohja e menaxhmentit të ndërmarrjeve industriale me përfitimet e zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë. Ofrimi i rekomandimeve të përgjithshme për masat e thjeshta në sjelljen e shërbimeve, dhe masat kosto-efektive që ofrojnë rezultate më të shpejta.
Efektiviteti	Ndryshimi i sjelljes së menaxhmentit dhe punonjësve të sektorit të industrisë: rritje e interesimit të menaxhmentit në zëvendësimin e teknologjive joefikase me ato efektive.
KURSIMET E PRITURA APO VJETORE NË 2011-2016	Kursimet vjetore të energjisë pritet të jenë 1 % të konsumit të energjisë të sektorit të industrisë, apo 2.2 ktoe. Kjo masë do të fillojë të prodhojë efekt më 2011, dhe në fund të 2012 kursimet e pritura të energjisë janë 2.2 ktoe, dhe në fund të vitit 2018, kursimet e energjisë në sektor pritet të jenë 13.2 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Programi do të përgatitet më 2009. Zbatimi i Programit do të fillojë në fillim të 2010. Rezultatet do të jenë të matshme duke filluar më 2011.

VII.1.3.: Menaxhimi i Kërkesës (KODI: KI3)

Sfondi dhe përkufizimi i problem

Menaxhimi i kërkesës përbëhet nga hapat e ndërmarrë nga një ndërmarrje publike për të siguruar se kërkesa për energji nuk tejkalon kapacitetin e saj për t'i përmbushur kontratat. Ajo përfshin një gamë të masave të efijencës së energjisë që e mundësojnë atë të zvogëlojë konsumin e saj, të zhvendos ngarkesat në kohë, dhe të mbajë kërkesën nën kapacitetin maksimal të furnizimit. Menaxhimi i kërkesës gjithashtu çon në përfitime të mëtejme në efijencë të energjisë për shkak se humbjet e energjisë janë më të mëdha në sistem të bartjes dhe shpërndarjes, i cili është i ngarkuar.

Mjeti më i rëndësishëm i menaxhimit të kërkesës është seti i tarifave të cilat janë dizajnuar që t'i ofrojnë konsumatorit incentivë për të modifikuar kërkesën e tij të energjisë për t'i dhënë një shabllon më të dëshirueshëm të ngarkesës që në anën tjetër mundëson sistemet e përgjithshme të prodhimit, bartjes dhe shpërndarjes që të operojnë në mënyrë më efikase. Elementet kryesore të tarifave që inkurajojnë një lakore më të mirë të kërkesës janë:

1. Ulje e tarifës për energjinë e përdorur gjatë natës apo në periudha të kërkesës së ulët,
2. Tarifa specifike mund të jetë incentiv i fortë për konsumatorët të cilët janë në gjendje të zvogëlojnë apo marrje ndërhyjnë në kërkesë gjatë disa periudhave,
3. Tarifë më e lartë për energjinë e përdorur në periudha të kërkesës së lartë apo në pik,
4. Ngarkesë për kërkesë maksimale (ngarkesë për maksigraf) për t'i dekurajuar konsumatorët nga instalimi i ngarkesave të mëdha që përdoren vetëm kohëpaskohe dhe krijojnë pik në lakoren e kërkesës,
5. Ngarkesa për energji reaktive për t'i dekurajuar konsumatorët nga instalimi i pajisjeve për stabilizim të rrymës.

Sistemi aktual i tarifave veçse përfshin tarifa modifikuara sezonale dhe ditore, si dhe ngarkesa për kërkesë ditore energji reaktive. Megjithatë, aktualisht, për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të rrymës, konsumatorët i kushtojnë pak vëmendje masave të tilla. Kjo shoqërohet edhe me shkallën shumë të ulët të inkasimit. Megjithatë, me rritjen e planifikuar të disiplinës së pagesave dhe rimëkëmbjes ekonomike të industrisë, masat për menaxhim të kërkesës do të jenë gjithnjë e më të rëndësishme në të ardhmen.

Për të qenë efektiv, përdoruesi duhet të jetë në dijeni për kursimet e kostos që mund të arrihen përmes shfrytëzimit të tarifave në dispozicion. Pastaj, ai mund të zbatojë masa të duhura, siç është ulja e kërkesës në periudha të pikut. Zbatimi i orëve për kontroll të pajisjeve që shpenzojnë energji, riorganizimi i orarit të punës për t'i shfrytëzuar përparësitë e periudhave të tarifave të ulëta, krijimi i sistemeve të menaxhimit të ngarkesës (SMK) që automatikisht kontrollojnë operimin e konsumatorëve kryesorë elektrikë, etj.

Sistemi ekzistues tarifor në Kosovë shkakton probleme të shumta për industrinë që po mundohen të rimëkëmben nga nja nivel shumë i ulët i prodhimit. Nëse një kompani është e obliguar të punojë në nivel të lartë të kërkesës për vetëm disa orë apo disa ditë në muaj për të përmbushur një porosi të vogël, atëherë do t'i ngarkohet tarifa e plotë e maksigrafit, e cila do ta bën koston e përgjithshme për njësi për energji elektrike shumë të shtrenjtë (disa herë më e lartë se koston normale).

Ekzistojnë disa qasje për ta tejkaluar këtë problem. Së pari, fabrika duhet të bëjë çdo gjë që mundet për ta tejkaluar kërkesën e pikut, për shembull, duke planifikuar shartimin dhe vazhdimin e prodhimit si proces në grumbull ashtu që të mos duhen të gjitha pajisjet në të njëjtën kohë. Së dyti, mund të jetë e mundur për KEK-in që të ofrojë një tarifë në të cilën kërkesa maksimale që shfaqet gjatë periudhës jashtë pikut të mos ngarkohet. Një tarifë e tillë do ta mundësonte industrinë që në këtë gjendje të vështirë të prodhojë në sasi të vogla kohë pas kohe gjatë natës. Ndryshe, KEK-u mund të jetë në gjendje që të ofrojë një tarifë në të cilën energjia ngarkohet në shkallë të lartë në vend të ngarkesës së maksigrafit. Përfundimisht, një mundësi tjetër është që konsumatorëve që janë në gjendje të planifikojnë programin e tyre të punës t'u ofrohen incentivë dhe të dërgohet një kërkesë te KEK-u për përdorim të energjisë, që do të lejonte KEK-un që të kufizojë kërkesën e pikut.

Shqetësim tjetër për sektorin e industrisë është se pas ndërprerjes së energjisë, fabrikat mund të kenë kërkesë maksimale shumë më të lartë sesa kërkesa 'natyrale' maksimale (kërkesa që do ta ketë arritur fabrika sikur të mos kishte pasur ndërprerje të energjisë), që shpije në rritje të faturës së tyre. Nuk duket se drejtë të ndëshkohen konsumatorët për dështimet e KEK-ut, dhe duhet të pritet që KEK-u t'i ndihmojë klientët e tij në zvogëlimin e pasojave nga ndërprerjet, përmes promovimit dhe mbështetjes së teknologjive të menaxhimit të ngarkesës dhe masave tjera të menaxhimit të kërkesës.

Një kufizim i tarifave të propozuara të KEK-ut është se ngarkesa për kërkesën maksimale është e njëjtë kurdoherë që të ndodh ajo, edhe nëse është në gjysmë të natës. Një tarifë e cila do të ofronte ngarkesë më të ulët nëse kërkesa maksimale është jashtë periudhës së lartë do të jepte incentiv shumë më të fortë për kufizim të kërkesës gjatë periudhës së pikut. Për shembull, investimet si deponimi i ftohës, që teknikisht mund të jetë i mundur në industrinë e agrobiznesit apo në sistemet e centralizuar të kondicionimit të ajrit dhe që lejon zhvendosjen e kërkesës së energjisë

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

elektrike për ftohje nga periudhat e larta në periudha të ulëta, nuk mund të jetë fitimprurës me strukturën aktuale tarifore. Vizitat në fabrika tregonin që menaxherët që nuk kanë dijeni për koston e energjisë reaktive dhe mënyrën se si të përmirësohet faktorimi i energjisë.

Objektivat e projektit janë:

1. Rritja e faktorit të ngarkesës së NVM-ve dhe ndërmarrjeve të mëdha industriale
2. ZRRE të zhvillojë tarifa të duhura që industria të merr parasysh Menaxhimin e Kërkesës
3. Të rritet vetëdijesimi i konsumatorëve industrialë për përfitimet potenciale të masave të menaxhimit të kërkesës.

Projekti përfshin 3 aktivitete kryesore:

1. Studimi i përgjithshëm për tarifën dhe relevancën e tyre për nevojat dhe kapacitetin e konsumatorëve industrialë që çojnë në rekomandimet e Rregullatorit të Energjisë,
2. Projekt demonstrues i masave të Menaxhimit të kërkesës në industri,
3. Fushatë e ngritjes së vetëdijes që për cak ka industrinë.

Studimi do të bazohet në një hulumtim në një mostër të konsumatorëve industrialë. Për secilin konsumator, faktura do të analizohet në hollësi për të përcaktuar sasinë e llojeve të ndryshme të kostove. Vizitat e shkurta në terren lejojnë identifikimin e llojit të pajisjeve dhe masave potenciale për përfitim nga tarifën aktuale, dhe përkufizimi i llojit të tarifës që të ishte më i duhur apo do të ishte më stimulues për menaxhim të ngarkesës. Një listë e rekomandimeve do t'i ofrohet fabrikës. Dhjetë fabrika do të ftohen për të përfituar nga ky veprim. Rekomandimet tipike me gjasë do të përfshijnë:

- Monitorimi dhe përmirësimi i faturave
- Përmirësimi i faktorizimit të energjisë
- Ulje e kërkesës me anë të menaxhimit të përshtatshëm të pajisjeve
- Ulje e konsumit të energjisë elektrike dhe kërkesës maksimale.

Projekti demonstrues do të zbatohet në një industri nga mostra e hulumtimit. Një kontribut financiar mund të kërkojë nga kompania për mbulimin e kostove të zbatimit, gjë që do t'i jepte fleksibilitet dizajnit dhe madhësisë së projektit demonstrues. Projekti do të përfshijë përmirësimin e faktorit të energjisë nëse arsyetohet ekonomikisht në vendin e përzgjedhur. Studimi fillestar do të mbulojë si në vijim:

1. Analizën e hollësishme të faturave
2. Konsumin elektrik dhe regjistrin e kërkesës për periudhën e aktivitetit (zakonisht një javë)
3. Bilanci i hollësishëm elektrik dhe rindërtimi i lakores së ngarkesës dhe i kërkesës maksimale
4. përkufizimi i bazës së konsumit dhe koston (para zbatimit të LMS)
5. rishikimi i të gjitha pashijeve elektrike, ndikimi në kërkesën maksimale, fizibilitetin e ndërhyrjes apo zvogëlimin e kërkesës varësisht nga periudhat tarifore,
6. identifikimi i masave pa kosto për uljen e kërkesës maksimale

Pastaj, sistemi i menaxhimit të ngarkesës do dizajnohet, blihet dhe instalohet bashkë me pajisjet adekuate, softuerin dhe punët elektrike. Pastaj rezultatet do të monitorohen në kuptim të lakores së ngarkesës, faturave të energjisë elektrike, konsumit të pas instalimit dhe koston, krahasimit me atë bazik, kursimet aktuale. Pastaj do të prodhohet një rast studimor.

Një fletëpalosje e Menaxhimit të kërkesës do të prodhohet për shpërndarje të industrisë, prezantim të informatave të duhura, siç është:

- tarifën e ndryshme në dispozicion për industrinë dhe rastet tipike ku aplikohen,
- informatat për faktorizim të energjisë dhe ndëshkime në rast të faktorimit të ulët të energjisë, si dhe zgjedhjet për rritje të tij,
- masat tipike për ulje të faturës energjetike përmes përdorimit më të mirë të strukturës tarifore
- rezultatet e projektit demonstrues.

Kanalet e ndryshme për shpërndarje të saj në industri mund të shfrytëzohen: KEK, për marrëdhënie të mira me klientët e tij, apo MTI, apo asociacionet e ndërmarrjeve siç janë KREA (Agjencia Kosovare e Ndërmarrjeve Rajonale).

Synimet dhe produktet

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

1. Raportimi i sjelljeve dhe nevojave të përdoruesve të fundit, që çojnë në tarifa më të përshtatshme në të ardhmen
2. Zbatimi dhe vlerësimi i projektit demonstrues
3. Zbatimi i fushatës informuese

Caku indikativ

Krahas mundësisë për operim më efikas të prodhimit, bartjes dhe shpërndarjes së energjisë, ky program synon uljen e kostos së energjisë së paguar nga konsumatorët, përmes një lehtësimit i të ngarkesës për KEK-un.

Partnerët zbatues

1. Rregullatori i Energjisë do të konsultohen për qasje në tarifa.
2. KEK-u do të ftohet të marrë pjesë në vlerësimin e tarifave. KEK-u po ashtu mund të jetë kanal i mundshëm për shpërndarjen e fletëpalosjeve për industrinë.
3. MTI mund të ofrojë mbështetje për kontaktet me industrinë për hulumtim, dhe gjithashtu mund të marrë pjesë në procesin e shpërndarjes për përcaktuesit e tij.

Planifikimi i aktiviteteve kryesore brenda programit të parë trevjeçar

Vlerësimi i tarifave: viti 1.

Projekti demonstrues: viti 2.

Fushata e vetëdijesimit: viti 3

Resurset e kërkuara

Kostot e projektit: 100,000 Euro

Kapitulli VIII. Sektori i transportit

Sektori i transportit ka mundësi të pakta për përmirësim të efijencës së energjisë. Periudha afatnesme e Planit për Efijencë të Energjisë (2010-2012), parasheh kursime të energjisë 4.5 %, 24.37% të konsumit total të energjisë. Me një infrastrukturë të prishur dhe me shumë probleme tjera, sektori i transportit nuk mundësi të realizojë asnjë potencial të konsiderueshëm për kursim të energjisë në periudhë afatnesme. Sasia e kursimit të energjisë do të vijë si rrjedhojë e fushatave të vetëdijesimit, të cilat do të ndikojnë në kulturën e përdorimit racional të veturave dhe mundësive të futjes së biokarburantëve, në një nivel modest, gjë që do të kishte ndikim në efikasitetin e motorit, uljen e produkteve të naftës së djegur dhe uljen e emetimeve të CO2. Tabela 19 tregon Konsumin e energjisë në Sektorin e transportit (ktoe), si sasi të burimeve të energjisë për periudhën 2003-2008

Tabela 19: Konsumi i energjisë në Sektorin e transportit (ktoe), si sasi të energjisë, 2003-2008

Sektori i transportit	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Produktet e naftës	273.3	232.4	296.3	306.45	269.53	278.2
Gjithsej	273.3	232.4	296.3	306.45	269.53	278.2

Me qëllim të uljes të konsumit të energjisë në pajtim me caqet e definuara, janë të nevojshme masat kryesore në vijim:

- Rehabilitimi i rrugëve, që tanimë ka filluar në masë të madhe;
- Ndërtimi i rrugëve të reja;
- Menaxhimi më i mirë i sektorit të transportit;
- Përdorimi i veturave efikase me fuqi më të ulët të motorit;
- Rritje e shpejtësisë mesatare të veturave për transportim.
- Rritje e pjesës së transportit publik.
- Përmirësim i infrastrukturës së hekurudhës për përdorim më të madh të transportit hekurudhor, etj.

Figurat 19 dhe 20 përmbledh kursimet relative dhe absolute të energjisë të duhura për sektorin e transportit që të përmbushen objektivat e përkufizuar në pjesët e mësipërme.

Figura 19. Caqet afatshkurtre dhe afatgjate të EE për sektorin e transportit në %





Figure 20. Gjithsej Kërkesa për energji pas zbatimit të masave të EE në sektorin e transportit dhe kursimet absolute të EE në (ktoe)



PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Tabela 20: Masat për përmirësim të efijencës së energjisë (PEE) në sektorin e transportit

KODI	TITULLI	GJENDJA	LLOJI	VITI I FILLIMIT	VITI I PËRFUNDIMIT	REZULTATI	Kursimet e energjisë (toe)	Kosto e implementimit (Euro)	Indikatorët e monitorimit	IMPLEMENTUESIT
KT1	UA për FUTJEN E Biokarburantëve në transport	Udhëzimi Administrativ duhet të hartohet	rregullative / normative/informative	2010	2010	Rezultatet që do të arrihen ndërlidhen me masat tjera afatgjate të EE, që do të zbatohen në këtë sektor, në pajtim me këtë akt ligjor.	678	Nuk ka zotim	Ende nuk është definuar	Institucionet qendrore dhe lokale, hekurudhat, doganat, kompanitë transportuese
KT2	Fushata publike për ngritjen e vetëdijës në transport	Planifikuar	Edukative/vetëdijësim	2010	2011	Kjo fushatë pritet të rezultojë në një nivel të caktuar të kursimeve vjetore të energjisë në Sektorin e Transportit, si rrjedhojë e vetëdijësimit publik për efijencën e këtij sektori.	1452	Nuk ka zotim	Ende nuk është definuar	MZHE, MTI, kompanitë transportuese, kompanitë energjetike

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VIII.1. MASAT INDIVIDUALE PËR PËRMIRËSIM TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

VIII.1.1.: UA PËR FUTJEN E BOKARBURANTËVE (KODI: KT1)

TITULLI	UA PËR FUTJEN E BOKARBURANTËVE NË TRANSPORT
KATEGORIA	Rregullative / normative
GRUPI I ÇAKUT	Institucionet qendrore dhe lokale, ndërmarrjet rrugore dhe të hekurudhave, doganat, ndërmarrjet transportuese
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Futja e përdorimit të biokarburantëve në një përqindje të caktuar për qëllime të transportit; Parandalimi i përdorimit të veturave dhe lëndëve djegëse joefikase; Ujja e emetimeve të CO2
Efektiviteti	Zëvendësimi i karburanteve fosil të lëngët, me biokarburantë për qëllime të transportit, apo përzierja e tyre në masë të caktuar. Inkurajimi i prodhimit të biokarburantëve; Detyrimi i tregtarëve të mëdhenj të naftës dhe produkteve të naftës që të importojnë sasi të caktuara proporcionale të biokarburantëve.
KURSIMET E PRITURA APO VJETORE NË 2011-2016	Kursimi i energjisë përmes zbatimit të kësaj mase nuk është drejtpërsëdrejti i matshëm.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Zbatimi i UA-së për biokarburantë pritet të fillojë më 2011

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

VIII.1.2.: FUSHATA PUBLIKE E VETËDIJESIMIT NË TRANSPORT (KODI: KT2)

TITULLI	FUSHATA PUBLIKE E VETËDIJESIMIT NË TRANSPORT
KATEGORIA	Informuese / edukative
GRUPI I ÇAKUT	Institucionet qendrore dhe lokale, kompanitë rrugore dhe hekurudhore, doganat, kompanitë e transportit, kompanitë energjetike
VEPRIMET E KONSUMIT FINAL TË SHËNJESTRUARA NGA PEE	Identifikimi dhe informatat mbi pengesat për zbatimin e efijencës së energjisë në Sektorin e transportit dhe mënyrat për eliminimin e tyre, siç janë: cilësia e dobët e rrugëve dhe rëndësia e riparimit të tyre, si dhe ndërtimi i rrugëve të reja për ulje të konsumit të energjisë; përdorimi i veturave me motorë efikas; kufizimi i përdorimit të veturave në transportin publik dhe privat që kanë shkallë të lartë të emetimit të gazit; zëvendësimi i veturave të vogla në transportin publik me autobusë; përdorimi i biokarburantëve.
EFEKTIVITETI	Ngritje e vetëdijes për përdorimin e veturave efikase, me kosto të ulët të lëndës djegëse, me fuqi më të vogël motorike, inkurajimi i një organizimi më të avancuar në transportin urban dhe rrugor.
KURSIMET E PRITURA APO VJETORE NË 2011-2016	Kursimet e pritura vjetore të energjisë në sektorin e transportit shihen të jenë 0.5 %, apo 1.4 ktoe. Në fund të vitit 2012 kursimet e pritura janë 1.4 ktoe, dhe në vitin 2018 8.4 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Fushata do të fillojë më 2010 dhe do të vazhdojë në periudhë afatgjate.

Kapitulli IX. Sektori i bujqësisë

Kosova do të vazhdojë të mbetet për shumë vite një shtet ku bujqësia dominon BPV-në krahasuar me të gjithë sektorët tjerë ekonomikë. Peshat specifike e bujqësisë në BPV mbetet rreth 40%. Energjia përdoret për kultivimin e të mbjellave dhe bagëtisë si dhe për pylltari dhe këta nënsektorë vazhdojnë të jenë mundësia kryesore për zhvillim ekonomik dhe social, posaçërisht në zonat rurale.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë kushtëzohet nga shumë faktorë, ku më të rëndësishmit janë:

1. fermat e vogla dhe të ndara,
2. problemet lidhur me pronësinë e tokave të punueshme,
3. çmimet tejet të larta të inputeve dhe sistemi i çrregullt dhe joefektiv i prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore,
4. mungesa apo pamjaftueshmëria e kredive bujqësore,
5. mungesa apo pamjaftueshmëria e mekanikëve bujqësore.

Më synim të zvogëlimit të konsumit të energjisë në pajtim me caqet për kursime të energjisë, janë marrë parasysh dhe analizuar masat vijuese sasiore dhe cilësore:

1. Së pari, është paraparë një ulje prej 10% në intensitetin të energjisë për shkak të menaxhimit më të mirë. Kjo do të arrihet përmes ristrukturimit të sektorit të bujqësisë. Këto masa do të dyfishojnë fitimet, rrisin prodhimin e bujqësisë dhe, në anën tjetër, zvogëlojnë konsumin specifik të karburantit.
2. Futja e skemave të biomasës dhe prodhimi i biogazit nga bimët dhe mbeturinat bujqësore dhe të kafshëve është mënyrë efektive për të përmbushur kërkesën në rritje të sektorit të bujqësisë.
3. Potenciali i lartë për energji solare në Kosovë e bën atë burim të preferuar të energjisë, posaçërisht nëse përdoren kolektorët solarë që prodhojnë ajër të ngrohët nga tharja e kulturave të ndryshme bujqësore.
4. Është paraparë përdorimi i skemave efikase të ujitjes, që do të thotë se ujitja sipërfaqësore me shpime do të zëvendësohet me ujitje me presion në formë të shiut apo pikave, për të zvogëluar konsumin e energjisë për ujitje për 50%.

Në figurat 21 dhe 22 janë përmbledhur kursimet relative dhe absolute të energjisë për sektorin e bujqësisë për arrijtjen e objektivave të definuar në pjesët e mësipërme.

Figura 19: Caqet afatshkurte dhe afatgjate të EE për sektorin e bujqësisë në %





Figure 20. Gjithsej Kërkesa për energji pas zbatimit të masave të EE në sektorin e bujqësisë dhe kursimet absolute të EE në (ktoe)



PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Tabela 22: Masat për përmirësim të efiçencës së energjisë (PEE) në sektorin e bujqësisë

KODI	TITULLI	GJENDJA	LLOJI	VITI I FILLIMIT	VITI I PËRFUNDIMIT	REZULTATI	IMPLEMENTUES
KB1	Fushatë publike e vetëdijesimit në sektorin e bujqësisë	Planifikuar	Edukim / vetëdijesim	2010	2011	Kursimet indikative të energjisë në Sektorin e Bujqësisë priten pas zhvillimit të fushatës	MZHE, MBPZHR, kompanitë bujqësore, kompanitë energjetike

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË

IX.1. MASAT INDIVIDUALE PËR PËRMIRËSIM TË EFIÇIENCËS SË ENERGIJË NË SEKTORIN E BUJQËSISË

IX.1.1.: FUSHATË VETËDIJESIMI NË SEKTORIN E BUJQËSISË (KODI: KB1)

TITULLI	FUSHATË VETËDIJESIMI PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË
KATEGORIA	EDUKUESE / VETËDIJESIM
GRUPI I ÇAKUT	MZHE(ish MEM), MBPZHR, INSTITUCIONET QENDRORE DHE LOKALE, KOMPANITË BUJQËSORE, KOMPANITË ENERGETIKE
VEPRIMET E NDËRMARRA NGA PEE	Fushatë e integruar publike me fokus në Sektorin e bujqësisë për eficiencë të energjisë në këtë sektor. Krahas shpjegimit të teknikave të kursimit të energjisë dhe uljes së konsumit të burimeve të caktuara të energjisë në kultivim të tokës, bagëti dhe agrobiznes, synimi është që të futet përdorimi i llojeve të ndryshme të biokarburantëve në makinën bujqësore.
EFEKTIVITETI	Fushata e vetëdijesimit pritet të rezultojë me kurse me kursime të energjisë në sektorin e bujqësisë, dhe me futjen e përdorimit të biokarburantëve, të prodhuar në vend apo të importuar.
KURSIMET E PRITURA APO VJETORE NË 2011-2016	Kurseme vjetore të energjisë në Sektorin e bujqësisë parashihen në 0.05 ktoe. Deri në fund të vitit 2012 kurset pritet të jenë 0.15 ktoe, dhe deri më 2018 0.4 ktoe.
STATUSI I ZBATIMIT DHE AFATI KOHOR	Fushata do të rezultojë m, kurseme të energjisë në vitin 2011.

Kapitulli X: Masat Politike dhe Programatike për Zbatimin e PNEE në Kosovë

Rishikimi i azhurnuar i Strategjisë së Rishikuar është bazuar në Programin e Qeverisë së Kosovës dhe në disa vendime qeveritare: dokumentin e politikave afat-mesme të sektorit të energjisë si dhe në një mor të studimeve dhe analizave përkatëse që janë kryer viteve të fundit. Janë ndërmarrë përpjekje të veçanta për tu siguruar që kjo Strategji është plotësisht në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian, që është ligjërisht e detyrueshme për Kosovën në kontekstin e anëtarësimit të saj në Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Qëllimi kryesor i Strategjisë së Energjisë së Kosovës është të arrijë menaxhimin efektiv të burimeve ekzistuese të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Strategjia përqendrohet në rritjen e sigurisë për furnizim me energji në pajtim me standardet evropiane, si dhe në diversifikimin e burimeve të energjisë. Kjo strategji synon gjithashtu të stimulojë shfrytëzimin racional të energjisë, të promovojë zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe futjen e teknologjisë së re që nuk shkakton dëme të riparueshme për mjedisin, duke respektuar kështu zbatimin e standardeve ndërkombëtare për mjedisin.

Neni 10 i Ligjit për Energjinë 2004/8 ka siguruar komizën për zbatimin e efijencës së energjisë dhe politikave të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Në veçanti, paragrafi (a) i Nenit 10 mbulon hartimin e një programi zbatues për promovimin e përdorimit eficient të energjisë dhe burimeve të energjisë së ripërtëritshme. Efijenca e energjisë dhe masat për menaxhimin e kërkesës janë kritike për zvogëlimin e shkallës së lartë të rritjes vjetore të kërkesës, që është kryesisht pasojë e përdorimit të energjisë elektrike për qëllime të ngrohjes. MZHE-i ka hartuar Projektligjin për Efijencën e Energjisë dhe kjo gjë është shumë e rëndësishme për rritjen e efijencës së energjisë për të gjithë sektorët ekonomik të Kosovës. Pengesat kryesore për futjen e efijencës së energjisë për ndërtesat në Kosovë, dhe mënyrat për t'i zbatuar ato, janë si në vijim:

- a. **Mos pagimi i energjisë nga konsumatorët** – Me një lehtësi të konsiderueshme, një konsumator mund të mos paguajë për të gjithë apo një pjesë të ngrohjes qendrore apo energjisë elektrike që ai konsumon. Nuk ia vlen të investohet në zvogëlimin e konsumimit të mallit që mund të merret pa pagesë. Me gjasë, kjo është pengesa më e madhe për momentin për investimet dhe masat për përmirësimin e efijencës së energjisë në të gjithë sektorët, si dhe në veçanti për ndërtesat. Gjatë tri viteve të kaluara, Qeveria e Kosovës ka përmirësuar shkallën e inkasimit dhe tani është në fazën përfundimtare të privatizimit të sektorit të distribucionit. Kjo gjë duhet të rrit shkallën e inkasimit shumë shpejt dhe duhet të ndihmojë në zbatimin e masave të EE për ndërtesat.
- b. **Mungesa e informacionit dhe vetëdijesimit nga ana e konsumatorëve** – Kjo mund të jetë një pengesë potenciale për çdo sektor. Për shembull, një konsumator mund të mos ketë informacion për mënyrën e tij të konsumimit të energjisë, si krahasohet me konsumatorët tjerë, si mund të përmirësohet, si dhe mund të ketë mungesë informacion për përfitimet financiare dhe të tjera për ndryshimin e konsumimit të energjisë. Ai mund të mos jetë në dijeni për skemat teknologjike dhe financiare në dispozicion, apo se si mund të përdor sistemin e tarifave për të blerë energjinë elektrike më lirë. Duke i marrë parasysh këto kushte, MZHE – me mbështetjen e ZNKE – ka kryer një fushatë vetëdijesimi për promovimin e EE dhe kjo gjë do të zbusë këtë pengesë.
- c. **Mungesa e stimuljeve për ndërmarrjen e veprimeve që çojnë në efijencën e energjisë** – Një pengesë serioze në sektorin publik është se rregullat nuk lejojnë që një spital, shkollë apo ndonjë njësi tjetër të përfitojë drejtpërdrejt nga kursimi i energjisë elektrike. Projektligji për Efijencën e Energjisë do të themeltojë Zyrën Rajonale/Komunale të Energjisë, që do të ndihmojë në këtë drejtim.
- d. **Mungesa e kapitalit** – Shumë shpesh ka mungesë të kapitalit dhe ka mundësi alternative të përcorimit të kapitalit që janë kosto-efektive. Kreditë merren me vështirësi dhe atëherë kur merren duhet të paguhet shkalla e lartë e kamatave. KfW i ka siguruar rreth 20 milion euro për bankat ProCredit dhe Raiffaisen, si kreu i të bura për EE dhe BER. Programi i Infrastrukturës së BE-së dhe KfW ka filluar programin e dytë për rritjen e efijencës së energjisë në ndërtesa për komunat e përzgjedhura për investime, duke përmirësuar kështu ndërtesat e tyre publike.
- e. **Mungesa e shkathtësive dhe njohurive profesionale** – Arkitektët, inxhinierët, importuesit dhe instaluesit mund të mos kenë shkathtësitë apo njohuritë e domosdoshme teknike për të shfrytëzuar mundësitë e plota për kursimin e energjisë nëpërmjet metodave moderne. MZHE, i mbështetur nga ZNKE, është në përfundim të sipër të një projekti trajnimi dhe certifikimi për 50 Auditorët e parë të Energjisë, të cilët do të ndihmojnë duke përhapur njohuritë e tyre dhe duke zbatuar këto shkathtësi në praktikë.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

- f. **Mungesa e një baze të fortë ligjore dhe rregullatore** – Aktualisht nuk ka një bazë të duhur ligjore dhe rregullatore për promovimin e efiçencës së energjisë dhe zbatimit të energjisë së ripërtrishme ose për përcaktimin e përgjegjësive dhe kompetencave për përmirësimin e situatës. MZHE, i mbështetur nga ZNKE, ka hartuar draftin final të Ligjit për Efiçencën Energjetike, që do të duhej të miratohej në mes të muajit mars të vitit 2011. Zbatimi i këtij ligji do të ndihmonte në mbushjen e zbrastërës në fushat ligjore dhe rregullatore.

Kapitulli XI: Treguesit e mbikëqyrjes 2010 - 2012

Aspekti i fundit dhe më i rëndësishëm i Planit të Veprimit të Kosovës për Eficiencë Energjetike është procesi i mbikëqyrjes, që duhet të përdoret për zbatimin e saj. Në mënyrë që të kemi një procesi të mirëfilltë të mbikëqyrjes, treguesit e mëposhtëm të mbikëqyrjes janë propozuar për të vlerësuar të gjithat masat e eficiencës së energjisë, që janë analizuar më lartë, dhe veçanërisht sektorët e amvisërisë dhe shërbimeve që së bashku përbëjnë 70 për qind të caqeve potenciale të kursimit të energjisë.

Grupi i parë i treguesve lidhet me masat e EE që janë përdorur për ngrohjen e hapësirave në ndërtesat e sektorëve të amvisërisë dhe shërbimeve. Përcaktimi i sasisë së kursimit në të dy sektorët është i rëndësishëm për shkak se 70 për qind e caqeve duhet të përmbushen nga vetë ato – ndërsa për sektorët tjerë treguesit e mbikëqyrjes janë domosdoshmërisht cilësor, për shkak se të dhënat për EE mungojnë gati tërësisht (në sektorët e industrisë, transportit dhe bujqësisë).

Treguesi i parë i mbikëqyrjes është numri i ndërtesave të amvisërive dhe shërbimeve (shih tabelën më poshtë), ku do të ndërmerren masat e rinovimit për të përmbushur kursimet afatshkurtra të energjisë. Kosto Mesatare për Njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.048 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.045 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve, dhe ky është një përfundim i rëndësishëm që duhet pasur parasysh gjatë promovimit të kësaj mase: d.m.th., kostoja e kursimit të energjisë është më e ulët se sa çmimi aktual i energjisë elektrike.

Numri i ndërtesave që duhet të rinovohen për të arritur caqet për çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave që kanë nevojë për masat e rinovimit	1504	2197	3693	329	467	610

Formula në vijim siguron vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë për shkak të përmirësimeve të izolimit të ndërtesës dhe sistemit të ngrohjes. Njësia matëse e kursimit final do të llogaritet në bazë të ndryshimit në mes të kërkesës specifike të ngrohjes para dhe pas masave të rinovimit.

$$UFES = \frac{SHD_{init}}{\eta_{init}} - \frac{SHD_{new}}{\eta_{new}} \quad [kWh\ m^2\ of\ useful\ floor\ area\ year]$$

SHD_{init} = ngrohja specifike para zbatimit të masave të rinovimit [kWh/m²*viti]

SHD_{new} = kërkesa e ngrohjes specifike pas zbatimit të masave të rinovimit [kWh/m²*vit]

η_{init} , η_{new} = eficiency e energjisë të sistemit të ngrohjes para (init) dhe pas (new) masave të rinovimit (sezonale) është eficiency mesatare e stokut të sistemeve të ngrohjes. B= 0,95 për ngrohjen e drejtpërdrejt me energji elektrike dhe 0,6 për kazanët e lëndës fosile, nëse nuk ekziston ndonjë vlerë përmirësuese kombëtare. c = koeficienti i intermite të cës që varet nga mosfunksionimi i vazhdueshëm i sistemit të ngrohjes. c = 0,5, nëse nuk ekziston një vlerë përmirësuese kombëtare. HDD = shkalla e ngrohjes-ditë [K*ditë/vit]

Kursimet shprehen në kWh/m² për vit. Gjendja 'para' do të bazohet në ndërtesën e veçantë apo do të pasqyrojë eficiency e energjisë për kategorinë e ndërtesës (varësisht prej llojit të ndërtesës, teknologjitë e instalimit, dhe/apo të llojit të izolimit dhe periudhës së ndërtimit). Vlerat e kërkesës së veçantë të ngrohjes do të korrigjohen duke u bazuar në ditët përkatëse të ngrohjes. Kursimet finale të energjisë për kWh për ndërtesë për vit do të llogariten duke shumëzuar njësinë matëse të kursimeve vjetore për m² me hapësirën e përgjithshme të hapësirës së shfrytëzueshme të ndërtesës së rinovuar. Kursimet e përgjithshme të energjisë të arritura sipas masës do të llogariten në përmoldhje të kursimeve të secilës ndërtesë të rinovuar.

Treguesi i dytë i mbikëqyrjes do të jetë numri i ndërtesave të amvisërisë dhe shërbimeve (tabela më poshtë), ku do të paraqiten masat e rinovimit të zbatuara për pjesët e ndërtesës (muri, kulmi) për të arritur kursimet e lartpërmendura të energjisë për periudhën afatshkurtër. Kosto Mesatare për Njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.021 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.020 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave ndaj të cilave duhet zbatuar masat e rinovimit në pjesët përbërëse (muret, kulmi)						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave ndaj të cilave duhet	1105	1485	2153	242	315	345

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

zbatuar masat e rinovimit në pjesët përbërëse (muret, kulmi)						
--	--	--	--	--	--	--

Formula në vijim (që do të përdoret gjithashtu për treguesin e tretë të mbikëqyrjes) siguron vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë në bazë të masave të izolimit të ndërtesave dhe ndërrimit të dritareve.

$$UFES = \frac{(U_{value_{init}^{wall,roof}} - U_{value_{new}^{wall,roof}}) \cdot HDD24 \cdot a \cdot b \cdot c}{1000} \quad [kWh m^2 \text{ of building year}]$$

$U_{value_{init}^{wall,roof}}$ and $U_{value_{new}^{wall,roof}}$

= U-Vlera para (init) dhe pas rinovimit (e re) [W/m² * K], përdorimin e vlerave për transmetimit termik të materialeve izoluese dhe strukturën ekzistuese të murit apo çati.

a = korrigjim varësisht nga zona klimatike e ndërtesës, me një = 1, në qoftë se nuk ka vlerë kombëtare korrigjim është në dispozicion

b= Korrigjim faktor në varësi të efikasitetit të sistemit të ngrohjes dhe burim të energjisë. Ky faktor korrigjim është efikasiteti mesatare të ngarkeses në sistemin e ngrohjes. Me b = 0,95 për ngrohje direkte elektroenergjetike dhe 0,6 për kalidaja me lëndë djegëse fosile, në qoftë se nuk ka vlerë korrigjim është në dispozicion.

c = koeficientit në varësi të operacionit jo të vazhdueshëm i sistemit të ngrohjes.

Me c = 0,5, në qoftë se nuk ka "Nacional"-U vlerën e ndërtesës e cila është rinovuar ose mesatare U-Vlera e mesatare e aksioneve ekzistuese të vitit të ndërtimit të ndërtesës nënshtruar rinovimit.

Njësia matëse e kursimeve vjetore të energjisë (në kWh/m²*vit) bazohet në ndryshimin në mes të vlerave U para dhe pas zbatimit të masave të rinovimit. Vlerat U do të korrigojnë në bazë të ditëve dhe shkallës së ngrohjes, për aq sa mund të zbatohet, me efizienz dhe intermitencë të sistemit të ngrohjes. Kursimet totale vjetore të energjisë në kWh për ndërtesën dhe për çdo vit do të llogariten duke shumëzuar njësitë matëse të kursimeve vjetore për m² me hapësirën e përgjithshme të izoluar (m²) të ndërtesës së rinovuar (muret, kulmi ose dritaret).

Treguesi i tretë i mbikëqyrjes është numri i ndërtesave aktuale të amvisërisë dhe shërbimeve (shih tabelën), duhet bërë ndërrimi i dritareve ekzistuese me lustrim të dyfishtë/trefishtë për të arritur kursimet e lartpërmendura të energjisë gjatë periudhës afatshkurtër. Kosto Mesatare për Njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.030 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.028 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave ekzistuese që u duhet ndërruar dritaret ekzistuese me lustrim të dyfishtë/trefishtë për çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave ekzistuese që u duhet ndërruar dritaret ekzistuese me lustrim të dyfishtë/trefishtë	936	1367	2298	205	290	380

Formula në vijim siguron vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë bazuar në futjen e një kodi të ri të ndërtesës me kushte më rigorozë për kërkesat e ngrohjes së ndërtesës.

$$UFES = \frac{(U_{value_{init}^{windows}} - U_{value_{new}^{windows}}) \cdot HDD24 \cdot a \cdot b \cdot c}{1000} \quad [kWh m^2 \text{ of building year}]$$

$$UFES = \frac{SHD_{initcode}}{\eta_{initcode}} - \frac{SHD_{newcode}}{\eta_{newcode}} \quad [kWh m^2 \cdot year]$$

= U-vlerë para (init) dhe pas rinovimit (e re) [W/m² * K], përdorimin e vlerave për transmetimit termik të dritareve ekzistuese dhe të reja.

a = korrigjim varësisht nga zona klimatike e ndërtesës, me një = 1, në qoftë se nuk ka vlerë kombëtare korrigjim është në dispozicion

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

= b Korrigjim faktor në varësi të efikasitetit të sistemit të ngrohjes dhe burim të energjisë. Ky faktor korrigjim është efikasiteti mesatare e aksioneve të sistemeve të ngrohjes. Me b = 0,95 për ngrohje direkte elektroenergetike dhe 0,6 për kalidaja lëndë djegëse fosile, në qoftë se nuk ka vlerë kombëtare korrigjim është në dispozicion.

c = Intermittency koeficientit në varësi të operacionit jo të vazhdueshëm i sistemit të ngrohjes. Me c = 0,5, në qoftë se nuk ka "Nacional"-U vlerën e ndërtesës e cila është rinovuar ose mesatare

U-Vlera e mesatare e aksioneve ekzistuese të vitit të ndërtimit të ndërtesës nënshtruar rinovimit.

Kursimet e unitar vjetor i energjisë (në vitin kWh/m² *) janë të bazuara në dallimin në mes të vlerave-U e Windows para dhe pas zbatimit të masës rinovimit. U-vlerat do të korrigojohen me ditët e shkallës përkatëse ngrohje che, sa më shumë të jetë e mundur, me efikasitet dhe intermittency i sistemit të ngrohjes. kursimeve totale vjetore të energjisë në kilovatorë në ndërtimin dhe në vit janë të llogaritet si shumëzim i matur kursimeve unitar vjetore të energjisë për m² e objektit të rinovuar (ndryshimin e dritareve).

SHD_{inicode} = kërkesa e veçantë e ngrohjes së ndërtesës sipas kodit fillestar të energjisë së ndërtesës (apo një grup i rregulloreve termike që kanë ekzistuar në Kosovë) në fuqi që nga viti 1999 [kWh/m²*vit]

SHD_{newcode} = kërkesa e veçantë e ngrohjes së ndërtesës sipas kodit të ri të ndërtesës [kWh/m²*vit]

$\eta_{inicode}$, $\eta_{newcode}$ =efiçienca e energjisë së sistemit të ngrohjes sipas kodit të vjetër (kodit fillestar) dhe kodit të ri (sezonal).

Treguesi i katërt i mbikëqyrjes do të jetë numri i ndërtesave të amvisërisë dhe shërbimeve (shih tabelën më poshtë), ku kod i energjisë së ndërtesës për ndërtesat e reja të banimit do të futet në përdorim për të arritur kursimet e lartpërmendura të energjisë në periudhën afatshkurtër. Kosto Mesatare për Njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.054 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.052 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave ku për çdo vit futet në përdorim kodit i energjisë së ndërtesës për ndërtesat e reja						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave ku për çdo vit futet në përdorim kodit i energjisë së ndërtesës për ndërtesat e reja	0	0	345	0	0	73

Formula e mëposhtme jep për vlerësimin e kursimeve të energjisë vjetore që rrjedhin nga prezantimi i një kodit ndërtesë e re me kërkesa më të rrepta në lidhje me kërkesën e ndërtesës së ngrohjes.

$$UFES = \frac{SHD_{inicode}}{\eta_{inicode}} - \frac{SHD_{newcode}}{\eta_{newcode}} \quad [kWh/m^2 \cdot year]$$

SHD_{inicode} = Kërkesa specifike për ngrohje të ndërtesës sipas vlerave fillestare të ndërtimit në kodin për energji (ose grup i rregullimit termike e cila ka ekzistuar në Kosovë), në vend që nga viti 1999 [viti kWh/m² *]

SHD_{newcode} = Kërkesa specifike për ngrohje të ndërtesës në bazë të kodit të ri u implementuar. [kWh/m² vitit *]

$\eta_{inicode}$, $\eta_{newcode}$ = Efiçasiteti i energjisë i sistemit të ngrohjes në ndërtimin sipas vjetër (inicode) dhe e re (newcode) kodit të ndërtimit. (sezonale)

Treguesi i pestë i mbikëqyrjes do të jetë numri i ndërtesave të amvisërisë dhe shërbimeve (shih tabelën më poshtë), ku do të bëhet zëvendësimi i pajisjeve të furnizimit me ngrohje për të arritur kursimet e lartpërmendura të energjisë në periudhën afatshkurtër. Kosto Mesatare për Njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.036 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.034 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave ku duhet zëvendësuar pajisjet e furnizimit me ngrohje për çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave ku duhet zëvendësuar pajisjet e furnizimit me ngrohje për çdo vit	78	402	1054	17	86	221

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Formula siguron vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë që burojnë nga zëvendësimi apo instalimi i ri i pajisjeve të furnizimit me ngrohje në ndërtesat e banimit dhe ato terciare. Njësitë matëse të kursimeve vjetore do të llogariten në bazë të ndryshimit në efikasitetin e sistemit të ngrohjes pas zëvendësimit të tij, duke e shumëzuar me kërkesat specifike për ngrohje dhe hapësirën e dobishme për ngrohje (në kWh/njësi*vit) për secilën ndërtesë.

$$UFES = \left(\frac{1}{\eta_{ini}} - \frac{1}{\eta_{new}} \right) \cdot SHD \cdot A \quad [kWh / unit \cdot year]$$

η_{ini} = efikasiteti i energjisë së pajisjeve të vjetra të furnizimit me ngrohje x para zëvendësimit (sezonal)

η_{new} = efikasiteti i energjisë së pajisjeve të reja të furnizimit me ngrohje (sezonal)

SHD = kërkesa e veçantë e ngrohjes (kWh/m²*vit)

A = hapësira mesatare që do të ngrohet nga pajisjet furnizuese të ngrohjes (amvisritë, zyrat, etj) (m²)

Kursimet totale vjetore të energjisë në kWh për çdo ndërtesë dhe për çdo vit do të llogariten duke përmblodhur njësitë matëse të kursimit vjetor, të arritur prej secilës njësi të zëvendësuar të pajisjeve furnizuese të ngrohjes. Kursimet e përgjithshme të energjisë të arritura sipas masës do të llogariten në përmbljedhjen e kursimeve në secilën ndërtesë të re.

Treguesi i gjashtë i mbikëqyrjes do të jetë numri i ndërtesave të amvisërisë dhe shërbimeve (shih tabelën më poshtë), ku do të bëhet zëvendësimi i kazanëve të ngrohjes së ujit, të kategorisë A, për ndërtesat e amvisërisë dhe shërbimeve për të arritur kursimet e lartpërmendura të energjisë në periudhën afatshkurtër. Kosto Mesatare për Njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.040 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.035 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave ku duhet ndërruar kazanët e ngrohjes së ujit, të kategorisë A, për ndërtesat e amvisërisë dhe shërbimeve për çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave ku duhet ndërruar kazanët e ngrohjes së ujit, të kategorisë A, për ndërtesat e amvisërisë dhe shërbimeve	390	409	476	41	44	53

Formula siguron vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë që burojnë nga zëvendësimi apo instalimi i ri i pajisjeve të reja të ngrohjes së ujit në ndërtesat e banimit dhe ato terciare. Njësia matëse e kursimeve vjetore (në kWh/ndërtesë*viti) do të llogariten në bazë të ndryshimit në efikasitetin e energjisë para dhe pas zëvendësimit të kazanit të ujit, duke e shumëzuar me kërkesat specifike për ujë të ngrohtë .

$$UFES = \left(\frac{1}{\eta_{ini}} - \frac{1}{\eta_{new}} \right) \cdot SWD \quad [kWh / households \cdot year]$$

$$SWD = \frac{C_{hot_water_daily} \cdot 365 \cdot n_{persons/hholds} \cdot (t_{hot_water} - t_{cold_water}) \cdot c_{water} \cdot C_f}{1000}$$

[kWh / households · year]

η_{ini} , η_{new} = Efikasiteti i energjisë së pajisjeve të vjetra dhe të reja për ngrohje

SWD = Kërkesa specifike për ujë të ngrohtë [kWh/amvisëri*vit]

365d = 365 ditë

Hot_water_daily = Konsumi mesatar ditor i ujit të ngrohtë për person

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

[I] npersons/hhds = Numri mesatar i personave për një amvisëri thot_ water = Temperatura e ujit të ngrohët (zakonisht 40 0 C) tcold_ water = Temperatura e ujit të ftohtë (zakonisht 15 0 C)
 cwater = Ngrohja specifike e ujit =1kcal/kg*0C
 cf = Faktori i konversionit 0,001163 kWh/kcal me 1 litër ujë = 1 kg

Gjithsej kursimet vjetore të energjisë [kWh/vit] llogariten duke i mbledhur kursimet vjetore unike të energjisë dhe numrin e zëvendësimeve të njësive të ujit të ngrohët.

Treguesi i shtatë i monitorimit është numri i amvisërive dhe numri i ndërtesave të shërbimeve (shih tabelën më poshtë) ku do të futen sistemet solare për ngrohje të ujit për të arritur kursimet e sipërpërmendura të energjisë në periudhë afatshkurtre. Kostoja mesatare për njësi e kësaj Mase të EE do të jetë 0.037 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.026 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave që kanë nevojë për instalim të sistemeve solare për ngrohje të ujit në ndërtesat e sektorit të amvisërisë dhe atë të shërbimeve çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave që kanë nevojë për instalime të sistemeve solare për ngrohje të ujit në ndërtesa	228	372	676	29	48	89

Formula ofron vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë nga instalimi i paneleve solare për ngrohje të ujit në ndërtesat ekzistuese apo të reja të banimit dhe atyre terciare. Kursimet vjetore unike të energjisë llogariten në bazë të kursimeve mesatare vjetore të energjisë për m² të panelit solar, duke marrë parasysh efikasitetin mesatar të stokut të sistemeve të ujit të ngrohët në vitin përkatës, qoftë për ndërtesat e reja apo për ato ekzistuese (në kWh/m²*vit).

$$UFES = \left(\frac{USAVE}{\eta_{stock_average_heating_system}} \right) \quad [kWh/m^2 \cdot year]$$

USAVE = Kursimet vjetore mesatare për m² të panelit solar, që paraqet prodhimin mesatar të ngrohjes për m² të panelit solar [kWh/m²] $\eta_{stoku\ mesatar\ i\ sistemit\ të\ ngrohjes}$ = Efikasiteti i stokut mesatar të sistemeve të ngrohjes të ujit

Gjithsej kursimet vjetore të energjisë [kWh/vit] llogariten përmes shumëzimit të kursimeve vjetore unike të energjisë me gjithsej hapësirën e instaluar në m² të paneleve solare.

Treguesi i tetë i monitorimit është numri i amvisërive dhe numri i ndërtesave të shërbimeve (tabela më poshtë) ku do të futen kaldajat efikase për gatim me etiketë të Kategorisë A në ndërtesat e sektorit të amvisërisë dhe të shërbimeve për të përmbushur kursimet afatshkurtre të energjisë. Kostoja mesatare për njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.038 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.034 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave që kanë nevojë për futjen e kaldajave efikase me etiketë të Kategorisë A në ndërtesat e sektorit të amvisërisë dhe shërbimeve çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave që kanë nevojë për futje të kaldajave efikase për gatim me etiketë të kategorisë A në ndërtesa	746	1015	1632	100	148	251

Formula mundëson vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë nga zëvendësimi apo instalimi i ri i pashijeve të gatimit në ndërtesat ekzistuese banesore dhe terciare. Kursimet vjetore unike të energjisë (në kWh/building*vit) llogariten në bazë të dallimit të efikasiteteve të energjisë ndërmjet kohës para dhe pas zëvendësimit të pashijeve për gatim, shumëzuar me kërkesën specifike për energji për gatim.

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

$$UFES = \left(\frac{1}{\eta_{ini}} - \frac{1}{\eta_{new}} \right) \cdot SCD \quad [kWh / households \cdot year]$$

$SCD =$ kërkesa specifike për energji për gatim si shifër bazike mund të përdoret 2000-2200 kWh/amvisëri

η_{ini} , η_{new} = Eficienca e energjisë e pajisjeve të vjetra dhe të reja për gatim

Gjithsej kursimet vjetore të energjisë [kWh/vit] llogariten përmes mbledhjes së kursimeve unike vjetore me numrin e pajisjeve të zëvendësuara të gatimit.

Treguesi i nëntë i monitorimit është numri i ndërtesave të amvisërive dhe shërbimeve (tabela më poshtë) ku janë instaluar poçet EE për të përmbushur kursimin e lartcekur të energjisë për periudhën afatshkurtër. Kostoja mesatare për njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.013 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.011 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave ku do të instalohen poçet EE në ndërtesa të sektorit të amvisërisë dhe shërbimeve çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave ku do të instalohen poçet EE në ndërtesa	167	227	365	8566	11491	17963

Formula më poshtë përcakton vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë nga zëvendësimi i poçeve me ato më efikase apo instalimin e llambave të reja. Kursimet vjetore unike të energjisë (in kWh/njësi*vit) për zëvendësim të llambave llogariten përmes dallimit ndërmjet konsumit mesatar të energjisë të stokut të llambave në vitin përkatës (situata 'para') dhe energjia e llambave efikase e promovuar nga masat dhe programet (situata 'pas' = viti i promovimit). Në rast të llambave shtesë në treg do të përdoret konsumi mesatar i energjisë në vitin përkatës.

$$UFES = \left(\frac{P_{STOCK_AVERAGE} - P_{BEST_MARKET_PROMOTED}}{1000} \right) \cdot F_{rep} \cdot n_h \quad [kWh / unit \cdot year]$$

$P_{STOCK_AVERAGE}$ = mesatarja e energjisë së poçeve ekzistuese në amvisëri [W]

$P_{BEST_MARKET_PROMOTED}$ = Energjia e poçeve të tregtuara efikase [W]

n_h = Numri i orëve të operimit

F_{rep} – Faktori i përmirësimit duke marrë parasysh se një pjesë e poçeve të shitura nuk do të zëvendësojnë menjëherë ato të vjetrat;

Gjithsej kursimet vjetore të energjisë in [kWh/vit] llogariten përmes shumëzimit të kursimeve vjetore unike me numrin e poçeve efikase të shitur apo instaluar sipas masave dhe programeve për përdorim rezidencial.

Treguesi i dhjetë i monitorimit do të jetë numri i ndërtesave të amvisërisë dhe numri ndërtesave të shërbimeve ku do të futen Lavatriqet me etiketë të kategorisë A për t'i arritur kursimet e lartcekura të energjisë për periudhën afatshkurtër. Kostoja mesatare për njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.046 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.040 Euro/kWh për ndërtesat e shërbimeve.

Numri i ndërtesave ku do të futen makinat larëse efikase me etiketë të kategorisë A në ndërtesat e amvisërisë dhe të shërbimeve çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Numri i ndërtesave ku do të futen makinat larëse efikase me etiketë të kategorisë A	1048	1361	2104	1781	4095	7671
---	------	------	------	------	------	------

Formula në vijim përcakton vlerësimin e kursimeve vjetore të energjisë nga zëvendësimi i pajisjeve elektrike shtëpiake me makina larëse më efikase. Kursimet vjetore unike të energjisë për pajisjet shtëpiake llogariten në bazë të dallimit ndërmjet konsumit vjetor mesatar të energjisë në vitin përkatës (për makinat e reja larëse mesatarja e tregut) dhe konsumi vjetor i energjisë për makinat larëse promovuar nga masat dhe programet.

$$UFES = AEC_{WM_referencyearstockaverag} \cdot AEC_{WM_referencmarkepromotedenergclass} \quad [kWh/m^2 \cdot year]$$

AEC mesatarja e stokut në vitin përkatës = Konsumi vjetor i energjisë i stokut të makinave larëse në vitin përkatës (2005) [kWh/njësi *vit]

AEC reference market promoted energyclass = Konsumi vjetor i energjisë i makinave larëse promovuar nga masat dhe programet (2007) [kWh/njësi*vit]

Gjithsej kursimet vjetore të energjisë in kWh për lloj të pajisjes dhe për vit llogariten përmes shumëzimit të kursimeve unike vjetore të energjisë me numrin e njësive të makinave larëse efikase të shitura.

Treguesi i njëmbëdhjetë i monitorimit është numri i ndërtesave të amvisërisë dhe shërbimeve ku janë futur frigoriferët e kategorisë A për eficiency për arritjen e kursimeve të cekura të energjisë për periudhën afatshkurtër. Kostoja mesatare për njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.041 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.036 Euro/kWh për ato të shërbimeve.

Numri i ndërtesave që kanë nevojë për frigoriferë efikas me etiketë të kategorisë A në ndërtesat e amvisërisë dhe të shërbimeve çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave që kanë nevojë për frigoriferë efikas me etiketë të kategorisë A në ndërtesa	133	177	276	267	354	552

Formula në vijim përcakton vlerësimin e kursimeve vjetore nga zëvendësimi i pajisjeve elektrike shtëpiake/shërbimeve me frigoriferë të ri më efikas. Kursimet vjetore unike të energjisë për pajisjet shtëpiake/të shërbimeve llogariten bazuar në dallimin ndërmjet konsumit vjetor të energjisë të stokut në vitin përkatës (për frigoriferë të ri mesatarja e tregut) dhe konsumi vjetor i energjisë i frigoriferëve të promovuar me masa dhe programe.

$$UFES = AEC_{RF_referencyearstockaverag} \cdot AEC_{RF_referencmarkepromotedenergclass} \quad [kWh/m^2 \cdot year]$$

AEC reference year stock average = Konsumi vjetor i energjisë i stokut të frigoriferëve në vitin përkatës (2005) [kWh/njësi *vit]

AEC reference market promoted energyclass = Konsumi vjetor i energjisë i frigoriferëve të promovuar nga masat dhe programet (2007) [kWh/njësi *vit]

Gjithsej kursimet vjetore të energjisë in kWh për lloj të pajisjes dhe për vit llogariten përmes shumëzimit të kursimeve unike vjetore të energjisë me numrin e njësive të frigoriferëve efikas të shitur.

Treguesi i dymbëdhjetë i monitorimit është numri i ndërtesave të amvisërisë dhe shërbimeve ku janë futur Kondicionerët efikas të ajrit e kategorisë A për eficiency për arritjen e kursimeve të cekura të energjisë për periudhën afatshkurtër. Kostoja mesatare për njësi e kësaj mase të EE do të jetë 0.052 Euro/kWh për ndërtesat e amvisërisë dhe 0.047 Euro/kWh për ato të shërbimeve.

Numri i ndërtesave që kanë nevojë për AC efikas me inverter me etiketë të kategorisë A në ndërtesat e amvisërisë dhe shërbimeve për çdo vit						
Viti	Sektori i amvisërisë			Sektori i shërbimeve		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Numri i ndërtesave që kanë nevojë për AC efikas me inverter me etiketë të kategorisë	119	211	408	67	83	120

PLANI KOSOVAR PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

A në ndërtesa					
---------------	--	--	--	--	--

Formula në vijim përcakton vlerësimin e kursimeve vjetore nga zëvendësimi i kondicionerëve me sistem të ndarë në ndërtesat e banimit dhe ato terciare. Kursimet vjetore unike të energjisë llogariten bazuar në përmirësimin e raporti të efikasitetit të energjisë (REE) të pajisjeve të kondicionimit të ajrit, normalizuar me energjinë nominale për ftohje të pajisjes dhe orët e operimit në vit (në kWh/njësi *vit).

$$UFES = \left(\frac{1}{EER_{average}} - \frac{1}{EER_{best_perf_on_market}} \right) \cdot P_{fn} \cdot n_h \quad [kWh/unit\ year] \quad \text{with: } n_h = n_{sh} \cdot f_u$$

EER = Raporti i efikasitetit të energjisë për pajisje: (energji e furnizuar për ftohje) / (energji elektrike e pajisjes)

$EER_{average}$ = Raporti i efikasitetit sezonal të energjisë të pajisjes përkatëse; $EER_{best_perf_on_market}$ = Raporti i efikasitetit sezonal të energjisë të pajisjes zëvendësuese me efikasitet të lartë. P_{fn} = Energjia nominale për ftohje të pajisjes [kW]

n_h = Orët e operimit në vit në fuqi të plotë

n_{sh} = Orët e kyçje në vit

f_u = Faktori i pjesës së ngarkesës (vlera e konfiguruar e sugjeruar është 58%)

Gjithsej kursimet vjetore të energjisë arritur me masën [kWh/vit] llogariten përmes mbledhjes së kursimeve unike vjetore të të gjitha njësive të zëvendësuese apo të reja të instaluara.

Kapitulli XI. Tabela e konversionit të njësive

	Kcal	kJ	kWh	Kgoe
1kcal=	1.00	4.186	11.63	10000
1kJ=	1.2388	1.00	27,778	238,850
1kWh=	859.845	3,600	1.00	85984.5
1kgoe=	10,000	41,868	11.63	1.00
Lëndët e lëngëta 1ton = 0.001 ktoe				
Naftë e papërpunuar: 1ton = 0.000946 ktoe				
Biomasë (dru zjarri): 1m ³ = 0.0001664 ktoe				
Thëngjill (linjit): 1ton = 0.0001911 ktoe				
Thëngjill i tharë: 1ton = 0.00096 ktoe				
Energji elektrike: 1GWh = 0.086 ktoe				